

# GROPOSJA E SË KALUARËS

## 10 VJET PANDËSHKUESHMËRI PËR ZHDUKJET DHE RRËMBIMET ME FORCË NË KOSOVË

**AMNESTY INTERNATIONAL**

Amnesty International është një lëvizje globale prej 2.2 milion personash në më shumë se 150 vende dhe territore të botës të cilët zhvillojnë fushata për t'i dhënë fund abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut. Vizioni ynë është që gjithsecili të gëzojë të gjitha të drejtat e mbrojtura nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe standarde të tjera të të drejtave të njeriut. Ne jemi një organizatë e pavarur nga çdo lloj qeverie, ideologjie politike, interesi ekonomik apo besimi fetar – dhe mbështetemi financiarisht kryesisht nga anëtarësimet dhe donacionet publike.

AMNESTY
INTERNATIONAL

Botime të Amnesty International

Botuar për herë të parë në 2009-ën nga
Amnesty International Publications
International Secretariat
Peter Benenson House
1 Easton Street
London WC1X 0DW
United Kingdom
www.amnesty.org

© Amnesty International Publications 2009

Indeksi: EUR 70/007/2009
Gjuha origjinale: Anglisht
Printuar nga Amnesty International,
Sekretariati Ndërkombëtar, Mbretëria e Bashkuar

Të gjitha të drejtat rezervohen. Ky botim është i mbrojtur nga e drejta e autorit, por mund të riprodhohet në çdo lloj mënyre pa asnjë lloj tarife për tu mbrojtur, për fushata apo mësimdhënieje, por jo për rishitje. Ata që gëzojnë të drejtën e autorit kërkojnë që një përdorim i tillë të regjistrohet me qëllim vlerësimin e efektit të tij. Për të kopjuar këtë botim në rrethana të tjera, për ta ripërdorur në botime të tjera, apo për ta përkthyer a përshtatur, duhet marrë leje me shkrim nga botuesit dhe një tarifë mund të aplikohet.

*Fotoja e kapakut*: Të afërmit e kosovarëve-shqiptarë të zhdukur demonstrojnë me fotografitë e të afërmve të tyre të pagjetur, Prishtinë, Kosovë. Mirënjohje: Mirësjellje e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur dhe Z. Shkelzen Rexha.
*Kreu i faqes së prapme*: Petrija Piljevic, një grua serbe, rrëmbyer në qershor 1999, me djalin e saj. Mirënjohje: Private
*Fundi i faqes së prapme*: Daka Asani, një burrë rom, rrëmbyer në gusht 1999. Mirënjohje: Private

# PËRMBAJTJA


1. Hyrje ....3

Luftërat në Kosovë dhe Serbi ....5

UNMIK-u dhe KFOR-i ....6

Zhdukjet me forcë të shqiptarëve etnikë ....6

Rrëmbimet e serbëve, romëve, dhe anëtarëve të komuniteteve të tjera në pakicë ....7

Mos-sigurimi i mbrojtjes ....8

2. Një dhunim i vazhdueshëm i të drejtave të njeriut: kuadri ligjor ....10

Ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut ....10

Të drejtat e të afërmve ....12

Mosrespektimi nga Serbia dhe UNMK-u i detyrimeve të tyre ndërkombëtare ....14

3. Gjetja e trupave: zhvarrimet dhe identifikimet ....16

Roli i KNKK-së ....16

Paqartësi kompetencash ....17

Zhvarrimet e kryera nga Tribunali ....19

Bashkëpunimi ndërmjet Serbisë dhe UNMIK-ut ....20

Zhvarrimet e kryera nga ZPZHML-ja e UNMIK-ut ....21

Komploti për fshehje: shqiptarët e Kosovës të varrosur në Serbi ....21

Ku ndodhen trupat e zhdukur? Pjesa e parë ....22

Identifikimi i eshtrave ....24

Ku ndodhen trupat e zhdukur? Pjesa e dytë ....25

Vazhdimi i zhvarrimeve ....27

4. Hetimet dhe ndjekjet penale ....28

Ndjekjet penale nga Tribunali ....28

Ndjekjet penale të serbëve për zhdukjet me forcë ....28

Ndjekjet penale të shqiptarëve etnikë për rrëmbimet ....30

Hetimet dhe ndjekjet penale në Serbi ....31

Gjykimet në Serbi të shqiptarëve etnikë për krime lufte ....33

Hetimet dhe ndjekjet penale të kryera nga UNMIK-u ....33

Ndjekjet penale në Kosovë ....35

Pengesat për t'i dhënë fund mosndëshkimit ....37

Mohimi i qasjes në prova ... 37
Mungesë bashkëpunimi ... 39
Pengesat ndaj hetimeve: policia e UNMIK-ut ... 41
Pengesat ndaj hetimeve: policia serbe ... 41
Pengesat në sistemin gjyqësor ... 42
Mungesa e mbrojtjes dhe mbështetjes për dëshmitarët ... 43
Ndërhyrjet politike në rrjedhën e drejtësisë ... 45

5. Të drejtat e të afërmve ... 51
Të afërmit kërkojnë të drejtat e tyre ... 53
Dëmshpërblimi: kompensimi për viktimat dhe familjet e tyre ... 54
Mundësia e marrjes së dëmshpërblimit nëpërmjet procedimeve civile ... 56
E drejta për të ditur: një shkelje e vazhdueshme ... 58
Kthimi dhe mospërsëritja ... 59

6. Konkluzione dhe rekomandime ... 60
Rekomandime ... 60
Zhvarrimet dhe identifikimet ... 61
Hetimet dhe Ndjekjet Penale ... 61
Të drejtat e të afërmve ... 63

Inicialet dhe Shkurtesat ... 65

Shtojca 1: Çështje Emblematike të ndjekura nga Amnesty International ... 67

Fundshënime ... 71

# 1. HYRJE

"Dola në rrugën kryesore dhe afërsisht katërqind ose pesëqind ushtarë ishin aty. Një prej tyre tha: 'Ndalo, ose të vrava,' dhe më pas – asnjëherë nuk do e harroj këtë – ai tha: 'Kthehu mbrapsht se tani po ia fillojmë'. Mbyllëm sytë dhe u kthyem në oborr ku po prisnin burrat, dhe u treguam se çfarë na u tha. E mbyllëm portën, por pas gati 10 minutash hynë brenda rreth 30 apo 35 policë. Kishin veshur uniforma blu me simbole serbe dhe shirita oficerësh në supe. Urdhëruan gratë dhe fëmijët të dilnin në rrugë dhe burrat të qëndronin brenda. MN shpëtoi pasi mbante në krahë nënën e tij të paralizuar. Arrestuan 11 burra: më i riu, Ilir Berisha, 17 vjeç; Tahir Sharani, Jusuf Sharani, Shkifer Sharani dhe dy djemtë e tij, Valonin dhe Visarin, dhe Mentor Sharani; Yusuf Saracini; Agim Saracini, Veli Saracini dhe djalin e tij Arben, të gjithë u morën atë ditë."

Sanje Berisha, nëna e Ilir Enver Berishës, Gjakovë/ Đakovica, shkurt 2009. Gjakova/ Đakovica vuajti nga një dhunë dhe shkatërrim i shkallës së lartë prej forcave serbe. Më se 1200 persona u arrestuan brenda 5 ditësh në qershor 1999, 400 prej tyre u dërguan në burgjet e Serbisë. Trupi i Ilir Enver Berishës u gjend në varrin masiv në Batajnica në Serbi dhe u rivarros në Kosovë më 21 shtator 2006.

Dhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, mosndëshkimi për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë mbetet një nga shkeljet më serioze të të drejtave të njeriut, si rezultat i konfliktit të armatosur dhe pasojave të tij. Zhdukjet me forcë përbëjnë krim dhe, në disa rrethana të parashikuara në të drejtën ndërkombëtare, krim kundër njerëzimit ose krim lufte.

Gjatë luftës në Kosovë, mbi 3000 shqiptarë etnikë qenë viktima të zhdukjeve me forcë nga policia, forcat paraushtarake dhe ushtarake serbe. Rreth 800 serbë, romë, dhe anëtarë të grupeve të tjera në pakicë, thuhet se janë rrëmbyer gjatë dhe pas luftës nga anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Amnesty International bën dallimin ndërmjet zhdukjeve me forcë, në të cilat janë të përfshirë direkt ose indirekt agjentët shtetërorë , dhe rrëmbimeve të kryera nga përfaqësues jo shtetërorë, si për shembull grupet opozitare të armatosura.

Në 1999 dhe 2000, Amnesty International intervistoi të afërmit e personave të zhdukur ose të rrëmbyer nga të dyja palët e konfliktit. Në vitin 2009 përfaqësuesit e organizatës u kthyen në Serbi dhe Kosovë për të zbuluar çfarë kishte ndodhur gjatë këtyre viteve. A ishin gjetur të afërmit që ishin zhdukur? A ishin kthyer trupat e tyre për t'u varrosur? A e dinin familjet çfarë i kishte ndodhur djalit, babait, vëllait, motrës, vajzës apo nënës së tyre? A ishin sjellë përgjegjësit para drejtësisë?

Amnesty International zbuloi një mungesë të theksuar progresi. Edhe pse trupat e afro gjysmës së viktimave të zhdukjeve dhe rrëmbimeve ishin gjetur dhe u ishin kthyer të afërmve, deri në prill 2009 afro 1911 familje në Kosovë dhe Serbi ende prisnin ndonjë lajm për fatin dhe vendndodhjen e anëtarit të familjes së tyre.[1] Në ato raste kur trupi i një anëtari të familjes ishte gjetur dhe i ishte kthyer familjes, po aq shqetësues ishte edhe fakti se pak familje kishin dijeni për hetimet penale nga policia, apo ndjekjen penale në Kosovë apo Serbi. Dhjetë vjet pas konfliktit të armatosur, përgjegjësit për zhdukjet dhe rrëmbimet me

forcë, nuk janë sjellë para drejtësisë.

Në këtë raport, të botuar me rastin e dhjetëvjetorit të përfundimit të luftës në Kosovë, Amnesty International ngre shqetësime që autoritetet në Kosovë dhe Serbi nuk i kanë respektuar detyrimet e tyre, ashtu sikurse parashikohen në të drejtën ndërkombëtare që zbatohet në Serbi dhe Kosovë, për të hetuar dhe ndjekur penalisht zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë dhe sjelljen para drejtësisë së autorëve të tyre prej të dy palëve. Raporti bën rekomandime të cilat kanë si qëllim t'i jepet fund mosndëshkimit të autorëve të këtyre veprave dhe u bën thirrje autoriteteve si në Serbi dhe Kosovë për t'u dhënë drejtësi të afërmve të personave të zhdukur.

**Mosndëshkim do të thotë pikërisht përjashtim nga ndëshkimi dhe dëmshpërblimet.**

Kur përdoret nga Amnesty International ky term i referohet mosdhënies së drejtësisë nga ana e shtetit për abuzimet e të drejtave të njeriut përmes hetimit, dhe, kur ka prova të mjaftueshme të pranueshme, përmes ndjekjes penale të autorëve të dyshuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe standardet ndërkombëtare, si dhe duke ofruar dëmshpërblim për lëndimet e pësuara nga viktimat. Të lejosh kryerjen e abuzimeve nga autorët e krimit, abuzime të cilat ndalohen qartësisht me ligj, pa asnjë lloj pasoje për ta, përjetëson krimet e tyre. Në të kundërt, sjellja e autorëve para drejtësisë, i transmeton shoqërisë mesazhin se abuzimet e të drejtave të njeriut nuk do të tolerohen, dhe si rrjedhim ndalon abuzimet e ardhshme. Mosndëshkimi i mohon dhënien e drejtësisë viktimave të abuzimeve të të drejtave të njeriut, duke i zhvatur sërish nga të drejtat e tyre. Mosndëshkimi u mohon viktimave dhe të afërmve të tyre të drejtën e paraqitjes dhe njohjes së të vërtetës, të drejtën e dhënies së drejtësisë, si dhe të drejtën e një zgjidhje ligjore të efektshme.

Raporti dokumenton se në këto dhjetë vjet, qeveria serbe dhe autoritetet përgjegjëse në Kosovë – deri ne dhjetor 2008 Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (inicialet në anglisht: UNMIK) – kanë dështuar në hetimin dhe ndjekjen penale të përgjegjësve të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë.

Raporti gjithashtu dokumenton rolin kontribuues të Forcave të Kosovës (KFOR) të drejtuara nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, (NATO), dhe Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (Tribunali) në këto dështime. Raporti zbulon një histori të padokumentuar zhvarrosjesh, një konfuzion të përpjekjeve të agjencive të ndryshme, dokumentacion të humbur, hetime të dështuara dhe ndërhyrje politike në sistemin e drejtësisë. Këta faktorë, të kombinuar me njeri-tjetrin, u kanë mohuar të afërmve të të zhdukurve të drejtën për të pasur qasje në drejtësi drejtësisë.

Raporti përfshin pjesë të shkëputura nga intervista me të afërmit e të zhdukurve. Këto intervista janë zhvilluar nga Amnesty International në 1999-2000 dhe 2009. Amnesty International ia dedikon këtë raport atyre dhe të gjithë të afërmve të të zhdukurve në Serbi dhe Kosovë dhe atyre të cilëve jetojnë gjetiu si refugjatë. Duke e bërë këtë, Amnesty International pranon se dhimbja dhe vuajtja e shkaktuar të afërmve nga dështimi i autoriteteve për t'ju treguar të vërtetën për fatin dhe vendndodhjen e anëtarëve të familjes së tyre, përbën në vetvete dhunim të të drejtave të njeriut: shkeljen e të drejtës së tyre për të qenë të lirë nga trajtimi mizor, çnjerëzor dhe degradues.

## LUFTËRAT NË KOSOVË DHE SERBI

Në 1999-ën Kosova ishte një krahinë e Republikës së Serbisë, e cila asokohe ishte një republikë brenda Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ).[2] Më herët, në vitin 1989, qeveria serbe i kishte revokuar Kosovës statusin e autonomisë, por në 1991-shin, pas një referendumi, shqiptarët kosovarë deklaruan pavarësinë e tyre. Pas kësaj vijoji thuajse një dekadë shkeljesh sistematike e të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës, kryesisht nga policia serbe.[3]

Nga mesi i viteve 1990, strategjia e shqiptarëve të Kosovës për rezistencë jo të dhunshme dhe institucione paralele nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, po sfidohej gjithnjë e më tepër nga disa shqiptarë të Kosovës të cilët filluan të marrin armët kundër forcave serbe. Në 1998-ën u rrit shpeshtësia dhe intensiteti i dhunimeve të të drejtave të njeriut, kryesisht të shqiptarëve të Kosovës, nga ana e RFJ-së, forcave serbe të sigurimit dhe paraushtarakëve serbë. Në Kosovë shpërtheu një konflikt i armatosur i brendshëm ndërmjet anëtarëve të UÇK-së e grupeve të tjera të armatosura, të cilat ishin formuar për të luftuar për një Kosovë të pavarur, dhe forcave të RFJ-së, policisë serbe e grupeve paraushtarake.

Pjesa më e madhe e viktimave të dhunimeve të të drejtave të njeriut ishin civilë me kombësi shqiptare etnikë. Këto dhunime përfshinin arrestime arbitrare, tortura ose keqtrajtime të pretenduara, vrasje të jashtëligjshme dhe sulme të tjera të qëllimshme dhe pa dallim kundrejt civilëve. Deri në qershor 1998, afro 60000 shqiptarë etnikë ishin larguar ose detyruar të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe ose ishin zhvendosur brenda Kosovës, ose kërkonin mbrojtje ndërkombëtare. Serbët gjithashtu vuajtën nga abuzime të të drejtave të njeriut, si për shembull rrëmbimet, rrahjet dhe ekzekutimet, të kryera nga grupet shqiptarësh etnikë të armatosur, përfshirë dhe UÇK-në.

Në fillim të vitit 1999, komuniteti ndërkombëtar, përfshirë në mënyrë të veçantë autoritetet e Shteteve të Bashkuara, mundësuan një seri takimesh në Rambuje të Francës, të cilat patën si qëllim të ndërmjetësonin një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet RFJ-së dhe përfaqësuesve shqiptarë etnikë nga Kosova. Dështimi i këtyre bisedimeve çoi në internacionalizimin e një konflikti të brendshëm të armatosur (ku komuniteti ndërkombëtar ndërhyri në atë që kishte qenë konflikt i brendshëm i armatosur). Në mars 1999, NATO filloi një fushatë bombardimi kundër forcave të RFJ-së, policisë dhe paraushtarakëve serbë. Qëllimi i deklaruar i kësaj ndërhyrje ishte shmangia e një katastrofe humanitare në Kosovë. Nga 24 marsi deri më 10, qershor fushata ajrore e NATO-s kundër RFJ-së, i quajtur Operacioni i Forcave Aleate, kreu afro 38000 fluturime luftarake, përfshirë 10484 fluturime goditëse kundër objekteve në Serbi, në provincat e Kosovës dhe Vojvodinës dhe Republikës së Malit të Zi, asokohe pjesë e RFJ-së.[4]

Megjithatë, dhunimet e të drejtave të njeriut nga forcat ushtarake të RFJ-së, policia dhe grupet paraushtarake serbe u shtuan në numër, dhe qindra e mijëra shqiptarë etnikë dhe anëtarë të komuniteteve në pakicë u larguan nga Kosova drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë ose u zhvendosën brenda Kosovës.

Fushata e dhunës së armatosur kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës, ndërmjet marsit dhe qershorit të vitit 1999, pati si qëllim largimin e njerëzve nga shtëpitë e tyre duke i urdhëruar haptas të largoheshin (përfshi këtu duke i detyruar të futeshin në trena për t'i dërguar në kufirin me Maqedoninë) ose duke krijuar një gjendje terrori për të shkaktuar

largimin e tyre. Më shumë se 9000 burra, gra dhe fëmijë, pjesa më e madhe e tyre civilë shqiptarë etnikë, u vranë nga forcat serbe. Të tjerë u morën nga shtëpitë e tyre dhe nuk u panë më, dhe shumë gra u përdhunuan ose iu nënshtruan formave të ndryshme të dhunës seksuale. Anekënd Kosovës, fshatra të tërë u granatuan dhe u bënë shkrumb e hi. Më 4 maj 1999, Zyra e Komisionerit të Lartë të KB për Refugjatët (inicialet në anglisht: UNHCR) e llogariste përafërsisht numrin e refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në më shumë se 677,000 duke përfshirë 396,000 në Shqipëri, 204,000 në Maqedoni dhe 62,000 në Mal të Zi.[5]

Në qershor 1999, NATO, pas përfundimit të Marrëveshjes Ushtarake Teknike (Marrëveshja e Kumanovës) me qeveritë e Republikave të Serbisë dhe të RFJ-së, pushoi fushatën e saj bombarduese.[6] Në përputhje me këtë marrëveshje forcat tokësore të NATO-s hynë në Kosovë dhe Ushtria Jugosllave (Vojska Jugoslavije, VJ) dhe policia e forcat paraushtarake serbe u tërhoqën nga Kosova para fundit të korrikut 1999.

## UNMIK-U DHE KFOR-I

Në qershor të vitit 1999-të me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244/99 (Rezoluta e KSKB 1244/99) u krijua Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ( UNMIK) me mandat administrimin e Kosovës. Në përputhje me Nenin 11(j) të kësaj rezolute, UNMIK-u ngarkohej me detyrën e "mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut." Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara theksoi më tej këtë detyrë duke thënë se: "Baza e ushtrimit të autoritetit të UNMIK-ut në Kosovë do të jenë standardet e të drejtave të njeriut të njohura në rang ndërkombëtar."[7]

Përgjegjësia e Forcave të Kosovës (KFOR) të udhëhequra nga NATO sipas Rezolutës 1244/99 ishte: "Krijimi i një mjedisi të sigurt ku refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpi të sigurt..."; "Garantimi i sigurisë dhe kthimi i papenguar i refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë"; dhe [krijimi] i kushteve për një jetë normale dhe paqësore për të gjithë banorët e Kosovës";[8] UNMIK-u dhe KFOR-i ngarkoheshin gjithashtu me rivendosjen e sundimit të ligjit.[9] Për më tepër, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP) nxori Rregulloren e UNMIK-ut 1/1999 më 25 korrik 1999, duke i dhënë UNMIK-ut pushtetin e nxjerrjes së akteve ligjore të cilat parashikojnë se personat me detyrë publike duhet të "respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut".[10]

## ZHDUKJET ME FORCË TË SHQIPTARËVE ETNIKË

M.K., një tregtar 32 vjeçar nga Vushtrri/Vučitrn,[11] që më parë kishte qenë gjeolog, ishte larguar nga Smrekonica/Smrekovnica në një kolonë me persona që zhvendoseshin vonë nga prilli i 1999-s. Në 3 maj policia dhe paraushtarakë serbë e rrethuan M.K. dhe grupin e tij së bashku me disa shqiptarë të tjerë etnikë në qendër të Smrekovnica/ Smrekonicës. Ai i tha Amnesty International se burrat dhe djemtë më të rritur i ndanë nga gratë dhe fëmijët dhe më pas i rrahën: "Ata zgjidhnin intelektualë, ata që merreshin me tregti, apo biznes. Më rrahën me një shufër hekuri derisa humba ndërgjegjen." M.K. tha se ai i njihte oficerët e policisë që komandonin : "Vinin në dyqanin tim gjithë kohën." Përmendi komandantin e policisë së Vushtrrisë/Vučitrn si "personin kryesor që kryente rrahjen e intelektualëve," dhe tha se shefi i tij urdhëronte rrahjet jashtë burgut. "Në fakt e dëgjova atë të jepte urdhra." M.K. iu referua dhe nofkave të dy oficerëve të tjerë të policisë që ishin pjesëmarrës.[12]

Më se 3,000 shqiptarë etnikë, pjesa më e madhe e tyre burra, por edhe gra dhe fëmijë, konsiderohen të kenë qenë viktima të zhdukjeve me forcë nga policia dhe forcat paraushtarake e ushtarake serbe.[13] Pjesa më e madhe e zhdukjeve u kryen nga marsi deri në qershor të vitit 1999, gjatë bombardimeve të NATO-s në Serbi dhe Kosovë. Në pjesën më të madhe të rasteve viktimat u panë për herë të fundit të arrestoheshin nga policia serbe. Shumë prej tyre u ndaluan në rrugë ose u morën nga kolonat e personave të zhvendosur brenda vendit kur largoheshin në drejtim të Shqipërisë apo Maqedonisë. Të tjerë u arrestuan në shtëpitë e tyre apo në shtëpitë e të afërmve të tyre, ku ishin strehuar si refugjatë. Disa prej këtyre arrestimeve thuhet se u shoqëruan me keqtrajtime. Zakonisht burrat i ndanin nga gratë, fëmijët dhe të moshuarit dhe dërgoheshin në këmbë apo me makinë gjetiu. Në disa raste burrat çoheshin vetëm pak më larg para se të vriteshin, ndërsa në raste të tjera merreshin në stacionet e policisë apo në qendrat e improvizuara të ndalimit në Kosovë. Hetimet kanë treguar se disa prej këtyre të ndaluarve u liruan, të tjerë u dërguan në burgjet e Serbisë, kurse një pjesë tjetër u vranë në ndalim.[14]

Persona të tjerë që u gjetën më vonë të vrarë në shtëpitë e tyre konsiderohen gjithashtu si viktima të zhdukjeve me forcë; trupat e tyre ishin midis atyre të paktën 800 kufomave që u zhvendosën nga Kosova prej policisë serbe dhe u transportuan në Serbi, ku u varrosën gjatë një operacioni masiv për fshehjen e gjurmëve.

Trupat e afro gjysmës së këtyre shqiptarëve etnikë që në 1999-ën besoheshin të ishin viktimat e zhdukjeve me forcë, më pas u gjetën. Por në 2009-ën,fati dhe vendndodhja e mbi 1300 shqiptarëve etnikë, të cilët u panë për herë të fundit në duart e forcave serbe, mbetet ende për t'u zbuluar.

## RRËMBIMET E SERBËVE, ROMËVE, DHE ANËTARËVE TË KOMUNITETEVE TË TJERA NË PAKICË

Tërheqja e VJ-së dhe policisë serbe nga Kosova, nga qershori në korrik 1999, u shoqërua me keqësimin e situatës së abuzimeve të të drejtave të njeriut të kryera nga grupe të armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Serbë, romë dhe anëtarë të grupeve të tjera etnike në pakicë (përfshirë këtu dhe shqiptarë të Kosovës që perceptoheshin si të lidhur me autoritetet serbe) u rrëmbyen apo u vranë. U përdhunuan gra dhe u dogjën shtëpi. Në atë kohë Amnesty International shprehu shqetësimin e saj për këto abuzime të të drejtave të njeriut dhe i kërkoi KFOR-it të bënte më të mirën e mundshme për mbrojtjen e pakicave në Kosovë, në përputhje me mandatin e tij "për krijimin e një ambienti të sigurt në Kosovë". Në mungesë të çdo autoriteti për zbatimin e ligjit – policia serbe u largua së bashku me VJ-në – Amnesty International i kërkoi të gjitha shteteve kontribuuese në UNMIK të punësonin me një farë urgjence policë civilë të trajnuar në fushën e standardeve të të drejtave të njeriut dhe të vendosnin sundimin e ligjit si dhe të mbronin të drejtat e njeriut të popullsisë civile.[15]

Nga fundi i gushtit 1999, pjesa më e madhe e shqiptarëve të Kosovës që ishin larguar apo dëbuar me forcë në Shqipëri apo Maqedoni nga forcat serbe, u kthyen në Kosovë. Shumë prej tyre zbuluan se anëtarët e familjes ose ishin zhdukur ose kishin vdekur dhe se shtëpitë e tyre ishin dëmtuar dhe shkatërruar me kast nga forcat serbe. Disa nga abuzimet e të drejtave të njeriut kundër anëtarëve të komuniteteve në pakicë mund të jenë kryer nga individë apo komunitete që kërkonin hakmarrje ndaj fqinjëve të tyre. Provat gjithashtu tregojnë se pas qershorit të 1999-s, grupe të armatosura të shqiptarëve të Kosovës kishin rregullisht në shënjestër anëtarë të komuniteteve serbe dhe rome.

Qeveria serbe mori qëndrimin zyrtar të inkurajimit të serbëve për të qëndruar në Kosovë, por mijëra serbë ishin larguar dhe vendosur në Serbi, madje para se policia serbe dhe VJ-ja të tërhiqeshin tërësisht nga Kosova. Më se 230000 serbë dhe pakica të tjera u larguan nga Kosova nga fundi i gushtit 1999.[16] Pjesa më e madhe e atyre që mbetën u vendosën në komunat apo enklavat mono-etnike brenda në Kosovë.

## MOS-SIGURIMI I MBROJTJES

Shumë prej serbëve të cilët qëndruan në Kosovë pasi u larguan VJ-ja dhe policia serbe, vepruan kështu pasi besuan se KFOR-i dhe UNMIK-u do t'i mbronte. Shumë prej tyre u rrëmbyen dhe u vranë para syve të KFOR-it.

Andrija Tomanoviq qëndroi në kryeqytetin Prishtinë, duke vazhduar punën si mjek kirurg në Spitalin e Prishtinës, ku kishte punuar për 36 vjet. Më 24 qershor 1999 u rrëmbye jashtë spitalit nga një grup burrash që e tërhoqën zvarrë, e futën në një makinë dhe u larguan. Ai nuk është parë që prej asaj kohe. Gruaja e tij i tha Amnesty International: *"Bashkëshorti im i ishte dedikuar shpëtimit të jetëve, pavarësisht nga kombësia apo besimi i tyre fetar. Ai ishte një burrë i shkëlqyer dhe jam shumë krenare për të: një humanist, kirurg, anëtar i shoqatës së mjekëve. Qëndroi këtu për të vazhduar punën; besonte se Rezoluta [e KSKB-së] 1244 kishte një farë kuptimi."*[17]

Në shtator 1999, Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë dhe RFJ-në deklaroi: "Në mungesë të ligjit dhe rendit publik, në Kosovë ndodhën dhunime të të drejtave të njeriut pothuaj pa asnjë ndëshkim, pavarësisht nga përpjekjet e UNMIK-ut për krijimin e një gjyqësori të përkohshëm. Vrasje, rrëmbime, shkatërrime pronash, në mënyrë të veçantë djegia e shtëpive, dhe zhvendosjet e vazhdueshme të jo-shqiptarëve dhe shqiptarëve të Kosovës që ishin 'të dyshuar politikë' pasqyrojnë dështimin e komunitetit ndërkombëtar për të vendosur territorin nën kontroll, për të vendosur paqen, për të siguruar shërbimet bazë dhe mbrojtje nga ana e qeverisë."[18]

Pavarësisht nga përgjegjësitë e vendosura nga KSKB për UNMIK-un dhe KFOR-in për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, sulmet ndaj anëtarëve të komuniteteve në pakicë vazhduan të bëheshin përditë pas qershorit 1999. Në tetor 1999, Amnesty International raportoi se "atmosfera e mungesës së tolerancës në Kosovë e karakterizuar nga frikësimi, ngacmimi dhe diskriminimi ka rezultuar në një kufizim të rëndë të lirisë së lëvizjes dhe ka penguar aksesin në shërbimet kryesore si shërbimi shëndetësor, edukimi, për shumë komunitete në pakicë... Viktimat e këtyre abuzimeve janë shpesh të moshuarit ose personat e sëmurë të cilët nuk kanë mundësi, apo nuk dëshirojnë të largohen nga shtëpitë e tyre."[19]

Numri i personave të vrarë ose numri i personave që besohet të jenë rrëmbyer nga shqiptarë të Kosovës në vijim të konfliktit të armatosur në Kosovë mbetet i kontestueshëm, me mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet numrave të cituara nga autoritete të ndryshme. UNMIK-u raportohet të ketë thënë në shtator 1999 se gjatë tre muajve, që prej qershorit 1999, ishin vrarë gati 170 serbë, por Ministri i Jashtëm i RFJ-së, Zhivadin Jovanoviq, në një konferencë shtypi të mbajtur në Nju Jork më 28 shtator, e ngriti këtë numër deri në 400.[20] Më 10 dhjetor 1999 KFOR-i raportonte se, që nga fundi i qershorit 1999, ishin vrarë 414 individë – 150 shqiptarë etnikë, 140 serbë dhe 124 persona kombësia e të cilëve është e paditur.[21]

Ndonëse rastet e rrëmbimeve dhe vrasjeve u pakësuan me largimin dhe zhvendosjen e popullsisë në pakicë, rrëmbime vazhdonin të raportoheshin deri të paktën në vitin 2000. Në Kosovë u rrëmbyen afro 800 serbë, romë, ashkali, boshnjakë dhe anëtarë të komuniteteve të tjera në pakicë.[22]

Marijan Melonashi ishte një gazetar në departamentin serb të Radio Televizionit Kosovar (RTK). Si person me kombësi të përzier serbe dhe shqiptare, ai punonte gjithashtu edhe për Radio Kontakt, një radio multi-etnike. Për herë të fundit u pa tek largohej nga zyra e RTK-së në Prishtinë, rreth orës 14:00 të datës 9 shtator 2000. Sapo kishte përfunduar programin ditor gjysmë orësh në gjuhën serbe. Sipas një tregtari përballë , ai kishte marrë një taksi ngjyrë portokalli në Rrugën Nënë Tereza, rruga kryesore në Prishtinë. Kolegët dhe shokët dyshonin se e kishin rrëmbyer pasi fliste serbisht publikisht në Prishtinë. Nëna e tij tregon: "*Ai ishte 24 vjeç, lindi atje, jetoi atje dhe dëshironte të qëndronte atje.*"[23] Gjyshi, me të cilin jetonte Marijan Melonashi, ndërmori masa të menjëhershme për ta gjetur. Ai kontaktoi Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) e policinë e UNMIK-ut dhe takoi Hashim Thaçin, asokohe anëtar i Këshillit Administrativ të Përkohshëm, si dhe Bernard Kouchner, Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), që atëherë kryesonte UNMIK-un. Organizata ndërkombëtare gazetarësh i bën gjithashtu apel autoriteteve ta gjenin gazetarin. Marijan Melonashi nuk është parë që prej shtatorit të vitit 2000, trupi i tij nuk u gjend kurrë; asnjë person nuk është sjellë para drejtësisë.

Amnesty International gjykon se, në përfundim të konfliktit të armatosur, komuniteti ndërkombëtar kishte një mungesë të mjerueshme përgatitjeje, për të njohur mundësinë për abuzime të të drejtave të njeriut të pakicave dhe për marrjen e masave për të adresuar këto abuzime.[24]

# 2. NJË DHUNIM I VAZHDUESHËM I TË DREJTAVE TË NJERIUT: KUADRI LIGJOR

## LIGJI NDËRKOMBËTAR I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Amnesty International gjykon se zhdukje me forcë kryhet në çdo rast kur ka baza të arsyeshme për të besuar se:

- një personi i është mohuar liria (përfshi këtu për shkak të një arresti, ndalimi apo rrëmbimi)

- kjo është kryer nga agjentë shtetërorë apo me miratimin, pranimin e heshtur, autorizimin apo mbështetjen e shtetit,

- dhe më pas autoritetet mohojnë se viktima është e arrestuar, apo mbulojnë a refuzojnë të paraqesin informacion lidhur me vendndodhjen dhe fatin e personit, duke e pozicionuar personin jashtë ashtë kuadrit të mbrojtjes ligjore.[25]

Në ato raste kur një personi apo disa personave u është mohuar liria nga aktorë jo-shtetërorë (duke përfshirë grupet e armatosura) organizata i gjykon ata të rrëmbyer.
Zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë përbëjnë krime në të gjitha llojet e rrethanave.

Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, veprimet përbërëse të zhdukjes me forcë konsiderohen se përbëjnë vepër penale për sa kohë përgjegjësit vazhdojnë të fshehin fatin dhe vendndodhjen e individit e faktet vazhdojnë të jenë të paqartësuara.[26]

Sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, zhdukja me forcë është një shkelje e rëndë, ndërmjet të tjerash, e së drejtës së njohjes si person para ligjit, të drejtës për lirinë dhe sigurinë e personit, dhe ndalimit të torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese të garantuara nga Nenet 16, 9, dhe 7 të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) dhe Nenet 5 dhe 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ). Zhdukjet me forcë përbëjnë një kërcënim të rëndë të integritetit fizik të personit dhe shpesh përfundojnë në vrasje të jashtëligjshme, në kundërshtim me të drejtën e jetës (të garantuar nga Neni 6 i KNDCP-së dhe Neni 2 i KEDNJ-së). Këto zhdukje dhunojnë të drejtën e viktimës dhe të familjes së tyre për jetë familjare (Neni 17 i KNDCP-së dhe Neni 8 i KEDNJ-së). Duke pasur parasysh që zhdukjet me forcë mund të shkelin në të njëjtën kohë një numër të drejtash të njeriut, ato referohen si shkelje "të shumëfishta" apo "të njëpasnjëshme" të drejtave të njeriut.

Në kohën e konfliktit në 1988-9 RFJ-a (që përfshinte Serbinë dhe Kosovën) ishte palë e KNDCP-së. Serbia dhe Mali i Zi nuk u bënë palë e KEDNJ-së deri në 2004-ën.[27] KEDNJ-ja u njoh si pjesë e legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë pas qershorit 1999.[28]

Kur zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë kryhen brenda kuadrit të një konflikti të armatosur, si në rastin e Kosovës, ato shkelin gjithashtu të drejtën ndërkombëtare humanitare (që qeveris konfliktin e armatosur) e cila zbatohet paralelisht me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Këto zhdukje dhe rrëmbime shkelin, apo shpesh përfundojnë në shkeljen e dispozitave ndaluese të parashikuara në të drejtën ndërkombëtare humanitare, përfshi këtu torturën dhe trajtime të tjera çnjerëzore, vrasjen, dhe të drejta të tjera të personave të cilëve u është mohuar liria.[29]

Amnesty International gjykon se zhvendosjet dhe rrëmbimet me forcë, të kryera në kuadrin e konfliktit të armatosur në Kosovë, përbëjnë krime lufte. Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, praktika e përhapur gjerësisht ose rregullisht e zhdukjeve apo rrëmbimeve me forcë të drejtuara kundër popullsisë civile, duke pasur dijeni për këtë sulm, përbën krime kundër njerëzimit.[30]

Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (Tribunali) nuk përfshin shprehimisht krimin specifik të zhdukjes me forcë, por njeh juridiksionin e Tribunalit për ndjekjen penale të krimeve të cilat janë përbërëse të zhdukjes dhe rrëmbimit me forcë, përfshi këtu: në përputhje me Nenin 2 si shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës (krime lufte): izolimin e paligjshëm; torturën apo trajtimin çnjerëzor; vrasjen e qëllimshme të një personi të mbrojtur; sipas Nenit 5, si krime kundër njerëzimit, kur kryhen në një konflikt të armatosur kundër popullsisë civile: vrasjen, torturën, dhe veprime të tjera të panjerëzishme, burgosjen; dhe sipas Nenit 3: shkeljen e ligjeve dhe zakoneve të luftës.

Kështu, në rastet e zhdukjeve me forcë të shqiptarëve etnikë, Tribunali ka akuzuar dhe dënuar zyrtarë të RFJ-së dhe Serbisë për krime kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës.[31] Shqiptarë të Kosovës të përfshirë në rrëmbimin e serbëve, romëve dhe shqiptarëve të tjerë janë akuzuar nga Tribunali për krime kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës, duke përfshirë burgimin, trajtimin çnjerëzor dhe vrasjen. Këto çështje diskutohen në kapitullin 4 në vijim.[32]

Ligjet e zbatueshme në Serbi dhe Kosovë nuk kriminalizonin shprehimisht zhdukjen me forcë, por kriminalizonin veprimet përbërëse të saj. Në gjykatat serbe, akuzat lidhur me zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë (nga shqiptarët etnikë) kanë përfshirë: vrasje, sulme kundër popullsisë civile që kanë sjellë si pasojë vdekjen, torturën, trajtimin çnjerëzor, shkaktimin e dëmtimeve trupore, përdhunimin, ndalimin e paligjshëm dhe mohimin e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.[33] Në gjykatat e Kosovës akuzat lidhur me rrëmbimet përfshijnë vrasjen, rrëmbimin, dhe "terrorizmin."[34]

Autoritetet kanë si detyrë të fillojnë menjëherë hetime të pavarura, të paanshme dhe të plota lidhur me pretendimet e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë, ose kurdoherë kur ka baza të arsyeshme për të besuar se këto zhdukje apo rrëmbime kanë ndodhur.[35] Qëllimi i hetimit është sigurimi i një zbatimi të efektshëm të ligjeve që mbrojnë të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit, që ndalojnë torturën dhe që mbrojnë të drejtën e jetës, si dhe për të siguruar llogaridhënien e përgjegjësve për shkeljet e këtyre të drejtave. Hetimi duhet të jetë i

efektshëm, që do të thotë se hetimi duhet të jetë në gjendje të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.[36]

Standardet ndërkombëtare kërkojnë gjithashtu që, kur të jetë e nevojshme autoritetet të marrin masa për tu siguruar që ankuesi, dëshmitarët, apo të afërmit, si dhe personat që marrin pjesë në hetim dhe avokatët, të jenë të mbrojtur nga veprimet hakmarrëse dhe frikësimi për shkak të ankesës së bërë, apo dhënies së ndonjë dëshmie.[37]

**Detyrimi për hetim dhe ndjekje penale parashikohet në Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë.***

Neni 3: Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për hetimin e veprimeve të përkufizuara në Nenin 2 [shih përkufizimin më sipër], të kryera nga persona apo grupe personash që kanë vepruar pa autorizimin, mbështetjen dhe pranimin e heshtur të Shtetit dhe për sjelljen e përgjegjësve para drejtësisë.

Neni 12 (1): Çdo Shtet Palë duhet të sigurojë se çdo individ që pretendon se një person ka qenë subjekt i një zhdukjeje me forcë, gëzon të drejtën t'i raportojë faktet tek autoritetet kompetente, të cilat duhet t'i shqyrtojnë pretendimet menjëherë dhe në mënyrë të paanshme dhe, nëse është e nevojshme, të kryejnë pa vonesë një hetim të plotë dhe të paanshëm. ... (2). Nëse ka baza të arsyeshme për të besuar se një person ka qenë subjekt i zhdukjes me forcë, autoritetet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni, do të hetojnë edhe në mungesë të një ankese zyrtare.

Neni 9 (1): Çdo Shtet Palë do të ndërmarrë masat e nevojshme për të përcaktuar kompetencën e vet për ushtrimin e juridiksionit lidhur me veprën e zhdukjes me forcë: (a) Nëse vepra është kryer në ndonjë territor nën juridiksionin e tij ... (b) Nëse autori që pretendohet të ketë kryer veprën është një prej qytetarëve të tij.

* Serbia e nënshkroi Konventën më 6 shkurt 2007, por ende nuk e ka ratifikuar.

Moskryerja nga ana e autoriteteve përkatëse e hetimeve të menjëhershme, të paanshme, të pavarura dhe të plota lidhur me raportimet për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë në Kosovë dhe mos-sjellja para drejtësisë e personave përgjegjës, përbën shkelje të së drejtës së lirisë dhe sigurisë së personit, të së drejtës së jetës, dhe të së drejtës për të mos iu nënshtruar torturës dhe ndonjë keqtrajtimi tjetër, ashtu sikurse parashikohet në KNDCP-në dhe të KEDNJ-në si dhe të së drejtës për të pasur një zgjidhje ligjore të efektshme për çështjen e tyre, e drejtë e garantuar (përkatësisht) nga Nenet 9, 6, 7 dhe 2 i KNDCP-së dhe Nenet 5, 2, 3 dhe 13 të KEDNJ-së.

## TË DREJTAT E TË AFËRMVE

*"Jemi ne, shokët dhe të afërmit; ne jemi viktimat e këtij krimi."* D.M., një grua serbe e Kosovës, djali 17 vjeçar i së cilës, i quajtur Ivan, u rrëmbye në Kosovë më 19 gusht 1999.

Neni 24 i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë përkufizon viktimat si "personi i zhdukur dhe çdo individ i cili ka pësuar një dëm si pasojë e drejtpërdrejtë e zhdukjes me forcë."

Neni 8 i Parimeve dhe Udhëzimeve Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën për Zgjidhje Ligjore dhe Dëmshpërblim të Viktimave të Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe

Shkeljeve Serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, parashikon: "Për qëllimet e këtij dokumenti, viktima janë personat të cilët individualisht apo kolektivisht kanë pësuar dëme, përfshirë këtu dëmtime fizike apo mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike apo dëmtime rrënjësore të të drejtave themelore, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, apo shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Kur është e përshtatshme, dhe në përputhje me legjislacionin vendas, shprehja "viktimë" përfshin gjithashtu anëtarë të ngushtë të familjes, ose personat në ngarkim të viktimës së drejtpërdrejtë dhe personat të cilët kanë pësuar dëme gjatë ndërhyrjes për të ndihmuar viktimën në fatkeqësi, apo për të shmangur viktimizimin."

Anëtarët e familjeve të personave të zhdukur dhe të rrëmbyer mund të konsiderohen gjithashtu viktima, një fakt i pasqyruar dhe në të drejtën ndërkombëtare. Sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, anëtarët e familjes që kanë mbijetuar, kanë të drejtën të informohen për progresin dhe rezultatet e hetimit dhe fatin e personit të zhdukur apo të rrëmbyer.[38]

Amnesty International gjykon se mos-informimi nga ana e autoriteteve i anëtarëve të familjes për fatin dhe vendndodhjen e një personi që është subjekt i zhdukjes me forcë, dhe qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve si dhe moskryerja nga ana e tyre e hetimeve të menjëhershme, të paanshme, të pavarura dhe të plota mbi çështjet e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë, mund të përbëjnë shkelje të së drejtës së anëtarëve të familjes për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe degradues (në përputhje me Nenin 7 të KNDCP-së dhe Nenit 3 të KEDNJ-së).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se dështimi i vazhdueshëm i shtetit për të hetuar çështjet e personave të zhdukur pas një ndërhyrjeje ushtarake, gjatë së cilës shumë persona janë vrarë ose marrë si të burgosur dhe atje ku zona më pas u mbyll dhe të afërmit nuk kishin më qasje në të, solli si pasojë shkeljen e vazhdueshme të së drejtës për t'u mbrojtur nga tortura dhe keqtrajtimet e tjera siç parashikohet nga Nenin 3 i KEDNJ. Gjykata parashtroi se "heshtja e autoriteteve të Shtetit të paditur karshi shqetësimeve reale të të afërmve të personave të zhdukur arriti një shkallë ashpërsie e cila mundet të kategorizohet vetëm si trajtim çnjerëzor në kuptimin e Nenit 3."[39]

Për me tepër, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të afërmit e personave të zhdukur dhe të rrëmbyer në kuadrin e konfliktit të armatosur në Kosovë, abuzime [zhdukjet dhe rrëmbimet] të cilat përbëjnë përkatësisht shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ose shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, kanë të drejtën e qasjes së barabartë në drejtësi dhe të një dëmshpërblimi të përshtatshëm dhe të efektshëm, në përpjesëtim me ashpërsinë e krimeve të kryera dhe dëmeve të pësuara.

Parimet dhe Udhëzimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën për Zgjidhje Ligjore dhe Dëmshpërblim të Viktimave të Shkeljeve të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve Serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare rendisin pesë forma dëmshpërblimi: kthimin, kompensimin, rehabilitimin, përmbushjen e kërkesave dhe garancitë e mospërsëritjes.[40]

Ashtu sikurse shtjellohet më poshtë, Amnesty International gjykon se autoritetet përkatëse në Serbi dhe Kosovë në shumicën e rasteve nuk u janë përmbajtur detyrimeve të tyre sipas së drejtës ndërkombëtare: për të siguruar hetimin e efektshëm të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë të cilat ndodhën gjatë konfliktit në Kosovë dhe në vijim të tij; për të sjellë para

drejtësisë personat përgjegjës në procedime të drejta dhe për të siguruar një dëmshpërblim të përshtatshëm të të afërmve. Ndërmjet të tjerash, kjo është edhe pikëpamja e Komitetit të të Drejtave të Njeriut, organ i pavarur ekspertësh që monitoron zbatimin e KNDCP-së ana e Shteteve Anëtare.

## MOSRESPEKTIMI NGA SERBIA DHE UNMK-U I DETYRIMEVE TË TYRE NDËRKOMBËTARE

Në qershor 2004, në vijim të ekzaminimit nga KNDCP-ja të zbatimit të detyrimeve prej Serbisë dhe Kosovës, Komiteti i të Drejtave të Njeriut[41] shprehu shqetësimin e tij për mosndëshkimin në vazhdimësi të krimeve të luftës, përfshi këtu, rastet e zhdukjeve me forcë, dhe i bëri rekomandime të ashpra shtetit palë:

9. Komiteti është i shqetësuar për vazhdimin e mosndëshkimit të shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut si para dhe pas ndryshimeve të tetorit 2000. Edhe pse Komiteti e vlerëson politikën e deklaruar të Shtetit palë për të kryer hetime dhe ndjekje penale të autorëve të shkeljeve të mëparshme të të drejtave të njeriut, Komiteti ndien keqardhje për numrin e pakët të hetimeve serioze qe kanë sjellë si pasojë ndjekje penale dhe dënime në përpjesëtim me ashpërsinë e krimeve të kryera (nenet 2, 6, 7). **Shteti palë është i detyruar të hetojë tërësisht të gjitha rastet e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut, në veçanti shkeljet e neneve 6 dhe 7 të Konventës gjatë viteve të 1990-ës dhe të sjellë para drejtësisë personat të cilët dyshohen të kenë qenë përfshirë në këto shkelje. Shteti palë duhet t'i sigurojë viktimave dhe familjeve të tyre një kompensim të përshtatshëm për shkeljet. Personat që pretendohet të kenë kryer shkeljet serioze duhet të pezullohen nga detyrat publike gjatë hetimit të pretendimeve dhe nëse deklarohen fajtor, veç ndonjë ndëshkimi tjetër, të përjashtohen gjithashtu nga shërbimi publik.**

10. Ndonëse Komiteti vëren punën e efektshme të kryer për zhvarrimet dhe autopsitë e 700 kufomave nga varret masive në Batajnica, Komiteti është i shqetësuar për mungesën e progresit të hetimeve dhe ndjekjeve penale të autorëve të këtyre krimeve (nenet 2, 6.) **Shteti palë duhet që, së bashku me procesin e zhvarrimit, të fillojë menjëherë hetimet për veprimet penale të dukshme të cilat përfshijnë shkeljen e Konventës. Nevojat e veçanta të të afërmve të personave të pagjetur dhe të zhdukur duhet po ashtu të adresohen nga Shteti anëtar, duke përfshirë këtu dhe parashikimin e një dëmshpërblimi të përshtatshëm.**[42]

Po ashtu në vitin 2006, pasi bëri vlerësimin e zbatimit të KNDCP-së në Kosovë nga UNMIK-u,[43] Komiteti i të Drejtave të Njeriut shprehu shqetësime të ngjashme me sa më sipër lidhur me dështimin e UNMIK-ut për të adresuar mosndëshkimin, përfshirë këtu mosndëshkimin për "të gjitha rastet e zhdukjeve dhe rrëmbimeve." Komiteti i të Drejtave të Njeriut i bëri UNMIK-ut vërejtjet dhe rekomandimet e mëposhtme:

12. Komiteti është i shqetësuar lidhur me mosndëshkimin në vazhdimësi që gëzojnë autorët e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimi para mandatit të UNMIK-ut dhe lidhur me krimet e kryera për motive etnike nga qershori 1999, përfshi këtu krimet e kryera në mars 2004, si dhe dështimin për të hetuar me efektshmëri shumë prej këtyre krimeve dhe për të sjellë autorët e tyre para drejtësisë. Komiteti ndien keqardhje që UNMIK-u nuk ka bashkëpunuar plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. (nenet 6, 7, 2(3)) **UNMIK-u në bashkëpunim me IPVQ duhet të hetojë rastet e pazgjidhura të krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të kryera për motive etnike para dhe pas 1999-ës, duke përfshirë këtu dhe rastet kur autorët e krimeve mund të kenë qenë shqiptarë të Kosovës dhe të sigurojë sjelljen e autorëve të këtyre krimeve para drejtësisë si dhe të sigurojë kompensimin e**

**përshtatshëm të viktimave. UNMIK-ut duhet të sigurojë programe për mbrojtjen e dëshmitarëve, përfshi këtu dhe ndryshimin e vendbanimit të tyre, dhe t'u ofrojë bashkëpunim të plotë prokurorëve të TPNJ-së.**

13. Komiteti, ndonëse e pranon punën e kryer nga Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësinë Ligjore, është i shqetësuar se afro 1,713 shqiptarë etnikë dhe 683 jo shqiptarë, përfshi këtu serbë, romë, ashkali dhe egjiptianë, vazhdonin të raportoheshin si të zhdukur në maj 2006, dhe se Njësia e Personave të Pagjetur e policisë së UNMIK-ut, që prej 2003-it Njësia Qendrore për Hetime Penale, pak prioritet i kishin dhënë hetimit të zhdukjeve dhe rrëmbimeve dhe, në rastet e mbyllura të zhdukjeve dhe rrëmbimeve, autorët e veprave penale rrallë, nëse kishte ndodhur ndonjëherë, ishin ndjekur penalisht dhe sjellë para drejtësisë. (nenet 6, 7 dhe 2(3)) **UNMIK-u në bashkëpunim me IPVQ duhet të hetojë të gjitha rastet e pazgjidhura të zhdukjeve dhe rrëmbimeve dhe të sjellë autorët e këtyre veprave para drejtësisë. UNMIK-u duhet t'i sigurojë të afërmve të personave të zhdukur dhe të rrëmbyer qasje në informacionin lidhur me fatin e viktimave si dhe kompensim të përshtatshëm.**[44]

# 3. GJETJA E TRUPAVE: ZHVARRIMET DHE IDENTIFIKIMET

Amnesty International është e shqetësuar që autoritetet si në Serbi, ashtu edhe në Kosovë vazhdojnë të mos përcaktojnë dhe bëjnë publike vendndodhjen e më shumë se 1900 personave të listuar si të zhdukur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK). Ky numër përfshin personat të cilët kanë qenë subjekt i zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë, si gjatë konfliktit të armatosur, dhe në vijim të tij. E drejta e të afërmve për tu informuar për fatin dhe vendndodhjen e anëtarëve të familjes që kanë pësuar zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë, njihet nga standardet e ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe parashikohet nga Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë.

Si në rastet e zhdukjeve, ashtu edhe në ato të rrëmbimeve me forcë, autoritetet janë të detyruara të hetojnë në mënyrë të efektshme të gjitha raportimet e besueshme që kanë marrë për këto krime. Amnesty International e konsideron mosgjetjen e vendndodhjes së eshtrave të të zhdukurve dhe të rrëmbyerve si një pengesë serioze për hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre krimeve.

Edhe pse disa të afërm vazhdojnë të shpresojnë se i dashuri i tyre i zhdukur është ende gjallë, në pjesën dërrmuese të rasteve, viktimat e zhdukjeve ose rrëmbimeve me forcë që janë ende të humbur, mund të prezumohen tashmë të vdekur. Si rrjedhim, procesi i zbulimit të fatit të çdo personi të zhdukur, fillon me zhvarrosjen dhe identifikimin e eshtrave të tij ose saj. E megjithatë, sipas KNKK-së në prill 2009 ende nuk janë gjetur eshtrat e afro 1911 personave të regjistruar si të zhdukur pas konfliktit në Kosovë.

Për familjet e viktimave të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë, kthimi i trupit për varrim është hapi i parë drejt dhënies së drejtësisë. Sipas pikëpamjes së disa familjeve, ky është hapi më i rëndësishëm.

Ky kapitull identifikon autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për gjurmimin e personave të raportuar si të zhdukur pas konfliktit të armatosur, për përcaktimin e vendndodhjeve të varreve dhe zhvarrimit të tyre në Kosovë dhe Serbi, dhe me tej, për identifikimin e eshtrave. Ai tregon se si kanë dalë pengesa të konsiderueshme për sigurimin e provave për hetimin penal të rasteve, për shkak të morisë së institucioneve që kanë marrë raportime lidhur me personat e zhdukur, në veçanti menjëherë pas luftës në Kosovë; si dhe veprimet e qëllimshme të fshehjes së provave nga ana e autoriteteve serbe, si dhe dështimin e të gjitha autoriteteve për të pajisur hetuesit me prova. Ky kapitull tregon gjithashtu se si mungesa e vazhdueshme e sigurisë lidhur me numrin e personave të raportuar si të humbur apo të zhvarrosur dhe problemet lidhur me identifikimin kanë vonuar dhënien e eshtrave të të zhdukurve dhe të të rrëmbyerve të afërmve të tyre.

## ROLI I KNKK-SË

Përgjegjësia e KNKK-së për gjetjen e personave të zhdukur pas konfliktit të armatosur bazohet në parashikimet e bëra në Nenin 26 të Konventës së Katërt të Gjenevës dhe Nenit

33(3) të Protokollit I të Konventave të Gjenevës lidhur me konfliktet ndërkombëtare të armatosura që i japin të drejtën KNKK-së të kryejë kërkime lidhur me vendndodhjen e personave të zhdukur.[45]

KNKK-ja në Kosovë, ashtu sikurse dhe në vende të tjera të rajonit, mbledh sistematikisht kërkesa nga familjet e personave të zhdukur për gjetjen e tyre, si dhe informacione për periudhën para vdekjes së tyre, përfshi këtu datën e zhdukjes apo të rrëmbimit me forcë të personit. Ky informacion më pas i paraqitet autoriteteve përkatëse në emër të familjeve. Sipas KNKK-së, autoritetet kanë përgjegjësi ligjore për të dhënë informacion lidhur me vendndodhjen e personave të zhdukur.

Menjëherë pas luftës, numri i personave të zhdukur në Kosovë të regjistruar fillimisht me KNKK-në ishte afro 5165. Në total KNKK-ja hapi 6001 kërkesa gjurmimi. Disa prej të zhdukurve prej asaj kohe janë gjetur gjallë, përfshi këtu afro 1400 shqiptarë të Kosovës, të cilët nga fundi i marsit deri në fillim të qershorit 1999, mbaheshin nga forcat serbe në Kosovë, para se të transferoheshin në burgjet e Serbisë. Nga viti 2001, pjesa më e madhe e këtyre të ndaluarve u lirua.

Në maj 2000 KNKK-ja botoi për herë të parë *Librin e të Humburve,* i cili rendiste afro 3525 persona situata e të cilëve mbetet e pashpjeguar, përfshi këtu afro 300 jo-shqiptarë.[46] Në prill 2001, pasi KNKK-ja mori raportime të tjera, numri i jo-shqiptarëve të regjistruar si të rrëmbyer u rrit në 500.[47]

## PAQARTËSI KOMPETENCASH

Dëshmi e Nesrete Kumnovës, djali i së cilës Albioni, 21 vjeç, u mor nga policia serbe prej shtëpisë së saj në Gjakovë/Dakovica në 31 mars 1999, së bashku me pesë persona të tjerë.

*"Pashë makinën e policisë që kaloi pranë. Ngrita dorën dhe i dola makinës përpara meqenëse M.M. ndodhej brenda në makinë. Ajo më tha 'A je ti Nesrete?' I thashë që djali im dhe pesë burra të tjerë ishin rrëmbyer. Më pyeti kush i mori me vete dhe iu përgjigja se i mori policia serbe. Ajo më pyeti nëse i kisha dokumentet e djalit për të kontrolluar nëse ishte i përzier me diçka, kështu që i dhashë dokumentin e identifikimit. Të nesërmen shkova bashkë me motrën për të takuar M.M. dhe kërkova ta takoja. Nuk guxoi të më tregonte dokumentin e identifikimit të Albionit në prani [të një oficeri tjetër të policisë], por më mori në oborr dhe më tha, 'Djali yt është tërësisht i pastër, por ndoshta është dërguar diku në Shqipëri.' I thashë që ai nuk ka para me vete kështu që nuk mund të shkonte në Shqipëri. Atëherë më tha që -nuk kishte nevojë për para për të shkuar atje, por ndoshta mund ta kishin dërguar në Pejë. E pyeta nëse njihte njeri në Pejë që mund të më jepte informacion dhe më tha: 'Jo, tani është gjendje lufte dhe asnjë person nuk udhëton.' Çdo ditë shkuam të pyesnim për lajme për djemtë tanë. Menduam se policia serbe do të na tregonte diçka pasi i njihja të gjithë serbët që jetonin në Gjakovë në atë kohë dhe nuk mendonim kurrë që policia serbe vendase mund të kryente këto krime kundra nesh. Më pas u takova me M.M. sërish dhe e pyeta a kishte ndonjë lajm. Me tha, 'Jo, më vjen keq.' Më pas shtoi, 'Për një ose dy vjet do ta mësosh fatin e djalit tënd, pasi kështu ndodh në kohë lufte.'"* Trupi i Albionit nuk u gjet asnjëherë.

Deri më 10 qershor 1999, kur UNMIK-u mori përsipër përgjegjësinë e administrimit të Kosovës, policia serbe ishte i vetmi autoritet në Kosovë të cilit shqiptarët e Kosovës mund t'i raportonin për zhdukjet me forcë. Megjithatë, menjëherë pas luftës në Kosovë, UNMIK-u nuk qe në gjendje të vendoste sundimin e ligjit anekënd Kosovës dhe deri në nëntor të 1999-

s nuk kishte oficerë policie të mjaftueshëm për të krijuar një organ ligj-zbatues për hetimin e raportimeve të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë të vazhdueshme të serbëve, romëve, dhe pakicave të tjera.[48] Në mungesë të një force policore, shumë anëtarë familjesh i raportuan këto krime tek KFOR-i, që po ashtu merrej me gjetjen dhe rivarrosjen e trupave.[49] Ende nuk dihet sa informacion i marrë nga anëtarët e familjes, apo sa prova të mbledhura nga trupat grumbulluar nga KFOR-i i janë dhënë UNMIK-ut jo-zyrtarisht, por në kohën e shkrimit të këtij raporti, arkivat e KFOR-it lidhur me këto raporte nuk i ishin vënë në dispozicion hetuesve në Serbi apo Kosovë.

"Ishte korrik. Ata ishin tre. Të gjithë kishin pantallona të zeza, bluza me mëngë të shkurtra të zeza e kapele bejsbolli dhe erdhën me një Mercedes ngjyrë bezhë. Dy [të tjerë] qëndruan në rrugë. Nëna ime morri shënim numrin e makinës. Thanë që kishin ardhur të merrnin vëllanë dhe babanë tim për një intervistë informative; ata nuk ishin marrë ushtarë. Babai kishte thyer këmbën dhe përdorte paterica. Ata nuk kishin qenë në luftë. Thanë që po i merrnin për 15 minuta. Menjëherë shkova tek KFOR-i gjerman të raportoja çfarë ndodhi. Ishin më pak se 30 minuta larg. U thashë çfarë kishin veshur burrat dhe i përshkrova makinën. KFOR-i më kërkoi t'i paraqisja foto. Vazhdova të shkoja tek KFOR-i për gjashtë muaj dhe më pas shkova të jetoj në Beograd. Më pas i tregova KNKK-së." R.D., nga Prizreni që tani jeton në Beograd, duke folur për rrëmbimin e babait dhe vëllait të saj në qershor 1999. Trupat e tyre u zhvarrosën në 2004-ën dhe 2005-ën (shih tabelën në seksionin në vijim "Zhvarrimet e kryera nga Tribunali").

Ndonëse KNKK-ja kishte përgjegjësinë e plotë për dokumentimin e raportimeve të bëra nga familjet që nuk kishin gjurmuar dot të afërmit e tyre, në vitet menjëherë pas konfliktit ekzistonte një konfuzion të jashtëzakonshëm lidhur me numrin dhe identitetin e personave të zhdukur. Përveç KNKK-së, raportime për personat e zhdukur merreshin dhe nxiteshin aktivisht nga Zyra e UNMIK-ut për të Ndaluarit dhe Personat e Pagjetur, Komisioni për Zbulimin dhe Identifikimin e Viktimave (KZIV) dhe Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), dhe disa organizata ndërkombëtare dhe jo-qeveritare (OJQ) si dhe shoqatat e të afërmve të personave të zhdukur dhe të rrëmbyer.

Numri i shumtë i agjencive dhe mungesa e qartësisë se kujt t'i drejtoheshin raportimet për personat e zhdukur solli një vonesë të madhe në përcaktimin e numrit dhe identitetit të personave të zhdukur dhe, si rezultat, vonesën në fillimin e hetimeve penale. Në prill 2002, Zyra e UNMIK-ut për të Ndaluarit dhe Personat e Pagjetur ishte ende duke krijuar Listën e Konsoliduar të Personave të Pagjetur për Kosovën, duke krahasuar listat e krijuara nga burime të ndryshme përfshi këtu dhe KNKK-së. Projekte fillestare të Listës së Konsoliduar për shqiptarët e Kosovës dhe të një liste për serbët e Kosovës duhet të qarkulloheshin për verifikim nga shoqatat e familjarëve dhe ishte parashikuar që një Listë e Konsoliduar të behej e disponueshme publikisht në korrik 2002. Me sa di Amnesty International, Lista e Konsoliduar nuk ishte përfunduar deri rreth shtator 2002 – shkurt 2003.[50] Duke u bazuar në këtë listë në fund të vitit 2004, Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (ZPZHML) raportoi se situata mbetet e pashpjeguar për 3192 persona. Këta përfshijnë 2460 shqiptarë të Kosovës, 529 serbë të Kosovës, dhe 203 anëtarë të grupeve të tjera etnike. Deri në këtë kohë rreth 439 persona ishin gjetur gjallë dhe 893 eshtra u ishin kthyer familjeve të tyre.[51]

Amnesty International gjykon se mospërcaktimi me saktësi nga ana e autoriteteve të UNMIK-ut, të paktën deri në 2004-ën, i numrit të viktimave të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë,

u bë shkak për një pengesë të konsiderueshme për procesin e zhvarrosjes dhe identifikimit dhe për fillimin e menjëhershëm të hetimeve penale.

## ZHVARRIMET E KRYERA NGA TRIBUNALI

Nga qershori 1999 zhvarrimet u kryen nga ekipe *ad hoc* që kishin në përbërjen e tyre ekspertë ndërkombëtarë të mjekësisë ligjore, të cilët punonin për Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (Tribunali), i krijuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në maj 1993 dhe që kishte juridiksion mbi krimet e luftës në Kosovë.[52] Qëllimi i këtyre zhvarrosjeve ishte mbledhja e provave për ndjekjen penale të anëtareve të udhëheqjes serbe të akuzuar nga Tribunali për krime lufte në Kosovë në maj 1999.[53] Nga qershori deri në nëntor 1999 u zhvarrosën afro 2108 kufoma nga 195 vendndodhje. Sipas Karla del Pontes, Kryeprokurore e Tribunalit:

*"Ky numër [2108 kufoma] nuk pasqyron detyrimisht numrin e plotë të viktimave reale, pasi gjetëm prova të trazimit të varreve. [Kjo ishte] një përpjekje e qëllimshme e qeverisë serbe dhe jugosllave për shkatërrimin e provave dhe lëvizjen e trupave. Ka një numër të madh vendndodhjesh ku numri i saktë i trupave nuk mund të përcaktohet. Në këto vendndodhje ishin marrë masa për fshehjen e provave. Shumë trupa ishin djegur, por megjithatë provat mjeko-ligjore përputheshin me të dhënat e mbledhura nga dëshmitarët e krimeve."*[54]

Në fazën e dytë të zhvilluar në prill-nëntor 2000, Tribunali zhvarrosi nga 325 vendndodhje edhe 1557 kufoma të tjera dhe 258 eshtra të pjesshme. Më 17 korrik 2001, Tribunali raportoi se kishte zhvarrosur prej 876 vendndodhjesh në Kosovë 4392 kufoma në total. Autopsitë e 3620 kufomave u zhvilluan nga grupi i ekspertëve të mjekësisë ligjore që punonin për Tribunalin dhe 2099 prej këtyre trupave ishin identifikuar dhe raportohen se u janë kthyer familjeve të tyre për varrim. Afro 1500 kufoma të paidentifikuar u rivarrosën në dy varreza të UNMIK-ut dhe varreza të tjera komunale për t'u identifikuar në "një datë të mëvonshme."[55]

Progresi në gjetjen dhe identifikimin e kufomave të zhvarrosura dhe me pas të rivarrosura nga grupi i hetuesve të Tribunalit u pengua për gati shtatë vjet, si rezultat i refuzimit të Tribunalit për t'i transferuar UNMIK-ut dokumentacionin lidhur me hetimet e tij.

Në 2007-n PSSP për Kosovën i raportoi Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara se: *"Në këtë proces u zhvarrosën 4019 trupa prej të cilëve 2001 u identifikuan. Një numër prej 2018 trupash të paidentifikuar [sic] u varros më pas në vendndodhje të panjohura. Tribunali i Hagës nuk ia transferoi dokumentacionin lidhur me zhvarrimet, identifikimet dhe vendndodhjet e varreve të trupave të paidentifikuara UNMIK-ut, i cili ka juridiksion për këto çështje në krahinë. Grupi i Punës për Personat e Zhdukur pa sukses i ka kërkuar dy herë Tribunalit të Hagës dorëzimin e këtij dokumentacioni."*[56]

Vetëm në 2008-n, pas negociatave ndërmjet Zyrës së Tribunalit dhe KNKK-së si organi drejtues i Grupit të Punës për Personat e Zhdukur, dokumentacioni lidhur me zhvarrimet, personat e zhdukur dhe vendndodhjet e mundshme të varreve, i mbledhur në 1999-2000 nga hetuesit që punonin për Tribunalin, u mor prej Zyrës së UNMIK-ut për Personat e Zhdukur dhe Mjekësisë Ligjore (ZPZHML), shih më poshtë seksionin "Mohimi i aksesit në prova".

Amnesty International shqetësohet se fakti që Tribunali nuk e ka pajisur UNMIK-un me dokumentacion të detajuar për vendndodhjen e gjithë trupave të paidentifikuar të zhvarrosur apo përndryshe të gjetur, ka vonuar procesin e identifikimit të trupave dhe ka shkaktuar dëshpërim edhe më të thellë të anëtarëve të familjes së viktimave.

R.D., (shih tabelën në seksionin më sipër "Paqartësi Kompetencash") i tha Amnesty International në 2009-n, se familja e saj nuk i kishte marrë trupat e babait dhe vëllait as gjashtë vjet pas gjetjes së tyre: *"Më thanë se babai dhe vëllai im ishin gjetur në tetor 1999. KFOR-i i Mbretërisë së Bashkuar i gjeti në një fshat të quajtur Novaki. Vëllai im u gjet mbi tokë, pa kokë; koka i ishte prerë. Nuk ishin në varre. Nuk ishin identifikuar. Secili prej tyre ishte vendosur në një qese për kufoma me një numër dhe ishin varrosur si shqiptarë."*

"Më pas, në 2003-shin pashë librin e [KNKK-së] me një foto të xhaketës së vëllait tim. Kunatës sime i kishin dhënë këpucët e vëllait dhe rrobat e tyre të cilat i kishin larë. Dhamë ADN në 2003-shin dhe sërish në 2005-ën. Unë e thashë këtu [në Beograd]; 10 anëtarë të familjes dhanë mostër ADN-je. Na i dhanë rezultatet në 2005-ën dhe i varrosëm në 2005-ën në një fshat afër Leskovacit."

Sipas ZPZHML-së, trupat e Dragomir Dukanoviqit dhe Jovica Dukanoviqit u zhvarrosën nga varreza e Shirokës në Suharekë/Suva Reka, ku me sa duket ishin varrosur nga hetuesit që punonin për Tribunalin. Trupat e tyre u zhvarrosën nga ZPZHML-ja së bashku me eshtrat e 70 trupave të serbëve dhe romëve të tjerë në nëntor 2003.[57]

## BASHKËPUNIMI NDËRMJET SERBISË DHE UNMIK-UT

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë i kërkon shteteve "t'i ofrojnë njeri-tjetrit shkallën më të lartë të bashkëpunimit reciprok ... në rast vdekje, në zhvarrosjen dhe identifikimin e tyre [trupave] dhe në kthimin e eshtrave."[58]

Në 5 nëntor 2001 si rezultat i presionit të ushtruar nga serbët e Kosovës, qeveria e RFJ-së dhe ajo serbe, para zgjedhjeve parlamentare të Kosovës UNMIK-u nënshkroi Dokumentin e Përbashkët të UNMIK-ut dhe RFJ-së i cili ripërtërinte angazhimin e të dyjave palëve për të përcaktuar fatin e viktimave të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë.[59] Në shkurt 2002, UNMIK-u dhe RFJ-ja nënshkruan tre protokolle60 për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve lidhur me rikthimin e eshtrave të identifikuara përtej kufirit, shkëmbimin e ekspertizës mjeko-ligjore dhe krijimin e grupeve të përbashkëta për verifikimin e burgjeve të fshehura.[61]

Me krijimin e Grupit të Punës të Nivelit të Lartë, u arrit bashkëpunimi për riatdhesimin e eshtrave, megjithatë pak bashkëpunim ka pasur në vijim për shkëmbimin e informacionit lidhur me vendndodhjen e personave të zhdukur dhe vendndodhjen e varreve. Informacion i dhënë nga Serbia mbi varret masive në territorin e vetë Serbisë, diskutuar më poshtë, i paraprin kësaj marrëveshje.[62]

Për të ndihmuar dialogun ndërmjet autoriteteve, në tetor 2003 KNKK-ja krijoi, dhe më pas vazhdoi të lehtësonte punën e një Grupi Pune për personat fati i të cilëve ishte ende i paditur, lidhur me ngjarjet ne Kosovë për periudhën janar 1998 deri në dhjetor 2000. Grupi i Punës i KNKK-së përbëhet nga anëtarë të komisioneve përkatëse për personat e zhdukur;[63] dhe përfaqësues të organizatave të familjeve të personave të zhdukur, të cilët janë vëzhgues. Megjithatë, pati shumë pak ose aspak përparim, ashtu sikurse raportoi në 2006-n edhe

Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (KNPZH): "Sesionet e Grupit të Punës për Personat Fati i të Cilëve Nuk Dihet Lidhur me Ngjarjet në Kosovë, i kryesuar nga KNKK-ja, vë në dukje hezitimin e ish-palëve në konflikt për shkëmbimin e informacionit për personat fati i të cilëve nuk dihet dhe për vendndodhjet e mundshme të varreve."[64]

## ZHVARRIMET E KRYERA NGA ZPZHML-JA E UNMIK-UT

Pas përfundimit të zhvarrimeve të kryera nga Tribunali, Njësia e Personave të Pagjetur (NJPP) e Policisë së UNMIK-ut, e krijuar në shkurt 2001, mori përgjegjësinë e identifikimit të vendndodhjeve të varreve të mundshme. NJPP-ja ishte gjithashtu përgjegjëse për të kërkuar urdhra nga gjykata për autorizimin e kryerjes së zhvarrimeve dhe për të kryer zhvarrimet së bashku me ekspertët mjeko-ligjorë arkeologë dhe/apo antropologë.[65] Në prill 2002, UNMIK-u rihapi institutin mjeko-ligjor në Rahovec/Orahovac që shërbeu si morg i përkohshëm i Tribunalit. Në maj, Jose Pablo Baraybar u emërua si drejtuesi i ZPZHML-së e cila filloi veprimtarinë e saj në qershor 2002.[66]

ZPZHML-ja pritej të kryente "një zhvarrim dhe një program identifikimi të vrullshëm" (ashtu sikurse u ra dakord në Dokumentin e Përbashkët të UNMIK-ut dhe RFJ-së) sipas mandatit të saj "[për të përcaktuar] fatin e personave të cilët u zhdukën prej konfliktit të armatosur dhe pas tij." Këtu përfshihet përcaktimi i vendndodhjeve të varreve, gërmimi, zhvarrimi, autopsitë dhe identifikimi i eshtrave, për të mundësuar kthimin e trupave pranë familjeve të tyre për rivarrim.

Në fund të vitit 2004, ZPZHML-ja raportonte se, që nga viti 2002 ,kishte kryer 1170 zhvarrime dhe 858 autopsi dhe deklaronte: "Pjesa më e madhe e trupave të personave të raportuar të zhdukur është gjetur. Edhe pse ZPZHML-ja pranon përgjegjësinë e saj për të vazhduar kontrollin për eshtrat, procesi duhet të përqendrohet në identifikimin e trupave që tashmë janë gjetur."[67] Sipas të dhënave të botuara nga ZPZHML-ja në dhjetor 2004, fati i afro 3192 personave - më shumë se gjysma e numrit të personave të raportuar si të zhdukur - ishte ende i paditur. Shumë prej trupave, përfshi këtu dhe ata të kthyer nga Serbia, mbetën në 2004 në pritje të identifikimit në morgun e dëmtuar të Rahovecit/Orahovac. Në kushtet e një numri marramendës trupash, me burime të pakta, dhe me pak mbështetje politike, kapaciteti i ZPZHML-së për zhvillimin e zhvarrimeve të mëtejshme ishte i kufizuar.

Si rezultat i kapacitetit të kufizuar dhe mungesës së provave lidhur me vendndodhjen e varreve, numri i zhvarrimeve të kryera nga ZPZHML-ja ra. Në 2005-n, ZPZHML zhvarrosi 118 eshtra trupash (që përfaqësonin trupa të plotë apo të pjesshëm); 59 u zhvarrosën në 2006-n; 73 në 2007-n; dhe 53 në 2008-n.[68]

## KOMPLOTI PËR FSHEHJE: SHQIPTARËT E KOSOVËS TË VARROSUR NË SERBI

Në 11 qershor 2001, autoritetet serbe ftuan Tribunalin të dërgonte një grup mjeko-ligjor në Beograd, për të qenë dëshmitarë të zhvarrosjes së trupave të shqiptarëve të Kosovës nga një kamion frigorifer i zbuluar në lumin Danub.[69] Sipas Ministrit të Policisë së asokohe, Dushan Mihajllovіq, në kamion gjendeshin 83 kufoma, kryesisht të gjymtuar, të shqiptarëve etnikë dhe tre koka pa trup. Kamioni ishte hedhur në lumë në mars 1999 dhe pretendohet të jetë rizbuluar rastësisht në prill 2001.

Ashtu sikurse është vërejtur, Tribunali dhe organizatat, përfshi këtu dhe Vëzhguesin e të Drejtave të Njeriut (inicialet në anglisht: HRW), kishin mbledhur prova që sugjeronin se

vendndodhjet e varreve në Kosovë ishin dëmtuar në përpjekje për fshehjen e provave. Sipas HRW-së, kjo përfshinte "heqjen e trupave, rivarrosjen e tyre nga varret masive në varre individuale, djegien e kufomave, dhe heqjen apo shkëmbimin e rrobave apo sendeve personale, me qëllim ndërlikimin e procesit të identifikimit."[70]

Në prill 2001, shkalla në të cilën autoritetet serbe kishin "ngacmuar" varret dhe përpjekjet e tyre për të fshehur provat e krimeve të luftës, ishin gati për të dalë në dritë.[71] Trupat në kamion ishin vetëm maja e ajsbergut. Në total, që prej kësaj kohe, në Serbi janë zhvarrosur eshtrat e të paktën 900 individëve, nga varret masive apo individuale në sipërfaqe toke në pronësi të Ministrisë së Brendshme Serbe, në Batajnicë, në të dalë të Beogradit, Petrovasellë, dhe Bajina Bashta, ku trupat e gjetur në Liqenin Peruçac, ishin rivarrosur në 1999.

Ata ishin shqiptarë etnikë të vrarë në Kosovë. Gjatë prillit dhe majit 1999, trupat e tyre ishin zhvarrosur nga punonjës së Ministrisë së Brendshme Serbe dhe ishin ngarkuar në kamionë për tu transportuar në Serbi, ku u rivarrosën.

Zhvarrimet e kryera gjatë 2001-shit dhe 2002-shit u drejtuan nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Beogradit dhe u ndihmuan nga anëtarët e Prokurorisë së Tribunalit, nga KNPZH-ja dhe ZPZHML-ja.[72] Pesë varre masive të veçanta u gjetën në ish-zonën e trajnimit të policisë të Ministrisë së Brendshme në Batajnicë; secila, me sa duket, përfaqësonte një dërgesë të veçantë nga Kosova. Autopsitë e kryera nga ZPZHML-ja zbuluan se nga 535 trupa të zhvarrosur nga Batajnica dhe Liqeni Peruçac, 531 persona kishin plagë nga armë zjarri. Nga dy varre masive në Petrovasellë u zhvarrosën edhe 70 trupa. Më pas u përcaktua se pjesa më e madhe e tyre ishin civilë, ndër të cilët edhe shtatë femra. Shumë prej tyre i kishin kyçet e duarve të lidhura me njëra-tjetrën dhe pjesa më e madhe ishin qëlluar me armë zjarri.[73]

Sipas marrëveshjes me ZPZHML-në identiteti i më se 90 për qind të këtyre eshtrave u përcaktua prej KNPZH-së nëpërmjet ADN-së korresponduese (shih seksionin në vijim "Identifikimi i eshtrave"), para se këto trupa të riatdhesoheshin në Kosovë. Të gjithë u riatdhesuan në verë të 2006-s.[74]

## KU NDODHEN TRUPAT E ZHDUKUR? PJESA E PARË

Amnesty International është e shqetësuar se jo në të gjitha vendndodhjet e varreve janë kryer zhvarrime. Sipas KNKK-së, përqindja e eshtrave të viktimave të zhdukjeve me forcë që lidhen me Kosovën, që janë gjetur, është më e lartë se gjetiu në rajon.[75] Ky është veç një ngushëllim shumë i vogël për të afërmit që ende presin kthimin e trupave të anëtarëve të familjes së tyre.

Në 2006-n, KNPZH-ja shprehu shqetësim "se UNMIK-u në të vërtetë nuk ka më informacion për vendndodhje të mundshme të varreve të tjera masive apo vendndodhje të paligjshme varresh në territorin e Kosovës. Për më tepër, Qeveria e Serbisë duket sikur i ka shteruar të gjitha kërkimet për varre të tjera masive apo të jashtëligjshme në territorin e vetë Serbisë."[76]

Në Kosovë, përgjegjësia për identifikimin e vendndodhjeve të varreve deri në dhjetor 2008 i përkiste ende policisë së UNMIK-ut. Amnesty International shqetësohet se policia e UNMIK-ut është përballur me vështirësi serioze në identifikimin e gjetjes së vendndodhjeve të tjera të

varreve.

Sipas Vjelko Odaloviqit, të Komisionit Serb për Personat e Pagjetur, dhe për aq sa Amnesty International është në gjendje të vlerësojë, nuk është ofruar asnjë informacion për vendndodhje varresh në Kosovë me trupat serbësh, romësh, apo të pakicave të tjera që mendohet të jenë rrëmbyer dhe vrarë (në pjesën më të madhe të rasteve pas përfundimit të konfliktit të armatosur) nga ish-anëtarë të UÇK-së apo nga dëshmitarë të tjerë. Sipas KNKK-së, kultura e frikës vazhdon të bëhet pengesë për përcaktimin e vendndodhjeve të varreve në Kosovë.[77]

Gjithashtu ka mundësi që vendndodhjet e varreve në Serbi të mos jenë hetuar tërësisht. Për shembull, nga 5-8 qershori 2007, u kryen gërmime në praninë e përfaqësuesve të UNMIK-ut, KNKK-së, OSBE-së dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisëse (IPVQ) në një gurore pranë Majdanit (komuna e Rashkës/Raška), në kufijtë administrativë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas deklaratave të dëshmitarëve marrë nga UNMIK-u, afro 400 trupa të rizhvarrosur në Kosovë, besohej të ishin hedhur në gurore në 2 qershor 1999. Edhe pse ky varr masiv nuk u gjet, mbeten ende pikëpyetje se ku të jenë varrosur këto trupa.

Më 23 dhjetor 2004, Qendra e së Drejtës Humanitare (QDH) me qendër në Beograd botoi pretendime të hollësishme se kufoma të civilëve shqiptarë të Kosovës ishin djegur në një furrnaltë në Mačkatica, në një kompleks alumini pranë Surdulicës, në pjesën jugore të Serbisë më 16 dhe 24 maj 1999. QDH-ja raportoi se djegiet ishin pjesë e operacioneve të shkallës së gjerë, si varret masive në Serbi – Batajnicë, Petrovasellë dhe Bajina Bashta.[78]

Mendohet se trupa të tjerë janë djegur në shtete në kufi me Kosovën, përfshi këtu dhe Malin e Zi, ku pretendohet të jenë varrosur trupat e shqiptarëve të Kosovës të cilët kishin ndërruar jetë para se të kalonin kufirin, ose në Kukës në Shqipëri (shih gjithashtu seksionin "Mungesë bashkëpunimi", kutia "Shtëpia e Verdhë"). Thuhet se në 2009-n EULEX-i se është përpjekur të kishte një bashkëpunim më të efektshëm ndërmjet kufijve për të mundësuar kryerjen e zhvarrimeve.[79]

Në shkurt 2009, gazeta ditore maqedonase në gjuhën shqipe, *Lajm*, raportoi se Ministria e Punëve të Jashtme të Maqedonisë ishte e gatshme të bashkëpunonte për hetimet e afro 20 trupa të shqiptarëve të Kosovës të cilët pretendohet të jenë djegur në varrezën Butel në kryeqytetin e Shkupit. Sipas Prenk Getaj, Kryetari i Komisionit të Kosovës për Personat e Pagjetur, dyshohej se trupat e këtyre shqiptarëve të Kosovës ishin hedhur në lumin Lepenc, që derdhet në lumin Vardar – lumë i cili rrjedh mes për mes Shkupit.[80]

Në një mbledhje të lehtësuar nga KNPZH-ja në dhjetor 2008, shoqatat e familjeve të personave të zhdukur si nga Serbia dhe Kosova paraqitën "pakënaqësinë e tyre lidhur me rezultatet e arritura në procesin e gjurmimit të personave të zhdukur". Ndërmjet të tjerash, ata i propozuan autoriteteve "që gjatë hetimit të kërkonin informacion për vendndodhjen e varreve dhe rrethanat e zhdukjes, në veçanti gjatë intervistimit të të dyshuarve ose dëshmitarëve në rastet e krimeve të luftës;" dhe "se duhet të krijoheshin mekanizma të tjerë për të mbledhur informacion mbi vendndodhjen e varreve, si dhe institucionet kompetente të vendeve të rajonit duhet të kërkonin ndihmë financiare nga institucionet e Bashkimit Evropian për mbështetjen e funksionimit të plotë të këtyre mekanizmave."[81]

## IDENTIFIKIMI I ESHTRAVE

Deri në 2001-shin trupat e zhvarrosur u identifikuan nëpërmjet mënyrave tradicionale, zakonisht kur një anëtar i familjes dallonte rrobat e personit ose sende të tjera vetjake të gjetura me trupin. Fotografi të këtyre sendeve u publikuan nga KNKK-ja dhe OSBE-ja në një seri botimesh "Librat e Sendeve Vetjake".[82] Sipas marrëveshjes me UNMIK-un, nga 2001-shi identifikimi i eshtrave është bërë nga KNPZH-ja që deri në prill 2009 kishte identifikuar 2174 individë, vdekja e të cilëve lidhej me konfliktin në Kosovë. KNPZH-ja me qendër në Sarajevë të Bosnjës dhe Hercegovinës, analizon ADN-në nga mostrat e kockave të marra si nga KNPZH-ja dhe nga autoritetet serbe, dhe më pas i krahason ato me AND-në e marrë nga mostrat e gjakut të prej të afërmve të personave të zhdukur. Deri tani KNPZH ka mbledhur 14 454 mostra ADN-je nga anëtarët e familjes, të cilët kanë raportuar një numër të përgjithshëm prej 4240 të afërmish të zhdukur.[83]

Ashtu siç ka rënë numri i zhvarrimeve, po ashtu ka rënë dhe numri i identifikimeve të suksesshme. Në 2008-n, sipas KNPZH-së u mbyllën vetëm 60 çështje,– 59 prej të cilave u mbyllën pasi identifikimi i ADN-së ishte pozitiv dhe rasti tjetër pasi një person, deri në atë kohë i listuar si i zhdukur, u gjend i gjallë. Në të njëjtën kohë, KNPZH-ja i ktheu familjeve trupat e 76 individëve. Ky numër përfshin dhe eshtrat e nëntë jo-shqiptarëve.[84] Për katër raste të individëve romë, nuk u gjet familja e tyre. Ndoshta ata mund të jenë midis romëve të tjerë që u larguan nga Kosova, duke kërkuar mbrojtjen e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Në kushte normale, për të siguruar identifikimin e saktë të një trupi kërkohet më shumë se 99 për qind përputhje në disa parametra. Në rreth 60 raste, ky kufi është ulur deri në 70 për qind, duke pasur si qëllim deri në një farë mase adresimin e çështjes së 437 trupave të paidentifikuar (shih më poshtë) dhe rasteve të tjera problematike. Rezultatet do të krahasohen më pas me provat e disponueshme si para dhe pas vdekjes.

Në rastet e mungesës së sasisë së mjaftueshme të masës eshtërore për të siguruar një mostër ADN-je që normalisht nevojitet për testim, janë duke u zhvilluar teknika të tjera identifikuese. Një teknikë e re, me të cilën testet mund të kryen vetëm me 100mg eshtër, mund të ndihmojë në identifikimin e fëmijëve të vegjël ose të trupave të cilat janë djegur dhe kur përbërja e fragmenteve të mbetjes eshtërore është shumë e vogël për të zbatuar metodën normale të mostrës së ADN-së.[85]

Në disa raste eshtrat e disa individëve nuk mund të identifikohen dhe ndoshta nuk do të identifikohen asnjëherë.

## E DREJTA PËR TË DITUR: ALBION KUMNOVA – KU NDODHET TRUPI I TIJ?

"Prita nëntëmbëdhjetë herë në kufi: të gjithë të tjerët [të arrestuar me Albionin] u kthyen më 3 shtator 2001, me përjashtim të Albionit. [Trupat e tyre] ishin gërmuar dhe identifikuar në varrezën Peruçac, me përjashtim të Albionit. [Grupi i Punës] më tha se varreza është zbrazur krejt dhe se atje nuk kishte mbetur asnjë . Trupat e tjerë [të paidentifikuar] mbahen nga ZPZHML-ja, ku është djali im Albioni atëherë? Ky është turp për institucionet tona. Ato e kanë për detyrë të kujdesen për ne. Kanë për detyrë të kujdesen për personat e zhdukur. Nuk ka harmoni në familjet tona, shpirtrat tanë s'gjejnë kurrë qetësi. Sikur ta dija ku është djali im,

dhe [do mund] ta varrosja dhe t'i vendosja një lule mbi varr, do të ndihesha më mirë."

Nesrete Kumnova ka protestuar vazhdimisht kundër mosgjetjes së eshtrave nga autoritetet , jo vetëm të djalit të saj, po edhe të viktimave të tjera të zhdukjeve me forcë. Në 8 mars 2009 ajo drejtoi një protestë të OJQ-së Thirrjet e Nënave. Disa nga këto anëtare hynë në grevë urie jashtë morgut të ZPZHML-së, ku ajo beson se vazhdojnë të mbahen eshtrat e paidentifikuara të djalit të saj. [86]

Në një intervistë televizive ajo deklaroi: "Kam vendosur të vazhdoj grevën [e urisë] derisa qeveria dhe organizatat që punojnë për çështjen e personave të zhdukur të nënshkruajnë një marrëveshje se të gjitha eshtrat e mbetura, edhe pjesë të vogla nga këto eshtra, do të dërgohen menjëherë në Bosnjë për tu analizuar. Ato duhen identifikuar dhe i duhen kthyer familjeve të tyre."

Një përfaqësues i Zyrë së Mjekësisë Ligjore, i intervistuar po për të njëjtin program, tha: "Sapo trupat të identifikohen do t'ua kthejmë familjeve të tyre; nuk kemi interes t'i mbajmë, edhe pse në pjesën më të madhe të rasteve (trupat që vijnë nga Beogradi), duke përfshirë dhe këtë rast, e duke pasur parasysh respektin që kemi për Znj. Nesrete Kumnova dhe protestën e verës së shkuar, nuk ka përputhje. Ne kemi paraqitur mostra gjaku një duzinë herësh, por problemi në fakt është se këto mostra [eshtrash] nuk përputhen me dhuruesit e mostrave të gjakut." [87]

## KU NDODHEN TRUPAT E ZHDUKUR? PJESA E DYTË

Në fund të 2008-s, eshtrat që përfaqësonin një minimum prej 437 personash, ishin ende të paidentifikuara dhe mbaheshin në morgun e ZPZHML-së në Prishtinë. Afro 395 trupa ishin zhvarrosur në Kosovë dhe 42 prej tyre ishin të kthyera nga vetë Serbia. Asnjë prej tyre nuk përputhet me mostrat e gjakut prej të afërmve. Ka një numër arsyesh të mundshme për këtë. Për shembull, disa eshtra nuk mund të identifikohen nëpërmjet analizës tradicionale të ADN-së. Në raste të tjera arsyeja e mosidentifikimit mund të lidhet me faktin se të afërmit nuk kanë ofruar mostra gjaku, pasi mund të mendojnë se e kanë varrosur trupin e anëtarit të familjes së tyre.

Kohët e fundit kanë dalë prova që sugjerojnë se një numër i paditur familjesh mund të kenë identifikuar gabimisht trupat, që ata besonin se i përkisnin të afërmve të tyre, ose se u është dhënë trupi i gabuar nga Tribunali. Ashtu sikurse vërehet më sipër, raportohet se Tribunali ka zhvarrosur afro 4000 trupa, për të mbledhur prova për krimet e luftës të kryera nga ushtria e RFJ-së dhe policia dhe forcat paraushtarake serbe. Disa prej këtyre trupave u identifikuan me mënyra tradicionale, disa të tjera vetëm mbi bazën e identifikimit pamor, para se të merreshin apo t'i ktheheshin familjeve për varrosje.

Tashmë duket sikur disa prej këtyre trupave mund të jenë identifikuar gabim. Dr. Arsim Gerxhaliu, Drejtor i ZPZHML-së, në një intervistë me median në 6 prill 2009 tha: "Kemi 2019 raste në të cilat familjet i varrosën trupat bazuar vetëm në identifikimin pamor. Mund të imagjinoni mundësinë e gabimit! Duhet të bindnim disa familje se kishin varrosur personin e gabuar, pasi trupi i të afërmit të tyre ishe gjetur gjetiu."[88]

Në vitin 2000, për shembull, raportohet që një familje kishte shkuar në një varrezë në fshatin Rakosh/Rakoš, ku autoritetet serbe, në maj 1999, kishin varrosur trupat e burrave të vrarë në burgun e Dubravës. Aty thuhet se ata gjetën një trup që kishte të veshur të njëjtën markë farmerkash si ajo e pantallonave të djalit të tyre. Babai i tha QDH-së: "Ne nuk jemi shumë të sigurt që është djali ynë, po e morëm trupin." UNMIK-u në 2001-shin raportoi

gjithashtu se familjet vizitonin vendndodhjet e varreve në rajonin e Mitrovicës dhe "kryenin zhvarrime të jashtëligjshme."[89]

Për pjesën më të madhe të familjeve të personave të rrëmbyer dhe të zhdukur me forcë prej të dy palëve të konfliktit, mundësia e varrosjes së personit të gabuar, është burim stresi dhe ankthi. Për autoritetet kjo është një çështje që duhet trajtuar me shumë takt dhe kujdes.

Gjatë 2008-s, në bashkëpunim me Serbinë dhe Komisionet Kosovare për Personat e Zhdukur, u krye një numër i kufizuar zhvarrimesh-provë,me kërkesën e anëtarëve të familjes që dëshironin të konfirmonin se personi që kishin varrosur ishte në fakt anëtari i familjes së tyre. Gjashtëdhjetë zhvarrime u kryen në jug të Mitrovicës me kërkesën e shoqatës vendase të familjarëve, gjashtë prej trupave të zhvarrosur ishin identifikuar gabim. Edhe 100 familje të tjera kanë kërkuar rizhvarrime.[90]

## E DREJTA PËR TË DITUR: DAKA ASANI – SI VDIQ?

Në dhjetor 2006, trupi i Daka Asanit, një burrë rom, iu kthye familjes për t'u varrosur. Djali i Daka Asanit e kishte parë atë për herë të fundit kur ishin së bashku duke bërë pazarin në treg në Ferizaj/Uroševac në 1 gusht 1999. Trupi i tij ishte një prej 176 trupave që zhvarrosi Tribunali në vitin 2000, pranë varrezës së Dragodanit në Prishtinë.

Sipas dokumenteve të identifikimit që ZPZHML-ja ia kishte dhënë familjes, trupi i Daka Asanit ishte gjetur në një varr më vete. Data e një autopsie bërë trupit të tij jepej si 22 qershor 2000. Megjithatë, familja kishte njoftuar KNKK-në dhe regjistruar atë si të zhdukur që nga 19 gushti 1999. Pse nuk iu kthye trupi i Daka Asanit familjes së tij deri në 2006-n?[91]

Një ekspert i pavarur, i cili ishte i pranishëm gjatë zhvarrimeve në vitin 2000, i tha Amnesty International: "TPNJ-ja u pozicionua (jo etike sipas mendimit tim), se nuk kishte asnjë përgjegjësi për identifikimin dhe, si rrjedhojë, disa nivele më të ulëta (nga ana organizative apo intelektuale) mbajtën një qëndrim të mospasjes interes për identifikimet, ndërkohë që me pak përpjekje do të ishte arritur shumë në disa raste."[92]

Sipas certifikatës së vdekjes dhënë familjes nga ZPZHML-ja në 2006-ën, Daka Asani kishte vdekur nga "plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri në kokë dhe në trup." Familja nuk ka marrë asnjëherë një raport autopsie të plotë që të detajonte shkakun dhe mënyrën e vdekjes. Ata i thanë Amnesty International se deshën të dinin nëse Daka Asani ishte ekzekutuar, nëse plagët ishin në pjesën e përparme apo të mbrapse të trupit, apo nëse ishte qëlluar nga një distancë e afërt.[93] Sipas ekspertit të pavarur të cituar më sipër, "Me siguri që ka një raport autopsie që mbahet nga TPNJ [Tribunali] ...ka mundësi që autopsia të jetë kryer nga grupi i MB."[94]

Në qershor dhe gusht 2007, Skënder Asani, djali i Daka Asanit, i shkroi SHPK-së për t'i kërkuar hetimin e vrasjes së babait të tij. Amnesty International gjithashtu i kaloi Njësisë e Krimeve të Luftës të policisë së UNMIK-ut (NJKL) informacionin e marrë nga familja, përfshi këtu kopje të dokumentacionit përkatës. Megjithatë, në gusht 2008, NJKL-ja informoi Amnesty International se nuk kishte marrë asnjë padi penale për këtë rast.

## VAZHDIMI I ZHVARRIMEVE

Në 9 dhjetor 2008 një Mision i Bashkimit Evropian të Sundimit të Ligjit në Kosovë (inicialet në anglisht: EULEX) mori nga UNMIK-u përgjegjësinë e hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe të krimeve të tjera të rënda.[95] ZPZHML-ja u transferua nga UNMIK-u tek Komponenti i Drejtësisë i EULEX-it.

EULEX-i raportoi në prill 2009 se, pavarësisht nga një pushim në janar dhe shkurt 2009 për shkak të motit të keq, ZPZHML-ja kishte kryer 12 zhvarrime të cilat rezultuan në gjetjen e 11 trupave, si dhe kishte përcaktuar gjashtë vendndodhje të tjera të mundshme varresh. Për më tepër, ZPZHML-ja e EULEX-it planifikoi të fillonte një fushatë intensive për rizhvarrimin eshtrave të varrosura pa identifikimin e duhur në 1999.

Puna filloi në mënyrë të konsiderueshme me analizimin e dokumentacionit lidhur me zhvarrimet, vendndodhjet e mundshme të varreve dhe të personave të zhdukur. Ky dokumentacion ishte marrë nga Tribunali prej UNMIK-ut në 2008-n (shih më sipër seksionin "Zhvarrimet e kryera nga Tribunali") dhe më pas i ishte transferuar EULEX-it. Si rezultat, "[v]endndodhje varresh të mundshme janë identifikuar dhe do të hetohen më pas në bashkëpunim të ngushtë me Njësinë e Hetimit të Krimeve të Luftës (NJHKL)."[96]

Amnesty International nxit EULEX-in të marrë masa që ZPZHML -ja dhe NJHKL-ja të pajisen me të gjitha burimet njerëzore, teknike dhe financiare për të kryer këtë detyrë.

# 4. HETIMET DHE NDJEKJET PENALE

*"Na kanë mashtruar të gjithë. Nuk ka drejtësi për ne, as edhe nga Milloshevigi, i cili na tha se do të mbroheshim. Kushdo që ka shkelur në këtë tokë na ka penguar të marrim drejtësi. Ne jemi vetëm njerëz të zakonshëm, që dëshironin të qëndronim me ndërgjegje të pastër, pasi nuk i kishim bërë keq askujt. Menduam se forcat ndërkombëtare do të na mbronin. Ne nuk bëmë asgjë; deshëm paqe."*

Një nënë serbe e Kosovës; djali i saj u rrëmbye në Kosovë në vitin 1999 dhe nuk dihet ku gjendet. Intervistë e Amnesty International, shkurt 2009.

Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare që zbatohet si në Serbi dhe Kosovë, autoriteteve u kërkohet të fillojnë hetime penale të menjëhershme, të pavarura, të paanshme dhe të plota për të gjitha raportimet e zhdukjeve me forcë dhe rrëmbimeve. Për më tepër, autoritetet duhet të sjellin para drejtësisë, nëpërmjet një procedimi të drejtë, të gjithë personat përgjegjës për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë. Këtu duhet të përfshihen jo vetëm ata që kryen këto akte, por edhe ata që urdhëruan kryerjen e tyre; ata me përgjegjësi të lartë të cilët nuk ushtruan kontroll të efektshëm ndaj personave nën pushtetin e tyre që kryen këto akte; si dhe ata që nuk ua paraqitën çështjet për hetim dhe ndjekje penale autoriteteve kompetente.

Amnesty International gjykon se, që nga qershori 1999, as policia dhe prokurorët serbë dhe as policia dhe prokurorët ndërkombëtarë në Kosovë, që janë përgjegjës për hetimin e krimeve të luftës, nuk kanë filluar hetime të menjëhershme, të pavarura, të paanshme dhe të plota për raportimet e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë.

Si rezultat, vetëm pak nga personat përgjegjës të krimeve të luftës dhe të krimeve ndër-etnike në Kosovë, gjatë dhe pas konfliktit të armatosur, janë sjellë para drejtësisë në gjykatat ndërkombëtare apo vendore. Një klimë e mosndëshkimi vazhdon të ekzistojë ende.

Ky kapitull identifikon autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për kryerjen e hetimeve dhe ndjekjeve penale; shqyrton progresin e deritanishëm dhe identifikon pengesat kryesore për t'i dhënë fund mosndëshkimit.

## NDJEKJET PENALE NGA TRIBUNALI

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ka juridiksion të ndjekë penalisht personat përgjegjës për shkeljet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë (përfshi këtu Kosovën) prej 1999-s. Statuti i Tribunalit jepte juridiksion mbi veprimet përbërëse të zhdukjes dhe rrëmbimit me forcë, dhe jo mbi këto dy krime specifike. Si rrjedhim, ata kundër të cilëve u ngrit padi penale lidhur me zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë, u akuzuan për krime lufte (shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës) ose krime kundër njerëzimit.

### NDJEKJET PENALE TË SERBËVE PËR ZHDUKJET ME FORCË

Në maj 1999, kur lufta vazhdonte ende, Tribunali bëri publike akuzën për krime lufte dhe

krime kundër njerëzimit në Kosovë. Kjo akuzë ngrihej kundër Presidentit të atëhershëm Federativ të RFJ-së, Sllobodan Millosheviqit, dhe pesë personave të tjerë.[97] Në 5 shtator 2002, Dhoma Gjyqësore ndau procedimet kundër Sllobodan Milloshevigit, i akuzuar gjithashtu për gjenocid lidhur me luftërat në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci, nga procedimet e pesë të bashkakuzuarve. Sllobodan Milloshevigi u akuzua për Kosovën, ndërmjet të tjerash, për "vrasjen e qindra civilëve shqiptarë të Kosovës – burra, gra, dhe fëmijë; vrasje që u kryen gjerësisht dhe rregullisht në të gjithë krahinën e Kosovës." Procedimet filluan në shkurt 2002 dhe përfunduan për shkak të vdekjes së tij më 11 mars 2006.

Në qershor 2006 filluan procedimet ndaj gjashtë politikanëve, zyrtarëve të lartë të policisë dhe ushtrisë, të cilët u akuzuan për krime kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës.[98] Ish-Zëvendës Presidenti Serb Milan Milutinoviq; ish Zëvendës Kryeministri Nikolla Shainoviq; ish Shefi i Përgjithshëm i Personelit (më pas Ministër Mbrojtjeje), Dragoljub Ojdaniq; ish Gjeneral-Koloneli i Policisë, Sreten Lukiq (më pas Ndihmës Ministër i Brendshëm); dhe ish Gjeneralë-Kolonelët e Ushtrisë Jugosllave, Nebojsha Pavkoviq dhe Vladimir Llazareviq, që u akuzuan së bashku për krime kundër njerëzimit dhe shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës. I bashkakuzuari, ish Gjeneral-Koloneli i Policisë, Vllastimir Gjorgjeviq, qëndroi lirë deri në 17 qershor 2007, kur u arrestua në Mal të Zi në bashkëpunim me autoritetet serbe.

Akuzat në këtë çështje, ndërmjet të tjerash, lidhen me zhvendosjen e trupave të shqiptarëve të Kosovës nga Kosova në Serbi në prill dhe maj 1999. Në shkurt 2009, Tribunali liroi Milan Milutinoviqin, por dënoi pesë të tjerët për bashkëpunim në krimet kundër njerëzimit dhe krime lufte, duke përfshirë dëbimet me forcë dhe vrasjen e mijëra shqiptarëve etnikë gjatë konfliktit në Kosovë. Nikolla Shainoviq, Nebojsha Pavkoviq dhe Sreten Lukiq u dënuan për dëbime, dhe veprime të tjera të çnjerëzore (transferimet me forcë), vrasje dhe persekutime (përfshi përdhunimet) mbi baza politike, racore apo fetare dhe secili u dënua me 22 vjet burgim. Dragoljub Ojdaniqi dhe Vladimir Llazareviqi u dënuan për dëbime dhe veprime të tjera çnjerëzore me 15 vjet burg.

Në vendimin e tij Tribunali arriti në përfundimin se: "[N]uk ka asnjë dyshim se, gjatë bombardimit të NATO-s u krye një operacion i fshehtë lidhur me zhvarrimin e mbi 700 trupave fillimisht të varrosur në Kosovë dhe transportimin e tyre në vetë Serbi ." Vendimi thoshte se "personalitetet kryesore të përfshira në organizimin e këtij operacioni të nivelit të lartë ishin Ministri i Brendshëm, Vlajko Stojiljkoviq; Presidenti i RFJ-së, Sllobodan Milloshevig; dhe Drejtori i RJB-së [Departamentit të Sigurisë Publike] në atë kohë, Vllastimir Gjorgjeviq." Megjithatë, pavarësisht nga konkluzioni i saj se provat ishin "shumë dënuese për MUP-in [Ministrinë e Brendshme Serbe] dhe shumë punonjësve të saj," Tribunali nuk arriti në përfundimin se ndonjëri prej të pestëve, duke përfshirë Sreten Lukiq, ishin direkt përgjegjës për transportimin dhe fshehjen e trupave në Serbi."[99]

Procedimet gjyqësore kundër Vllastimir Gjorgjeviqit filluan në Tribunal në 27 janar 2009. Gjatë periudhës 1 janar deri 20 qershor 1999, si ish-Ndihmës Ministër i MUP-it dhe Shef i Departamentit të Sigurisë Publike (RJB) ai qe përgjegjës për të gjitha njësitë e RJB-së në Kosovë. Kundër Vllastimir Gjorgjeviqit u ngrit padia për zhvendosjet me forcë të shqiptarëve etnikë, për përgjegjësi individuale dhe të përbashkët në pjesëmarrjen e tij në një "vepër të përbashkët penale ... [përfshirë që] ... [s]ë bashku me [Vlajko] Stojiljkoviqin[100] dhe të tjerë,

ai kishte rol drejtues në planifikimin, nxitjen, urdhërimin dhe zbatimin e programit të fshehjes së krimit të vrasjes nga anëtarët e RJB-së dhe njësitë vartëse, në bashkërendim me personat e RDB-së [sigurimit të shtetit] dhe të VJ-së".[101] Gjyqi kundër tij ende vazhdonte në maj 2009.

### NDJEKJET PENALE TË SHQIPTARËVE ETNIKË PËR RRËMBIMET

Tribunali bëri dy akt-akuza publike kundër shqiptarëve të Kosovës. E para u bë në 24 janar 2003, kur kundër Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, anëtarë të UÇK-së, u ngrit akt-akuza publike për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Ata u akuzuan lidhur me rrëmbimin, paraburgimin dhe vrasjen gjatë konfliktit të armatosur në 1998, të të paktën 35 civilëve, përfshi këtu serbë, romë, dhe shqiptarë etnikë. Dymbëdhjetë prej viktimave u vranë në Kampin e Burgut Llapushnik/Lapušnik gjatë periudhës 24 qershor 1998 deri më 26 korrik 1998, dhe 10 të tjerë u vranë në ose afër Bjeshkëve të Berishës/Beriša, pranë kampit. Në 27 shtator 2007, Haradin Bala u dënua me 13 vjet burg për kryerjen e veprave penale të torturës, trajtimit mizor dhe vrasjes. Fatmir Limaj dhe Isak Musliu u liruan.[102]

Tribunali gjykoi se nuk kishte prova të mjaftueshme për të provuar se secili nga individët që ishte rrëmbyer dhe ndaluar në Kampin e Burgut të Llapushnikut/Lapušnik ishte vrarë atje. Për shembull, Sllobodan Mitroviqi u pa për herë të fundit në 24 qershor 1998 dhe dihej që ishte mbajtur në Llapushnik/Lapušnik. Gjatë gjyqit, gruaja e tij dëshmoi se ajo nuk e kishte parë burrin e saj që prej zhdukjes dhe ishte e bindur se ishte vrarë. Ai mbetet në listën e KNKK-së si person i pagjetur.[103] Megjithatë, ndonëse Dhoma e Tribunalit i pranoi si të mjaftueshme provat për të vendosur se Sllobodan Mitroviqi ishte mbajtur i ndaluar në kamp, ajo deklaroi se "provat nuk japin siguri të mjaftueshme për rrethanat e vdekjes së tij të mundshme, për të përcaktuar elementët e veprës penale të vrasjes sipas akuzës."[104]

Akt-akuza e dytë publike kundër shqiptarëve të Kosovës u bë nga Tribunali në mars 2005, dhe sërish kishte të bënte me pretendime rrëmbimesh. Akuzoheshin për krime kundër njerëzimit Ramush Haradinaj, ish-komandanti i UÇK-së dhe më pas kryeministri i Kosovës, Idriz Balaj, një ish-komandant njësie, dhe Lahi Brahimaj, një anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.[105] Akt-akuza pretendonte se ata ishin bashkëpunëtorë në kryerjen e zhvendosjeve të paligjshme e trajtimeve mizore, torturimin, përdhunimet dhe vrasjet e 60 shqiptarëve, serbëve, romëve dhe egjiptianëve të rrëmbyer nga UÇK-ja dhe të burgosur në kompleksin e Jabllanicës të UÇK-së në 1998. Në prill 2008 Dhoma Gjyqësore i shpalli të pafajshëm të gjithë të akuzuarit për krime kundër njerëzimit, për shkak të provave të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se ishte sulmuar popullata civile. Lahi Brahimaj u dënua me gjashtë vjet burg për krime lufte dhe trajtim mizor dhe për torturimin e dy dëshmitarëve. Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj u liruan. Një apel nga prokuroria është ende në Dhomën e Apelit.

Asnjë akuzë tjetër nuk është bërë nga Tribunali lidhur me zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë të kryera në kuadrin e konfliktit në Kosovë dhe në vijim të tij. Kryeprokurori i Tribunalit parashtroi në 1999-ën se Tribunali "nuk kishte as mandatin dhe as burimet për të funksionuar si agjencia parësore për hetimin dhe ndjekjen penale të të gjitha krimeve penale të kryera në Kosovë."[106]

## HETIMET DHE NDJEKJET PENALE NË SERBI

Autoritetet kanë si detyrim fillimin e një hetimi të menjëhershëm, të pavarur, të plotë e të paanshëm dhe të sigurojnë zgjidhje ligjore për rastet e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë. Kjo buron nga detyrimet e tyre KNDCP-së dhe KEDNJ-së për të vënë drejtësi dhe për të respektuar e mbrojtur të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit, të ndalimit të torturës e keqtrajtimeve, si dhe të së drejtës së jetës.

Amnesty International gjykon se përgjegjësia parësore për hetimin e rasteve të zhdukjeve me forcë të shqiptarëve etnikë nga policia dhe forcat paraushtarake serbe ose nga VJ-ja, i takon autoriteteve serbe. Kjo midis të tjerash për shkak se ata kanë qasje të drejtpërdrejtë në informacionin që i përket këtyre krimeve.

Amnesty International gjykon se, të paktën deri në vitin 2003, autoritetet serbe në pjesën më të madhe nuk i kanë respektuar këto detyrime. Madje, ato jo vetëm që ngurronin t'i fillonin këto hetime, por vazhduan të ushqenin klimën e mosndëshkimit të krimeve të luftës, përfshirë dhe fshehjen e vazhdueshme të disa prej krimeve më të kobshme të luftës të kryera nga autoritetet serbe, si dhe zhvendosjen e trupave nga Kosova në Serbi (shih më sipër seksionin "Komploti për fshehje: shqiptarët e Kosovës të varrosur në Serbi" dhe më poshtë seksionin "Ndërhyrjet politike në rrjedhën e drejtësisë"). Si rezultat janë kryer vetëm pak ndjekje penale, përfshirë këtu edhe ato prej gjykatave ushtarake.[107]

Në korrik 2003, Asambleja Serbe miratoi legjislacionin për krijimin e Prokurorisë së Krimeve të Luftës (PKL) dhe krijoi një Dhomë Speciale për Krimet e Luftës (DHSKL) në Gjykatën e Rrethit të Beogradit. Ligji gjithashtu krijoi një Shërbim Hetimi të Krimeve të Luftës (SHHKL) në Ministrinë e Brendshme, që vepron mbi bazën e kërkesave nga PKL. Nga koha e krijimit të këtyre institucioneve është bërë një përparim i dukshëm në ndjekjen penale të krimeve të luftës të kryera nga RFJ-ja dhe forcat serbe në Bosnje-Hercegovinë, Kroaci dhe Kosovë, ndonëse numri i ndjekjeve penale të përfunduara mbetet i ulët.

Në mungesë të një dispozite që penalizon specifikisht veprën penale të zhdukjeve me forcë në Kodin Penal serb i cili hyri në fuqi në 1999-n, ndjekjet penale që lidhen me zhdukjet me forcë janë kryer mbi bazën e dispozitave që mbulojnë krimet e luftës. Këto përfshijnë disa prej akteve që karakterizojnë zhdukjet me forcë si: rrëmbimi, ndalimi i jashtëligjshëm, tortura dhe vrasja.

Që nga koha e krijimit të DHSKL-së në Gjykatën e Rrethit të Beogradit, hetimet nga Kryeprokurori për Krimet e Luftës kanë rezultuar në tre procedime lidhur me zhdukjet me forcë në Kosovë.

Në 24 prill 2009, katër anëtarë të policisë serbe u dënuan për vrasjen e 48 anëtarëve të familjes Berisha dhe të Abdullah Elshanit në Suharekë/Suva Reka të Kosovës në mars 1999. Trupat e tyre fillimisht u dogjën në poligonet ushtarake të Prizrenit në Kosovë. Disa prej trupave, por jo të gjithë, ende me kartat e identitetit në ta, u transportuan në Batajnicë të Serbisë. Këta ishin ndër trupat e parë që u zhvarrosën dhe identifikuan. Procedimet u hapën në 2 tetor 2006. Ky ishte rasti i parë që përfshinte punonjës policie të rangut të lartë dhe në të cilin, me ndihmën e QDH-së, dëshmuan në gjykatë disa prej fëmijëve që mbijetuan.[108]

Radojko Repanoviq, ish-komandanti i stacionit të policisë në Suharekë dhe punonjësi i policisë Slagjan Çukariq u dënuan me 20 vjet burg. Punonjësi rezervist i policisë Miroslav Petkoviq u dënua me 15 vjet dhe ish-Inspektori i Sigurimit të Shtetit, Millorad Nishaviq, u dënua me 13 vjet burg. Megjithatë, gjykata shfajësoi nga përgjegjësia penale për vrasjen Radosllav Mitroviqin, ish-komandantin e Batalionit të 37-të të Policisë Speciale Serbe (PJP), Zoran Petkoviqin, ndihmësin e komandantit të stacionit të policisë së Suharekës, si dhe një punonjësin rezervist të policisë.

Në gusht 2006 Sreten Popoviq dhe Millosh Stojanoviq, ish-oficerë komande në Grupin Operativ të Ndjekjes të PJP-së u dënuan për "mohimin viktimave të së drejtë së tyre për një proces gjyqësor të paanshëm dhe të drejtë".[109] Agron, Mehmet dhe Ilijem Bytiqi ishin vëllezër me origjinë shqiptarë të Kosovës ; ata kishin shtetësi amerikane dhe thuhet se ishin kyçur në Brigadën e Atlantikut, që luftonte në krah të UÇK-së. Në 8 korrik 1999 u lëshuan nga Burgu i Rrethit të Prokupljes, pasi ishin dënuar me 15 ditë burgim për vajtjen e tyre në Serbi. Pas lirimit të tyre pretendohet se u ndaluan nga të akuzuarit dhe se u çuan në një fushë stërvitjeje në Petrovasellë, ku u vranë në 9 korrik 1999. Trupat e tyre u gjetën në vitin 2001 në krye të varreve masive në Petrovasellë. Gjyqi filloi në 13 nëntor 2006 dhe vazhdon ende në kohën e shkrimit të këtij raporti.

Në prill 2008, katër anëtarë të Grupit Parlamentar të njohur si "Akrepat" u akuzuan për vrasjen e shqiptarëve civilë në Podujevë/o. Në qershor 2005, në procedime të veçanta, një nga anëtarët e grupit, Sasha Cvjetan, u dënua për këtë krim me 25 vjet burgim. Procedimet u transferuan nga Prokuplje në Gjykatën e Rrethit të Beogradit në 2002-shin.[110]

Aktakuza kundër Zheljko Gjukiqit, Dragan Mediqit, Dragan Borojeviqit dhe Miodrag Sholajas, anëtarë të njësisë së "Akrepave", thotë se në 28 mars 1999 ata kishin marrë 20 shqiptarë – gra, fëmijë, dhe të moshuar nga shtëpia e familjes Bogujevci, ku ata ndodheshin, dhe i kishin urdhëruar të shkonin në oborrin e shtëpisë së Halim Gashit. Sipas dëshmive të fëmijëve, sapo Shefkate Bogujevci hyri në oborr, një anëtar i panjohur i njësisë së "Akrepave" e qëlloi me armë. Kur e kuptuan se nëna e tyre, Shefkate Bogujevci, ishte vrarë, fëmijët e saj Fatos, Jehona, Lirije, dhe Genc Bogujevci vrapuan drejt saj. Në këtë moment disa prej "Akrepave" filluan të qëllonin me armë kundër tre prej fëmijëve Bogujevci dhe civilëve të tjerë që gjendeshin në oborr.[111] Trupat e familjes Bogujevci u varrosën në varret masive jashtë varrezës së Podujevës. Procedimet filluan në 8 shtator 2008 dhe vazhdojnë ende në kohën e shkrimit të këtij raporti.

Sipas Prokurorit të Krimeve të Luftës dhjetë raste të tjera që lidhen me zhdukjet me forcë nga forcat serbe të shqiptarëve të Kosovës janë aktualisht në fazën e hetimit paragjyqësor dhe aktakuzat priten të ngrihen së shpejti.[112] Secili nga këto raste lidhet me trupa të identifikuar të gjetur në varret masive në Serbi dhe përfshijnë: 144 nga 287 shqiptarët e Kosovës të vrarë gjatë tre ditëve që nga 27 prilli 1999, në dhe rreth Mejës/Meja; 53 persona të vrarë në Zahaq/Zahac; më shumë se 40 persona të vrarë në Qyshk/Cuška; afro 37 persona të vrarë në Tërm/Trnje; dhe 77 të vrarë në Petrovasellë/Petrovo Selo. Sipas PKL-së, SHHKL-së i ishte kërkuar të identifikonte autorët, duke përfshirë anëtarë të një njësie policore paraushtarake të njohur.[113]

Në shkurt 2009 Amnesty International zbuloi se të afërmit e viktimave të zhdukjeve me

forcë, trupat e të cilëve ishin gjendur në Serbi, nuk kishin marrë asnjë informacion as nga policia serbe dhe as nga UNMIK-u lidhur me hetimet në vazhdim.[114]

### GJYKIMET NË SERBI TË SHQIPTARËVE ETNIKË PËR KRIME LUFTE

Serbia ka ushtruar gjithashtu juridiksion në Kosovë dhe ka ndjekur penalisht dy shqiptarë etnikë të dyshuar për krime lufte lidhur me rrëmbime gjatë konfliktit dhe në vijim të tij. Përveç rastit të Anton Lekajt, (shih seksionin më poshtë "Ndërhyrjet politike në rrjedhën e drejtësisë"), në dhjetor 2007, Sinan Morina, një ish-ushtar i UÇK-së, u shpall i pafajshëm për të gjitha akuzat për krime lufte, përfshirë dhe ndalimin e paligjshëm të civilëve serbë në Rahovec/Orahovac në korrik 1998, gjatë një konflikti të brendshëm të armatosur.[115] Edhe 10 shqiptarë etnikë të tjerë, që jetonin në Preshevë, në jug të Serbisë, u arrestuan në dhjetor 2008 me dyshimin e rrëmbimit të 159 personave kryesisht serbë, në Gjilan/Gnilane në Kosovë, dhe vrasjen e të paktën 51 prej tyre në 1999 gjatë një konflikti të armatosur. Ata ndodhen në ndalim paragjyqësor.[116]

## HETIMET DHE NDJEKJET PENALE TË KRYERA NGA UNMIK-U

UNMIK-u gjithashtu kërkoi juridiksion për hetimin e zhvendosjeve dhe rrëmbimeve me forcë që u kryen në Kosovë në kuadrin e konfliktit të armatosur dhe në vijim të tij. Hetime penale u ndërmorën deri në dhjetor 2008 nga policia e UNMIK-ut, fillimisht nga Njësia e Personave të Pagjetur në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Hetimeve Penale (NJQHP)[117] dhe më pas nga një Njësi e dedikuar për Krime Lufte (NJKL). (Kjo përgjegjësi u mor përsipër nga Komponenti Policor i EULEX-it që nga dhjetori 2008.) Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), i krijuar që nga shtatori 1999, u përjashtua nga këto hetime.

Anëtarët e Amnesty International, si pjesë e fushatës së organizatës për drejtësi për viktimat e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë, kanë kërkuar rregullisht nga viti 1999 informacion prej UNMIK-u lidhur me progresin e hetimeve. Në dhjetor 2008 organizata u informua se UNMIK-u kishte hapur hetimet për rrëmbimin e 26 personave, që përfshihen në dosjen e Amnesty International të 41 rasteve emblematike të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë. Për më tepër, dy raste që lidhen me 17 viktima të zhdukjes me forcë, i ishin transferuar Prokurorisë Ndërkombëtare, por për asnjë nuk ishte ndërmarrë asnjë ndjekje penale (shih Shtojcën 1: Rastet Emblematike).[118]

Në prill 2004, Zëvendës Komisioneri i atëhershëm i Policë së UNMIK-ut për Krimet, Robbie Pedlow e siguroi Amnesty International se disa "rastet të pazgjidhura" po rishikoheshin nga "njësia e krimeve të pazgjidhura" krijuar në fillim të vitit 2003, por asnjë rast i zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë nuk ishin përcjellë për hetim deri në fund të vitit. Në prill 2006, Drejtori i Policisë së UNMIK-ut për Hetimet Penale, Wayne Hissong, informoi Amnesty International se disa raste të rëndësishme ende mund të hetoheshin, aty u ishin dhënë provat e mjekësisë ligjore, por (duke qenë se i jepej përparësi krimit të organizuar dhe korrupsionit), nuk kishte gjasa të hapeshin shumë hetime për pjesën e mbetur të zhdukjeve me forcë dhe rrëmbimeve.[119]

Edhe pse policia e UNMIK-ut nuk ka asnjë detyrim për t'i dhënë Amnesty International hollësi për përparimin e hetimeve penale, organizata është shumë e shqetësuar se UNMIK-u nuk ka përmbushur detyrimin për njoftimin e anëtarëve të familjes të personave të zhdukur dhe të rrëmbyer lidhur me zhvillimin e hetimeve. UNMIK-u ka detyrë të veprojë kështu në përputhje me Nenin 2 të KEDNJ.[120] Amnesty International ka zbuluar se në shumë raste

anëtarët e familjes, pasi kanë paraqitur fillimisht pranë policisë së UNMIK-ut deklaratat e tyre, nuk janë kontaktuar më prej policisë për disa vite me radhë. Në raste të tjera, ata nuk janë informuar si duhet për ecurinë e hetimit. Për shembull, në rastet në vijim, Amnesty International u informua në dhjetor 2008 se dosja i ishte dërguar prokurorisë, por familja nuk ishte njoftuar, deri sa Amnesty International e informoi në një takim në shkurt 2009.

Tetë anëtarë të familjes të Ferdonija Qerkezit janë ende të pagjetur. Trupat e dy anëtarëve të tjerë, Artan dhe Edmond Qerkezi, u kthyen në dhjetor 2005. Ferdonija Qerkezi i tha Amnesty International: "Në 2008-n u njoftova se çështja ishte ende e hapur. Një polic erdhi më takoi dy ose tre herë, por pastaj ai e mbaroi misionin e tij." Por kushërira e saj Laura Ymeraga, burri i së cilës Shpejtim Ymeraga u arrestua me të njëjtin grup, i tha organizatës: "Policia nuk më ka bërë vizitë, por dy ose tre muaj më parë i ranë telefonit për të më pyetur nëse isha ende e interesuar për të gjetur trupin."

Trupat e anëtarëve të familjes Dana u zhvarrosën në Batajnicë të Serbisë. Trupi i Afrim Danës iu kthye familjes së tij në 15 janar 2005 dhe ata të pesë anëtarëve të tjerë të familjes, më 25 gusht 2005. Avni Dana i tha Amnesty International: "S'ma merr mendja që prokurori ta ketë hapur këtë çështje apo të ketë bërë akt-akuzë. Ne nuk jemi informuar për ndërmarrjen e ndonjë veprimi. Vetëm nëse policia apo prokuroria do na kontaktojnë dhe do na japin informacion të hollësishëm mbi çështjen, do besojmë se policia apo prokuroria po bëjnë diçka për zgjidhjen e saj. Nuk u besoj atyre. Ku e gjetën këta persona [prokuroria dhe policia] informacionin për rastin e djemve tanë, sepse ne nuk jemi kontaktuar kurrë prej tyre? Policia jonë [SHPK-ja] apo UNMIK-u duhet të kishin ardhur tek ne dhe të na pyesnin si ndodhi çdo gjë."[121]

Në një rast tjetër, anëtarë të familjes së një grupi tjetër burrash dhe grash të arrestuar nga forcat serbe në Gjakovë/Đakovica i thanë Amnesty International se, megjithëse kishin paraqitur deklarata tek policia e UNMIK-ut në 1999 dhe 2000, në verën e vitit 2008, policia e UNMIK-ut i kontaktoi dhe u kërkoi të shkruanin dëshmitë. Në raste të tjera, sipas një OJQ-je vendase, disa dëshmitarëve dhe të afërmve u ishte kërkuar të paraqitnin dëshmitë e tyre në polici çdo gjashtë muaj, për shkak të mandatit të shkurtër të punonjësve të policisë në Kosovë, ndërkohë që një tjetër punonjës policie UNMIK-u kishte filluar të merrej me çështjen.

Djali i Petrija Piljeviqit, një gruaje serbe e cila besohet se në 28 qershor 1999 ishte rrëmbyer nga UÇK-ja prej apartamentit të saj në Prishtinë, i tha Amnesty International në fillim të vitit 2009, se ai nuk ishte kontaktuar nga ndonjë punonjës policie që prej vitit 2003. Sipas D.P., A.K. ,një hetues i policisë së UNMIK-ut, i bëri një vizitë në shtëpi në Prokuplje në pjesën jugore të Serbisë dhe e pyeti lidhur me vrasjen e nënës. D.P. i tha Amnesty International se pak pas kësaj vizite, ai mori një telefonatë nga A.K., i cili sipas tij i ka thënë se ishte i detyruar ta linte hetimin dhe se po transferohej nga Kosova. Policia e UNMIK-ut nuk e ka kontaktuar D.P. që atëherë; në fakt UNMIK-u në dhjetor 2008 raportoi se nuk e kishte të regjistruar gruan si subjekt të një raportimi penal apo hetimi.[122]

Të afërm të tjerë e informuan Amnesty International se, pavarësisht nga raportimi tek policia e UNMIK-ut i zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë të të afërmve të tyre, ata nuk ishin kontaktuar më pas nga policia ose nuk ishin njoftuar lidhur me ndonjë hetim.

Amnesty International ka arritur në përfundimin se në shumë raste policia e UNMIK-ut nuk filluar ose ka zhvilluar një hetim më shumë se sipërfaqësor. Shkalla e këtij dështimi iu

konfirmua Amnesty International në nëntor 2007 nga anëtarë të Ekipit Planifikues të BE (EPBE).[123] Në dhjetor 2008 policia dhe prokurorët e EULEX-it morën nga policia e UNMIK-ut dhe programi GJPN-së i UNMIK-ut përgjegjësinë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, krimeve ndëretnike, dhe krimeve të tjera të rënda. Në shkurt 2009 ata e informuan Amnesty International se nga 1200 dosje hetimi penal, vetëm në 550 prej tyre kishte ndonjë shenjë që tregonte se po kryhej një hetim "aktiv" nga ana e policisë së UNMIK-ut.

Amnesty International pranon se, në ndryshim nga Serbia, ku ekzistonin institucione që funksiononin, UNMIK-u fillimisht hasi në probleme të theksuara për krijimin, organizimin dhe pajisjen me një polici dhe gjyqësor menjëherë pas konfliktit të armatosur - përfshirë dhe kohën që u desh për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm. Megjithatë, mungesa e progresit në vijim, përbën shqetësim serioz.

"Ju lutem na ndihmoni të zgjidhim çështjet deri në fund, jo si veproi UNMIK-u. Lanë çdo gjë të pazgjidhur. Do ju jap emrin e policit që më mori burrin dhe djalin dhe ai do t'ju tregojë se çfarë bëri me ta, dhe si i vrau. Ju kërkoj që përgjegjësit për krimet të sillen para drejtësisë nëse ka ligj."

Flora Bunjaku, Gjakovë/Đakovica, shkurt 1999. Nëna e Bekim Bunjakut (15 vjeç) dhe gruaja e Lufti Enver Bunjakut (47 vjeç) trupat e të cilëve u zhvarrosën nga Peruçac (Bajina Bashtë) në shtator 2001 dhe iu kthyen familjes së tyre në 20 shtator 2006. Në dhjetor 2008 UNMIK-u informoi Amnesty International se çështja ishte në fazën fillestare të hetimit.

### NDJEKJET PENALE NË KOSOVË

Deri në fund të vitit 2008, Gjyqtarët dhe Prokurorët Ndërkombëtarë të UNMIK-ut kishin zgjidhur afërsisht 40 çështje për krime lufte. Në 2009-n, prokurorët e EULEX-it e informuan Amnesty International se kishin marrë nga UNMIK-u afërsisht 66 çështje për krime lufte në faza të ndryshme të hetimit, ndjekjes penale apo apelimit.[124]

Ish-Shefi i Njësisë së Monitorimit të Sistemeve Ligjore (NJMSL) të Departamentit të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit të OSBE-së, i ngarkuar me monitorimin e sistemit ligjor në Kosovë,[125] dhe një Këshilltar Ligjor i NJMSL-së, që së bashku kishin përcjellë përpjekjet e UNMIK-ut në ndërtimin e sistemit ligjor, arritën në përfundimin se: "UNMIK-u nuk zhvilloi një strategji koherente për sektorin e drejtësisë, përfshi këtu dhe rastet e krimeve të luftës. Zgjodhi në vend të kësaj strategjie një përqasje të ngurtë, që ishte katastrofike për të akuzuarit dhe viktimat, e në veçanti për serbët e Kosovës."[126]

Thuajse gjysma e çështjeve të ndjekura penalisht nga UNMIK-u lidhen me 21 çështjet kundër atyre serbëve të Kosovës të cilët deri nga nëntori 1999 ishin arrestuar në Kosovë me akuzat për kryerjen e krimeve të luftës sipas Nenit 142 të Kodit Penal të RFJ-së (krime lufte kundër popullsisë civile), përfshi këtu dhe akuzat për "marrjen peng" dhe detyrimin e personave për tu përfshirë në punë të detyruar.[127] Nëntëmbëdhjetë prej këtyre çështjeve ishin përfunduar nga mesi i vitit 2002. Gjykimi filloi në 5 nëntor 1999, fillimisht para panelit të gjyqtarëve shqiptarë. Në vijim të protestave dhe grevave të urisë nga të dyshuarit serbë të ndaluar në burgun e Mitrovicës, lidhur me periudhën e gjatë të ndalimit të tyre (në disa raste deri 10 muaj pa u akuzuar) dhe shqetësime të ngritura nga OSBE-ja lidhur me paanshmërinë e panelit shqiptar për të vendosur këto çështje, UNMIK shpalli rregullore dhe prezantoi panele të përbëra në shumicë nga gjyqtarë ndërkombëtarë. Më pas UNMIK-u

prezantoi prokurorët ndërkombëtarë me kompetencë mbi rastet e krimeve të luftës dhe krimeve ndër-etnike.[128] Pjesa më e madhe e këtyre gjyqeve u përfunduan nga fundi i vitit 2002 edhe pse në nëntor 2007 Miroslav Vuqkoviq, fillimisht i dënuar në janar 2001, priste për herë të tretë, pas disa apeleve, gjykimin në shkallën e parë.[129]

Nga viti 2002 nuk është kryer asnjë ndjekje penale për zhdukjet me forcë – procedimet janë kryer thuajse në mënyrë ekskluzive kundër ish-anëtarëve të UÇK-së për rrëmbimin, ndalim të paligjshëm, torturimin, dhe vrasjen e shqiptarëve të tjerë etnikë të dyshuar nga UÇK-ja për bashkëpunim me autoritetet serbe. Secili nga gjyqet e mëposhtme u zhvillua nga prokurorët e UNMIK-ut para një paneli gjykatësish ndërkombëtarë.

Idriz Balaj, Daut Haradinaj, Bekin Zekaj, Ahmet Elshani dhe Ramush Ahmetaj u dënuan në Gjykatën e Rrethit të Pejës/Peć në 17 dhjetor 2002, për bashkëpunim në ndalimin e jashtëligjshëm dhe për bashkëpunim në ndalimin e jashtëligjshëm me pasojë vdekjen e katër shqiptarëve etnikë në shtator 1999. Idriz Balaj u dënua me 15 vjet burg, Daut Haradinaj dhe Bekin Zekaj u dënuan me pesë vjet dhe Ahmet Elshani dhe Ramush Ahmetaj tre vjet secili. U lëshuan në dhjetor 2003, pas një apeli për dënimin e tyre.[130]

Procedimet filluan në 17 shkurt 2003 kundër shqiptarëve të Kosovës, Latif Gashi, Rrustem Mustafa, Naim Kadriu dhe Nazif Mehmeti, të cilët akuzoheshin për pjesëmarrje në ndalimin, torturim, dhe vrasje të paligjshme gjatë periudhës gusht 1998 deri në qershor 1999. Njëzet e pesë viktima ishin shqiptarë etnikë dhe një ishte Millovan Stankoviq, serb i rrëmbyer dhe më pas torturuar në një qendër ndalimi të UÇK-së në Bajgorë, në periudhën gusht-shtator 1998. Latif Gashi u dënua me 10 vjet burg, Rrustem Mustafa me 17 vjet, Nazif Mehmeti me 13 vjet dhe Naim Kadriu me pesë vjet. Në vijim të një apeli, u rihap gjyqi në 29 nëntor 2007, por asnjë procedim vijues nuk është zhvilluar deri në maj 2009.[131]

Në 10 gusht 2006 ish-oficerët e lartë të UÇK-së, Selim Krasniqi, Bedri Zymberi dhe Agron Krasniqi u dënuan për krime lufte, përfshi dhe ndalimin e paligjshëm dhe rrëmbimin e shqiptarëve në fshatin Drenovc/Drenovac (Malishevë) gjatë qershor-korrikut 1998. Secili u dënua me shtatë vjet burgim. Në apelin e prillit 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, e kryesuar nga një gjykatës i EULEX-it dhe e përbërë nga dy gjyqtarë ndërkombëtarë dhe dy gjyqtarë kosovarë, e pranoi pjesërisht apelin e bërë nga tre burrat, duke ulur dënimin për Selim Krasniqin dhe Bedri Zymberin në gjashtë vjet dhe dënimin për Agron Krasniqin në katër vjet e gjashtë muaj.[132]

Në 8 shkurt 2007 Idriz "Galani" Gashi u dënua për krime lufte kundër popullsisë civile dhe u akuzua për vrasjen e Sanije Balajt në gusht 1998 afër fshatit Vranoc/Vranovac në komunën e Pejës/Peć. Sanije Balaj u rrëmbye në 12 gusht 1998, pasi u ndalua në një pikë kontrolli të UÇK-së, dhe u mor për t'u pyetur. Trupi i saj u gjet në 11 shtator 1998; ishte goditur në kokë. Në 22 qershor 2007 Idriz Gashi u dënua për vrasjen e saj nga një panel gjyqtarësh ndërkombëtarë në Gjykatën e Rrethit të Pejës/Peć me 15 vjet burg.[133]

Deri tani asnjë ndjekje penale nuk është ndërmarrë kundër anëtarëve të UÇK-së të dyshuar për rrëmbimin e serbëve, romëve, dhe pakicave të tjera, të cilat ndodhën pas qershorit 1999.

## PENGESAT PËR T'I DHËNË FUND MOSNDËSHKIMIT

Amnesty International gjykon se hetimet dhe ndjekjet penale si në Serbi dhe Kosovë janë rrethuar nga pengesa për kapërcimin e të cilave autoritetet përkatëse kanë vepruar fare pak. Disa prej këtyre pengesave (të diskutuara më poshtë) janë krijuar nga vetë autoritetet ose nga organet ndërkombëtare që funksionojnë në Kosovë. Për më tepër, Amnesty International pranon se ndërsa Serbia kishte një polici dhe gjyqësor të paprekur menjëherë pas luftës, në Kosovë nuk kishte gjykata apo sistem gjyqësor të ngritur (pjesa më e madhe e gjyqësorit shqiptar të Kosovës ishte shpërndarë nga autoritetet serbe gjatë viteve 90-të) kështu që UNMIK-u duhet t'ia fillonte punës nga e para.

### MOHIMI I QASJES NË PROVA

Amnesty International shqetësohet se provat ekzistuese lidhur me zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë nuk iu vunë në dispozicion autoriteteve përkatëse.

Organizata është e shqetësuar në mënyrë të veçantë se provat e mbledhura nga Tribunali lidhur me zhvarrimet, personat e pagjetur, dhe vendndodhjet e varreve nuk iu vunë në dispozicion ZPZHML-së deri në 2008-n. Për më tepër, ndonëse në disa raste specifike Tribunali ka ofruar informacion, organizata vazhdon të jetë e shqetësuar se afro 72000 faqe dokumentacioni lidhur me hetimet penale të Tribunalit në Kosovë nuk i janë vënë në dispozicion nga Tribunali policisë dhe prokurorëve.[134] Edhe pse Amnesty International e kupton se informacionet lidhur me procedimet në vazhdim nga Tribunali nevojiten të mbeten konfidenciale, organizata vëren se hetimet e policisë së UNMIK-ut (dhe në një farë mase ato të Serbisë) u dëmtuan nga mungesa e këtij informacioni.

Për më tepër, Amnesty International shpreh shqetësimin se provat, përfshirë fotot e vendndodhjeve të ndryshme të varreve dhe informacione të tjera lidhur me trupat e gjetur (dhe në disa raste të djegur), nuk i janë vënë në dispozicion nga KFOR-i hetueseve të UNMIK-ut apo EULEX-it. Shumë të afërm të serbëve të rrëmbyer në Kosovë në vijim të konfliktit, i raportuan rrëmbimet e tyre tek batalioni vendas i KFOR-it. Sipas informacionit që ka në dispozicion Amnesty International, asnjë informacion i dhënë batalionit të KFOR-it nga të afërmit, duke përfshirë deklaratat, fotografitë e personave të pagjetur dhe dokumentet e identifikimit, nuk i është vënë në dispozicion autoriteteve që kanë mandatin për hetimin e këtyre krimeve në Kosovë.

Për tu siguruar që i gjithë informacioni i përshtatshëm lidhur me vendndodhjet e varreve të bëhet i disponueshëm, "KNKK-ja ka kërkuar bashkëpunimin e Tribunalit dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, që kanë qenë të pranishme në Kosovë gjatë dhe në vijim të konfliktit, për të marrë informacion të mëtejshëm për personat e zhdukur. Duke pasur parasysh rolin e luajtur nga komuniteti ndërkombëtar në Kosovë, KNKK-ja ka rekomanduar që të gjitha vendet anëtare të KB që kanë luajtur një rol në Kosovë, të shqyrtojnë dokumentacionin e tyre për të parë nëse kanë informacion që lidhet me eshtrat, varret apo të zhdukurit në përgjithësi."[135]

Amnesty International gjykon se mosdorëzimi nga ana e Tribunalit dhe KFOR-it i provave të mbledhura në 1999-2000 menjëherë pas krimeve, mund të shërbejë si një pengesë serioze për zgjidhjen e fatit të disa personave që kanë qenë subjekt i zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë. Diskutimet e Amnesty International me anëtarët e familjeve të tyre tregojnë se mosdorëzimi i provave dhe mospërcaktimi dhe informimi i familjeve për fatin dhe

vendndodhjen e të dashurve të tyre, janë burime të një ankthi të madh për familjarët. Shumë prej tyre mendojnë se komuniteti ndërkombëtar, i cili erdhi për t'i mbrojtur dhe për të rivendosur sundimin e ligjit, i ka lënë në baltë.

**E drejta për të ditur – roli i KFOR-it**

Halim Qerkezi (53 vjeç), Artan Qerkezi (25), Armend Qerkezi (24), të dy djem të Halim Qerkezit, Ardian Qerkezi (19), Edmond Qerkezi (14), Vegim Qerkezi, nipi i Halim Qerkezit (19), Shpejtim Ymeraga, kushëri i Halim Qerkezit (32), Skënder Dylhasi (59), Myrteza Dylhasi (26), Fatos Jetishi (21) dhe Shpend Jetishi (20) u morën të gjithë nga shtëpia e familjes Qerkezi në Gjakovë/Đakovica në orën 19:30 në 27 prill 1999. Kartat e identitetit u ishin marrë nga policia vendase më herët po atë ditë. Burrat u ngarkuan në një kamion pa shenja dalluese dhe u morën nga burra të maskuar që Arta Qerkezi, gruaja e Artan Qerkezit, beson se ishin policë serbë.[136]

Në muajt e mëvonshëm familja u përpoq intensivisht, por pa sukses, të zbulonte fatin e burrave, duke shkuar shpesh në stacionet e policisë serbe për të raportuar zhdukjen me forcë të tyre dhe për të kërkuar informacion. Iu tha shumë herë se ishte a pamundur të merrej informacion pasi linjat e telefonave nuk punonin; se burrat ishin dërguar në Shqipëri; dhe se duhet t'i kërkonin informacion NATO-s. Ata kërkuan gjithashtu ndihmë nga një punonjës i policisë, të cilin Halim Qerkezi e kishte njohur si një nga burrat që kishte ardhur në shtëpinë e tyre në 27 prill, dhe i cli më vonë ishte parë duke vozitur një makine familjare, të vjedhur po atë ditë. Polici mohoi së kishte dijeni apo përgjegjësi për zhdukjet me forcë.

Në shtator 1999, sipas Kasim Qerkezit, axhës së Artan Qerkezit, një fshatar nga Liqeni Shkoza/Škoza afër Prizrenit i solli familjes kartën e identitetit të Artan Qerkezit. E kishte gjetur pranë Liqenit të Shkozës/Škoza. Kasim Qerkezi shkoi tek liqeni, pranë Vërmicës/Vrbnica. Ai i tregoi Amnesty International në shkurt 2009 çfarë kishte ndodhur:

*"Fillimisht kam shkuar atje me disa burra të tjerë dhe e pashë Artanin dhe të tjerët. E dallova Artanin nga rrobat. Iu afrova trupit dhe i preka rrobat me një shkop. E identifikova 100 për qind. Ai ishte në breg të lumit: Armendi, Ardiani dhe Myrtezani ishin pranë Artanit – të gjithë trupat ishin gjysmë brenda liqenit, e gjysmë jashtë tij. Nuk e di nëse ishin ekzekutuar atje apo diku tjetër."*

*"Njoftova KFOR-in dhe shkova me ta të shihja trupat. KFOR-i nuk na lejoi të afroheshim: na thanë se ishte e rrezikshme. KFOR-i na tha se do të merrnin dhe identifikonin trupat, dhe ne* [familjet] *menduan se ndoshta do të kishte trupa të tjerë* [në liqen], *pasi ata ishin të gjithë të transportuar* [nga Prizreni] *në të njëjtin kamion. Nuk e pamë kamionin, por gratë kishin parë një kamion kur u morën burrat."*

"Më pas shkova tek TPNJ-ja dhe pashë trupat dhe ata na premtuan se TPNJ-ja do i identifikonte dhe do ia jepte familjeve. Ne i besuam. Hetuesi i TPNJ-së, Z. Cliff, shkoi tek vendi i ngjarjes dhe unë ia tregova. Mos u brengos, më tha, ne do t'i mbledhim ata [trupat] dhe do të kujdesemi për ta. Kjo ka qenë ndoshta nga tetori 1999."

*"Shkuam tek UNMIK-u për të marrë rezultatet dhe na thanë mos hajdeni këtu se nuk është kjo procedura. Nuk na e morri mendja se do shkonte kaq gjatë për të marrë trupat."*[137]

Ferdonije Qerkezi deklaroi veçmas se ajo kishte qenë tek vendi në Vërmicë/Vrbnica dhe i kishte parë trupat, përfshi dhe ato të cilët ajo besonte të ishin trupat e burrit dhe djalit të saj, Vegim Qerkezit dhe Halim Qerkezit.

Trupi i Artan Qerkezit u zhvarros nga Tribunali në 2000-ën në Vërmicë/Vrbnica, komunën e Prizrenit dhe iu kthye familjes në 15 dhjetor 2005. Trupi i Edmond Qerkezit u zhvarros nga Tribunali në 2000-ën në një vend tjetër në komunën e Gjakovës/ Đakovica dhe iu kthye familjes më 15 dhjetor 2005.138 fati dhe vendndodhja e Vegim Qerkezit, Halim Qerkezit, Armend Qerkezit, Ardian Qerkezit, Myrtezan Dylhasit, Skënder Dylhasit, Shpejtim Ymeragas, Fatos jetishit, dhe Shpend Jetishit, të cilët ishin ndaluar dhe zhdukur së bashku me Artan dhe Edmond Qerkezin në 27 prill 1999, nuk u janë treguar asnjëherë familjes së tyre.

MUNGESË BASHKËPUNIMI

Si Serbia dhe UNMIK-u gjykojnë se kanë pasur juridiksion për krimet e luftës në Kosovë, por nuk kanë krijuar ndonjë marrëveshje teknike të efektshme apo kornizë për bashkëpunim. Duke pasur parasysh konfliktin e armatosur dhe, më pas, mungesën e një marrëveshjeje ndërmjet Serbisë dhe Kosovës mbi çështjen problematike të statusit përfundimtar të Kosovës, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Serbisë dhe UNMIK-ut lidhur me hetimet dhe ndjekjet penale nuk është për tu habitur, por megjithatë mbetet një pengesë e vajtueshme për drejtësinë.

Serbia perceptohet me të drejtë nga Kosova si e ngadaltë në ndjekjet penale kundër forcave serbe që konsiderohen përgjegjëse për krimet e luftës të kryera në kuadrin e konfliktit me Kosovën. Ndërkohë autoritetet serbe konsiderojnë mungesën e ndjekjeve penale nga UNMIK-u, të anëtarëve të UÇK-së për krimet e kryera kundër serbëve, si tregues të asaj që ata e perceptojnë si njëanshmëri të UNMIK-ut në favor të komunitetit të shqiptarëve etnikë.

Bruno Vekariq, zëdhënësi i Zyrës së Prokurorisë të Krimeve të Luftës (ZPKL) në Serbi, i tha Amnesty International se zyra rrallë kishte marrë ndonjë reagim për provat që i dërgonte policisë së UNMIK-ut.[139] Për shembull, në 2 nëntor 2003, në gazetën e përditshme të Beogradit *Vecernje Novosti* u publikuan foto të ca burrave të veshur me uniformën e UÇK-së, që mbanin koka të prera serbësh të Kosovës . QDH-ja i kishte shkruar Prokurorit Ndërkombëtar në Kosovë për të kërkuar fillimin e një hetimi lidhur me mënyrën sesi të vdekurit gjetën vdekjen, dhe si burrat në foto kishin mundur të merrnin në posedim kokat e tyre. Ndonëse në nëntor 2003 UNMIK-u i konfirmoi Institutit për Raportimin e Luftës dhe Paqes se ishte hapur një hetim, asnjë progres nuk është raportuar që nga ajo kohë edhe pse ZPKL-ja thotë se ka paraqitur prova që lidhen me fotot tek Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, si dhe emrat e personave të zhdukur nga Deçan /Dečan, kokat e të cilëve tregoheshin në foto.[140]

Pas krijimit të ZPKL-së në Serbi në 2003-shin, u krijua një farë bashkëpunimi. ZPKL-ja, për shembull ka marrë (dhe vazhdon të marrë) informacion mjeko-ligjor nga ZPZHML-ja në Kosovë. Megjithatë ZPKL-ja në Serbi nuk ka qasje në vendndodhjet në Kosovë. Për më tepër ZPKL-ja dhe gjyqtarët hetues në Serbi kanë raportuar pengesa për intervistimin e dëshmitarëve shqiptarë të Kosovës lidhur me ndjekjen penale të të dyshuarve serbë. ZPKL-ja mbështetet tek UNMIK-u për të pasur qasje tek këta dëshmitarë, por pretendon, për shembull, se në çështjen e Suharekës, UNMIK-u nuk lehtësoi aksesin tek dëshmitarët. Raportohet se UNMIK-u e ka mohuar këtë.[141] Amnesty International vëren se në çështjen e Suharekës (shih më sipër "Hetimet dhe ndjekjet penale në Serbi"), të tre dëshmitarët kryesorë u bindën përfundimisht të jepnin dëshmi në procedimet serbe vonë në 2007-n vetëm pas inkurajimit, ndihmës dhe mbështetjes së QDH-së, roli pozitiv i së cilës është njohur nga ZPKL-ja. Në rastin e Anton Lekaj (shih më poshtë "Ndërhyrjet politike në

rrjedhën e drejtësisë"), në 6 qershor 2006, një prokuror dhe një gjyqtar hetues nga ZPKL-ja e Serbisë mbërritën në Prishtinë në pritje të intervistimit të gjashtë dëshmitarëve. Por UNMIK-u miratoi intervistimin e vetëm dy dëshmitarëve, të cilët ishin dëshmitarë për të akuzuarin, pasi kërkesat nga ZPLK-ja ishin paraqitur shumë vonë.[142] Gjyqtari Miroslav Ampliq nga DHSKL-ja dhe kryeprokurori në çështjet që lidhen me Dragoljub Stankoviqin thanë se PSSP Soren Jessen-Petersen kishte lejuar vetëm intervistimin nga ZPKL-ja të dëshmitarëve për të akuzuarin. Ata më pas refuzuan të merrnin pjesë në seancën gjyqësore duke pretenduar ndërhyrje direkte të ekzekutivit në gjyqësor.[143]

Ndonëse Bruno Vekariqi ishte realist lidhur me delikatesën politike të bashkëpunimit me EULEX-in (autoriteti në Kosovë i të cilit nuk pranohet nga Serbia), ZPKL-ja e ka njohur nevojën e këtij bashkëpunimi. Edhe pse prokurorët e ZPLK-së dhe EULEX-it e kanë bërë mbledhjen e parë vetëm në mars 2009, Amnesty International shpreson se kjo është vetëm e para e shumë të tjerave që do të vijnë më pas dhe shpreson se mbledhja ishte shenjë e dëshirës për të bashkëpunuar në hetimin e krimeve të luftës në kuadrin e konfliktit në Kosovë dhe në vijim të tij.

Rasti më poshtë ilustron disa nga problemet që hasen në krijimin e një bashkëpunimi, jo vetëm ndërmjet Serbisë dhe hetueseve në Kosovë, por edhe ndërmjet Tribunalit dhe vendeve të tjera në kufi me Kosovën.

## "SHTËPIA E VERDHË"

*"Djali im 17 vjeçar është zhdukur; jam ende duke kërkuar për të. Imagjino si u ndjeva kur dëgjova për 'Shtëpinë e Verdhë'. Po më çmend, 'Shtëpia e Verdhë' ..."*[144]

Në tetor 2008 Vladimir Vuqkeviqi i ZPKL-së vizitoi Shqipërinë për hetimin e pretendimeve se më se 300 serb ishin rrëmbyer nga anëtarë të UÇK-së gjatë 1999 dhe ishin dërguar tek "Shtëpia e Verdhë" pranë qytetit Burrel në Shqipëri. Prokurori i Përgjithshëm nuk i dha leje për të zhvilluar hetime në Shqipëri, pasi hetimi i kryer nga Tribunali nuk kishte zbuluar prova që mbështesnin pretendimet se serbët ishin transferuar në atë vend. Hetimi i ZPKL-së u krye në vijim të pretendimeve të botuara nga ish-Kryeprokurorja e Tribunalit, Karla del Ponte, se serbët ishin rrëmbyer për t'ua hequr organet me operacion dhe për t'i shitur.[145]

Edhe pse tashmë është fakt se UNMIK-u zhvilloi një hetim lidhur me pretendimet e 2004-ës, ai fillimisht mohoi çdo lloj interesi në këtë çështje. Në qershor 2008, ZPKL-ja në Serbi mori një letër nga Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut, që thoshte se asnjë prokuror ndërkombëtar nuk ishte përfshirë në "hetimin e një rasti që buronte nga këto pretendime." UNMIK-u më pas i dërgoi ZPKL-së një raport të plotë lidhur me hetimin në 22 mars 2009.[146]

Çështja ishte deri në maj 2009 nën hetim nga ZPKL-ja dhe Senatori Dick Marty, që heton çështjen në cilësinë e tij si raportues për Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Pas raportimeve të BBC-së në MB në prill 2009, që pretendonin rrëmbimin dhe më pas torturimin e serbëve nga anëtarë të UÇK-së në "Shtëpinë e Verdhë", zyrtarë të lartë të qeverisë së Kosovës i hodhën poshtë këto pretendime. Kryeministri Hashim Thaçi tha në një transmetim të BBC-së, se personat e përfshirë kishin abuzuar uniformën e UÇK-së, ndërkohë që Presidenti Fatmir Sejdiu thuhet të ketë thënë më vonë "Dikush ka menduar t'i bëj dëm Kosovës. Por nuk ka për të funksionuar."[147]

## PENGESAT NDAJ HETIMEVE: POLICIA E UNMIK-UT

Amnesty International gjykon se policia e UNMIK-ut nuk ka zhvilluar hetime të përshtatshme lidhur me krimet e luftës dhe krimet e rënda të kryera për motive etnike, duke përfshirë dhe rrëmbimet e pas luftës të serbëve dhe romëve. UNMIK-u kishte juridiksion mbi këto krime deri në dhjetor 2008. Ashtu sikurse dhe Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë (IOK) raportoi në 2003-shin, "[n]ë disa raste viktimat e këtyre krimeve dhe familjet e tyre kanë pritur për rezultate nga hetimet e policisë për më shumë se tre vjet tashmë, shpeshherë edhe pa u informuar si duhet mbi të rejat e rasteve përkatëse."[148]

IOK-ja, Amnesty International dhe organizma të tjerë ia kanë atribuuar këtë dështim shumë faktorëve duke përfshirë: ndryshimin e vazhdueshëm dhe të shpeshtë të personelit hetues, me oficerët e policisë së UNMIK-ut që shpeshherë qëndronin në detyrë jo më shumë se gjashtë muaj, duke sjellë si pasojë një mungesë në vijimësinë e hetimit, një përsëritje të shpeshtë të intervistave nga oficerët pasardhës, apo një lënie pas dore në raste të tjera. Për më tepër, shumë oficerë pranë NJPP-së dhe NJHKL-së kishin pak ose aspak eksperiencë në hetimin e krimeve të rënda, për të mos përmendur krimet e luftës dhe krimet ndër-etnike (për shembull policia e Ministrisë së Mbrojtjes së MB). Në pjesën më të madhe të rasteve, duke mos qenë në gjendje të flisnin gjuhën vendase e duke përjashtuar anëtarët e SHPK-së nga pjesëmarrja në hetime, policia e UNMIK-ut gjeti pak bashkëpunim tek komunitetet dhe dëshmitarët vendas. Megjithatë, siç deklaron edhe Ombudspersoni: "[Kjo] nuk mund të shërbejë si një justifikim i vlefshëm për paaftësinë e autoriteteve zbatuese të ligjit për të arritur rezultatet hetuese të pritura, në mënyrë të veçantë në rastet që kishin të bënin me krime të rënda."[149]

Për më tepër, duket se nuk është krijuar asnjë procedurë hetimore penale e efektshme. Sipas Matti Raatikainen, Shefi i NJHKL-së i EULEX-it, policia e UNMIK-ut kishte vetëm një sistem "të thjeshtë" të dhënash. Dosje të përbëra prej më shumë se 30000 faqesh në letër, nuk ishin kompjuterizuar, duke shkaktuar një problem të madh në gjetjen e dokumenteve, siç vërtetohet edhe nga informacioni kontradiktor lidhur me statusin e disa çështjeve individuale dhënë nga UNMIK-u Amnesty International.[150]

## PENGESAT NDAJ HETIMEVE: POLICIA SERBE

Amnesty International gjykon se klima e mosndëshkimit në radhët e policisë serbe, e edhe mbështetur nga figura politike drejtuese, përfshirë këtu Ministrinë e Brendshme, paraqet një nga pengesat më të konsiderueshme për hetimin e krimeve të luftës, duke përfshirë dhe zhvendosjet me forcë.[151] Kjo pengesë haset si në rang ministror dhe vendor.

Në 23 dhjetor 2004, QDH-ja botoi pretendime lidhur me djegien e kufomave të civilëve shqiptarë të Kosovës në furrnaltën e fabrikës së Mačkatica në Surdulicë në 16 dhe 24 maj 1999. QDH-ja raportoi se djegiet e pretenduara ishin pjesë e një operacioni në shkallë të gjerë për fshehjen e krimeve të luftës të kryera në Kosovë. Qendra paraqiti informacion të hollësishëm mbi personat që besoheshin të ishin përgjegjës dhe në 2005-n bëri publike provat lidhur me Njësinë e Policisë Speciale që pretendohet të ketë transportuar trupat në Mačkatica, duke përmendur zyrtarë të lartë sigurimi, si të mëparshëm dhe aktualë, dhe duke pretenduar se dinte emrat e shoferëve të kamionëve.

Në 16 janar 2005, QDH-ja raportoi se në vijim të bërjes publike të këtyre pretendimeve,

anëtarë të policisë dhe të Agjencisë së Sigurimit të Shtetit Serb (BIA) të përfshirë në raport, kishin kërcënuar një numër personash për t'i frikësuar. Punonjësja e doganës, Anita Nikoliq nga Vladičin Han, në kontakt me QDH-në për një çështje tjetër, u kërcënua vazhdimisht nga zyrtarë të sigurimit të cilët dyshonin se ishte informatore. Në 30 dhjetor 2004, Bratislav Milenkoviq, kreu vendor i BIA-s, pretendohet t'i jetë afruar asaj në një kafene në Vladičin Han, në prani të një dëshmitari, dhe t'i ketë thënë: "Tani jemi duke identifikuar armikun; Tashmë kam identifikuar disa prej tyre. Dhe armiqtë e mi përfundojnë tre pashë nën dhe."

Edhe pse Gjeneral-Inspektori Vladimir Bozoviq, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më pas deklaroi se kishte nisur një hetim, në 3 shkurt 2005 QDH-ja vuri në dukje se një oficer i lartë policie i përzier në këtë çështje, fillimisht u pezullua dhe më pas u ngrit në përgjegjësi e mori pozicionin e oficerit të zbulimit në Xhandarmëri. QDH-ja tha se kishte tregues të konsiderueshëm se udhëheqja e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe BIA-s po përpiqeshin të ndalonin daljen në shesh të fakteve të çështjes.[152]

Pengesat vazhdojnë: në maj 2009 punonjës policie në Leskovac organizuan protesta kundër arrestimit të katër ish-anëtarëve të Njësisë së Policisë Speciale të Batalionit të 37-të (PJP). Policë rezervistë u panë të veshur me bluza në pjesën e përparme të cilave ishin printuar fotot e anëtarëve të arrestuar të PJP-së, kurse mbrapa kishin sloganin: "Heronjtë e Batalionit të 37-të". Sipas QDH-së, protestat, të cilat dukej të mbështeteshin nga Administrata e Policisë së Qytetit Leskovac dhe Presidenca e Sindikatës së Pavarur të Policisë të Republikës së Serbisë, kërkonin lirimin e oficerëve të arrestuar dhe një deklarim publik të emrave të dëshmitarëve. Thuhet se punonjësit e policisë janë dëgjuar të kenë kërcënuar se do të vrisnin dëshmitarët policë dhe kërkonin që ata ta gjykoheshin për tradhti.[153]

Pra, nuk është për t'u çuditur se Shërbimi për Hetimet e Krimeve të Luftës (SHHKL) i krijuar në 2003-shin, si një shërbim hetimor special për krimet e luftës në Ministrinë e Brendshme për të ndihmuar ZPKL-në, ka hasur vështirësi të konsiderueshme në hetimet e tij.[154] Sipas ZPLK-së dhe vëzhguesve të tjerë, njësia pengohet nga pozicioni i saj në Ministrinë e Brendshme, pasi oficerëve të saj i kërkohet shpesh të hetojnë pretendimet kundër punonjësve të policisë më të lartë në rang se ata. Madje njësia fillimisht drejtohej nga oficerë të cilët ishin vetë të pretenduar si të përfshirë në krime lufte. Pavarësisht nga emërimi i një drejtuesi të ri të respektuar, SHHKL-ja vazhdon të perceptohet si e dobët dhe me një mungesë gatishmërie për të filluar hetime. Njësia vetë ka mungesa burimesh dhe një personel të paguar pak për përgjegjësitë që kanë. Edhe pse PKL-ja ka raportuar një farë bashkëpunimi për hetimet e Suharekës, në raste të tjera qasja në informacion pretendohet të jetë penguar. Si rrjedhim, në 90 për qind të çështjeve, prokurorët e PKL-së, në vijim të ndryshimeve në ligj në 2004-ën, kanë zhvilluar hetime penale që i lejonin të ekzaminonin dëshmitarët pa u mbështetur në punën e mëparshme të policisë. Si PKL-ja, dhe OJQ-të ndërkombëtare, kanë diskutuar për krijimin e një drejtorie të veçantë për krimet e luftës brenda Ministrisë së Brendshme ose Ministrisë së Drejtësisë, ose për t'i dhënë kontrollin mbi njësinë PKL-së.[155]

### PENGESAT NË SISTEMIN GJYQËSOR

Amnesty International ka ngritur shqetësime lidhur me funksionimin dhe praktikat e sistemeve gjyqësore si në Serbi dhe Kosovë, sisteme të cilat kanë vepruar si pengesë për kryerjen ndjekjeve penale të efektshme. Në Kosovë në 2008-n organizata botoi një raport që paraqiste vlerësimin e saj të detajuar për sistemin e gjyqësor të dështuar të UNMIK-ut, duke

u fokusuar në Programin e Gjyqësorit dhe Prokurorisë Ndërkombëtare (GJPN) prezantuar në vitin 2000.  Amnesty International dokumentoi shembuj të mungesës së eksperiencës së GJPN-së lidhur me krimet e luftës, mungesën e njohurive për ligjin e zbatueshëm – duke përfshirë atë mbi të drejtën humanitare ndërkombëtare – dhe mosveprimin në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Organizata vuri re mungesën e pavarësisë së gjyqësorit, që në disa raste u konsiderua se kishte shkelur të drejtat e të akuzuarit për një gjyq të drejtë. Megjithatë, e meta më e dukshme ishte numri i vogël i ndjekjeve penale dhe dënimeve në rastet e krimeve të luftës dhe krimeve ndër-etnike – arsyet për të cilat u krijua GJPN-ja.[156]

ZPLK-ja dhe DHSKL-ja në Serbi përballen me një sërë problemesh.  Me mbështetje të paktë politike, me mungesa në personelin e ZPKL-së dhe me një numër të kufizuar gjyqtarësh hetues, ishte menduar që progresi do të ishte i dobët, megjithëse pritej që ndryshimet e parashikuara në ligji  ta përmirësonin situatën.[157]  OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare kanë kritikuar vazhdimisht gjykatën për kohën e gjatë që ka shpenzuar për ngritjen e akt-akuzave – për shembull, në rastin e vëllezërve Bytyqi, akt-akuza u ngrit vetëm shtatë vjet pas vrasjes së tyre (shih më sipër seksionin “Hetimet dhe ndjekjet penale në Serbi”).

Megjithatë shqetësim më të madh për OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore përbën fakti që PKL nuk ka ngritur akuza kundër zyrtarëve të lartë të policisë dhe ushtrisë, përfshi këtu dhe krimet e kryera nga individë të varur drejtpërsëdrejti prej tyre.

Mosbërja e akuzave mund të vijë pjesërisht si rezultat i mungesës së një përkufizimi të përshtatshëm në ligjin e zbatueshëm të përgjegjësisë së komandës.[158]  Megjithatë, ekzistojnë shumë dispozita të cilat përfshijnë aspekte të përgjegjësisë së komandës, përfshi këtu kryerjen e veprave penale me mosveprim, mosraportimin e krimeve dhe bashkëpunim me anë të mosveprimit.  Sipas TPNJ-së, PKL-ja ka hezituar të përdorë këto dispozita dhe komenton se PKL-ja “ka vështirësi me përgjegjësinë e komandës si doktrinë dhe zbatimi i saj mund të vendosë zyrën në konflikt me ushtrinë, policinë, dhe elitën politike.”  Në shkurt 2009, Amnesty International perceptoi një shqetësim të ngjashëm me PKL-në, kur organizata trajtoi çështjen e akt-akuzave ende të paparaqitura për “fshehjen”.[159]  TPNJ-a gjithashtu vëren se gjykatës i mungojnë analistët e nevojshëm politikë, ushtarakë, dhe historianët që nevojiten për këtë akuzë komplekse.

QDH-ja i ka shprehur shqetësimet e saj fuqimisht.  Në 2007-n, lidhur me akuzën e Suharekës/Suva Reka ajo deklaron si vijon:  “Megjithatë, edhe pse ... është ngritur akuzë për një numër anëtarësh të Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Suharekë, akt-akuza nuk ka zbatuar parimin e përgjegjësisë së komandës ...  Është e qartë se PKL-ja po funksionon si një njësi e qeverisë, e jo si njësi e gjyqësorit”.[160]  Në prill 2009, DHSKL-ja liroi dy oficerë të lartë komande të akuzuar për vrasjen e Familjes Berisha në Suharekë/Suva Reka në 1999.[161]

## MUNGESA E MBROJTJES DHE MBËSHTETJES PËR DËSHMITARËT

Amnesty International gjykon se as Kosova dhe as Serbia nuk kanë marrë masat e duhura për mbrojtjen e dëshmitarëve në ndjekjet penale të krimeve të luftës, pjesa më e madhe e të cilëve vazhdojnë të kenë frikë për sigurinë e tyre.  Për më tepër, prokurorët në Serbi, përfshi këtu dhe shefin e PKL-së, janë kërcënuar.[162]

Ndonëse tashmë në Serbi ekzistojnë masa për mbrojtjen e dëshmitarëve, ato u prezantuan vetëm në vitin 2006, kryesisht me kërkesë të QDH-së, personeli i së cilës, në mungesë të një

programi zyrtar për mbrojtjen e dëshmitarëve i ka shoqëruar vetë ata në gjyq dhe i ka siguruar strehim dhe mbështetje në Beograd. Njësia për Mbrojtjen e Viktimave dhe Dëshmitarëve e krijuar në DHSKL në qershor 2006, përbëhet nga dy punonjëse që nuk kishin eksperiencë të mëparshme kur u morën në punë. Pasi u trajnuan nga Tribunali dhe duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me QDH-në, ato tashmë bëjnë koordinimet për akomodimin dhe udhëtimin e dëshmitarëve dhe kujdesen për ta në gjykatë. Megjithatë, ato nuk kanë kapacitetet për të ofruar ndihmë psikologjike, e as buxhet.

Ligji për Mbrojtjen e Pjesëmarrësve në Procedurat Penale i 2006-s parashikon masa për mbrojtjen e personave, duke përfshirë dëshmitarët, të akuzuarit, dhe palët e dëmtuara para, gjatë dhe pas gjyqit. Brenda gjykatës, këto masa lejojnë përdorimin e pseudonimeve dhe lidhjet me video për ata dëshmitarë të cilët refuzojnë të vijnë në Beograd.[163] Një Njësi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në Ministrinë e Brendshme mbron dëshmitarët kur janë në Serbi dhe ka organizuar me sukses mbrojtjen e të afërmve të dëshmitarëve jashtë Serbisë, edhe pse kjo ka qenë problematike në rastin e disa dëshmitarëve – përfshi këtu dhe oficerët e policisë të cilët janë vetë dëshmitarë të marrë në mbrojtje.

Në Kosovë, Rregullorja 2001/20 e UNMIK-ut Për Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe të Dëshmitarëve në Procedurën Penale, i jep anëtarëve të panelit gjyqësor kompetenca për kufizimin e zbulimit të identitetit të dëshmitarit, kur mendohet se dëshmitari ose familja e tij/e saj ka mundësi t'i nënshtrohet një dëmi të mundshëm fizik, dhe kjo përfshin edhe masa të tjera që mund të mbrojnë identitetin e tyre gjatë procedimeve gjyqësore.[164] Megjithatë, këto masa kufizohen në zbatimin e tyre nga gjyqësori ndërkombëtar, si dhe për shkak të mungesës së pajisjeve – vetëm Gjykata e Rrethit të Gjilanit disponon lidhje me video.[165] Njësia e Mbrojtjes së Dëshmitarëve e Policisë së UNMIK-ut ka qenë një burim shqetësimi për Amnesty International, e cila ndër vite i ka bërë rekomandime të vazhdueshme autoriteteve për fuqizimin e saj dhe sigurimin e fondeve të duhura.

Në 10 tetor 2005, në një gjyq për krime lufte para një paneli gjyqtarësh ndërkombëtarë në Gjilan/Gnjilane, një dëshmitar kryesor i prokurorisë u vra, dhe një dëshmitar anonim u plagos rëndë në pazar në Xërxe/Zerze pranë Prizrenit. Sipas NJMSL të OSBE-së, individë të panjohur më pas zhvarrosën trupin e dëshmitarit të vrarë dhe i vunë flakën. U shpërndanë pamflete në të cilat Ushtria Kombëtare Shqiptare (UKSH) deklaroi përgjegjësinë për vrasje, duke parashtruar se ata "nuk [do të ] pushonin ekzekutimin e të gjithë bashkëpunëtorëve." Pas kësaj, një gazetë vendase, në artikullin e saj mbi incidentin, përfshiu emrin e dëshmitarit që mbeti gjallë. NJMSL e OSBE-së raportoi se sipas hetuesve të çështjes, "[h]ezitimi i popullsisë vendase për të bashkëpunuar (frika nga hakmarrja dhe admirimi i dy të dyshuarve kryesorë) është problemi kryesor. Edhe pse publiku është i gatshëm të dëshmojë dhe bashkëpunojë, ai nuk ka besim se autoritetet mund t'i mbrojnë si duhet nga hakmarrja prej të dyshuarve."[166]

Një shembull tjetër i nivelit që kërkohet për mbrojtjen e dëshmitarëve në rastet e krimeve të luftës në Kosovë ilustrohet nga problemet që hasi Tribunali, shumë herë më i pajisur me burime, në ndjekjen penale të ish-Komandantit të UÇK-së Ramush Haradinaj. Dhoma Gjyqësore e Tribunalit, në vendimin e saj në *Haradinaj et al*, raportoi vështirësi të konsiderueshme në mbledhjen e provave nga 100 dëshmitarët e prokurorisë, 18 prej të cilëve u desh të thirreshin me detyrim në gjykatë për të siguruar paraqitjen e tyre. Për më tepër, afro 34 dëshmitarë u pajisën me masa mbrojtëse dhe katër persona u akuzuan nga Tribunali për mosbindje ndaj gjykatës, duke përfshirë një gazetar të dënuar në korrik 2008 për

zbulimin e emrit të një dëshmitari të mbrojtur dhe dy zyrtarë të qeverisë kosovare të dënuar në dhjetor 2009 me tentativën për të influencuar një dëshmitar të mbrojtur.[167]

Amnesty International gjykon se në Kosovë hezitimi i dëshmitarëve për të dalë vullnetarë për dhënien e informacionit lidhur me krimet e luftës, refuzimi i tyre për të dëshmuar në procedime penale dhe një program i papërshtatshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve, ka krijuar pengesa të rënda për ndjekjen penale të shqiptarëve etnikë, përgjegjës për rrëmbimet e kryera gjatë ose pas konfliktit.

## NDËRHYRJET POLITIKE NË RRJEDHËN E DREJTËSISË

Si në Kosovë dhe Serbi ka pasur një mungesë të dukshme vullneti politik për të sjellë para drejtësisë autorët "e tyre" të krimeve të luftës. Në disa raste kjo mungesë vullneti politik është manifestuar në mungesën e mbështetjes të procesit gjyqësor nga ana e qeverisë. Në raste të tjera ka prova bindëse të ndërhyrjes politike, duke përfshirë edhe ato raste ku ka prova bashkëpunimi për të ndërhyrë në rrjedhën e drejtësisë. Në veçanti, Amnesty International gjykon se hetimet e zhdukjeve me forcë në Serbi, që pretendohet të jenë kryer nga policia serbe, janë vështirësuar dhe penguar nga Ministria e Brendshme. Hetimet kundër anëtarëve të UÇK-së të dyshuar për rrëmbimin e serbëve dhe pakicave të tjera në Kosovë, janë vështirësuar dhe penguar po ashtu nga ish-anëtarët e UÇK-së dhe nga UNMIK-u.

### *Pengesa në Serbi*

Deri në fillim të vitit 2001 autoritetet serbe vazhduan të fshehin provat e shumë shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të kryera nga forcat e sigurisë në Kosovë në 1998 dhe 1999. Për shembull, edhe kur provat për fshehje u bënë publike, pengesat e influencuara politikisht penguan hetimet penale lidhur me përgjegjësinë e transportimit të trupave nga Kosova në Serbi.

## KOMPLOTI PËR FSHEHJE [PROVASH]: VAZHDIM

Sipas Çaslav Golluboviqit, ish-shefi i Sekretariatit për Marrëdhëniet e Brendshme në Bor, në 6 prill 1999 ai morri një telefonatë nga Tomisllav Miladinoviq, shefi i policisë kriminale, që e informonte për zbulimin e raportuar në 5 prill 1999 të një kamioni frigorifer që kishte 20 deri në 30 trupa. Kamioni ishte gjetur duke pluskuar në lumin Danub, pranë fshatit Tekijë.[168]

Në dëshminë e tij në Tribunal, Çaslav Golluboviq tha se rreth orës 8:30 në 6 prill 1999, ia raportoi zbulimin Gjeneralit Vllastimir Gjorgjeviq në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili pretendohet t'i ketë dhënë udhëzimin t'i hiqte qafe trupat. Ai dëshmoi: *"Gjenerali Gjorgjeviq më tha që gjatë natës të përpiqesha t'i transferoja trupat nga kamioni frigorifer në një makinë tjetër dhe të eksploroja mundësinë e varrosjes së kufomave diku në zonën Kladovo."* Çaslav Golluboviq pretendohet të jetë udhëzuar të shkatërronte kamionin frigorifer dhe të mos i jepte asnjë informacion mediave. Ai më pas parashtroi se udhëzimi ishte sipas urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme, të ndjerit Vlajko Stojiljkoviq.[169] Trupat më pas u gjetën nga zhytësit në 9 prill 1999 dhe u varrosën në Batajnicë.

Për më tepër, në 6 prill 1999 Zëvendës Prokurori i Rrethit të Negotinit, duke u bazuar në informacionin e marrë nga policia vendore, tha se kishte njoftuar Prokurorin e Rrethit për këtë zbulim. Zëvendës Prokurori i Rrethit të Negotinit u informua të nesërmen se çështja nuk do të hetohej më tutje.[170]

Ekzistenca e trupave mbeti “sekret shtetëror” deri në 1 maj 2001, kur një artikull i botuar në një gazetë vendore përsëriti zbulimin e raportuar të kamionit frigorifer që mbante kufomat e prillit 1999 nga Kosova.[171]

Si pasojë e protestës vijuese në media, në 12 maj 2001, Ministri i Punëve të Brendshme Vlajko Stojiljkoviq dhe zëvendësi i tij Sreten Lukiq, u detyruan të krijonin një grup pune për hetimin e këtyre pretendimeve. Sipas provave të paraqitura pranë Tribunalit, *“[Sreten] Lukiq, udhëzoi grupin e punës të sigurohej që të mos përjashtonte nga hetimi apo t'i bënte favore asnjë personi dhe i dha grupit të punës autorizim dhe pushtet të plotë në hetimin e tij. Sipas Dragan Furduloviqit, grupi i punës ishte në gjendje të punonte tërësisht i pavarur dhe pa pengesa në marrjen e masave të ligjshme kundër anëtarëve të MUP-së.”*[172]

Grupi i punës intervistoi afro 30 policë dhe civilë gjatë 12 deri 15 majit 2001 dhe shënimet e tij iu kaluan Prokurorit Publik të Rrethit të Beogradit. Edhe pse ka të dhëna që Vllastimir Gjorgjeviqi nuk ka pranuar të dëshmojë para grupit të punës, Sllobodan Borisavljeviqi, asokohe ndihmës i shefit të kabinetit të Vllastimir Gjorgjeviqit, dëshmoi në Tribunal se Vllastimir Gjorgjeviqi e kishte udhëzuar t'i kryente pagesat personave që kishin punuar për transportimin e trupave. Grupi i punës nuk intervistoi Sreten Lukiqin i cili në 1999 ishte Drejtori i MUP-it në Kosovë.[173]

Në 25 maj 2001, grupi i punës konfirmoi se Ministri i Brendshëm, Vlajko Stojiljkoviq, dhe Shefi i Departamentit të Sigurisë Publike (RJB), Vllastimir Gjorgjeviq, e kishin deklaruar zbulimin fillestar të trupave në 1999 një “Sekret shtetëror.” Sipas provave të dëgjuara nga Tribunali: *“Komunikata raportonte më pas se në mars 1999 ishte bërë një mbledhje në zyrën e Sllobodan Milloshevigit, në të cilën kishin marrë pjesë vetë Milloshevigi si dhe Stojiljkoviqi, Gjorgjeviqi, dhe Radomir Markoviqi (Shefi i RDB-së)*[174] *gjatë së cilës Gjorgjeviqi kishte ngritur çështjen e spastrimit të terrenit në Kosovë të quajtur ‘asanacija.’ Milloshevigi atëherë e urdhëroi Stojiljkoviqin ‘të merrte masa për zhdukjen e gjurmëve, të cilat mund të tregonin ekzistencën e provave të krimeve të kryera.’ Sipas komunikatës, problemi u diskutua më pas edhe në mars 1999 në zyrën e Stojiljkoviqit. Qëllimi ishte lëvizja e viktimave civile, të cilat mund të bëheshin subjekt i hetimit nga Tribunali. Stojiljkoviqi i dha urdhra Gjorgjeviqit dhe Iliqit ta kryenin këtë detyrë. Një mbledhje e tretë u zhvillua pak kohë më pas, ku Gjorgjeviqi bëri organizimin e pastrimit të trupave nga Kosova.”*[175] Në një komunikatë të dytë të botuar në 26 qershor 2001, grupi i punës parashtroi se në kamionin frigorifer kishte kufoma të veshura me uniforma të UÇK-së, por, sipas provave të paraqitura pranë Tribunalit në atë kohë nga Boshko Radojkoviq, një punonjës police në Kladovo i thirrur në vendin e ngjarjes në 5 prill 1999, kufomat ishin kufoma civilësh, përfshirë dhe gra.[176]

Edhe pasi u zhvarrosën trupat, nuk u raportua asnjë progres i mëtejshëm i hetimeve penale. Në mars 2002 Dragan Karleusha, asokohe Zëvendës Drejtori i Ekipit për Krimet e Organizuara pranë Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme, i cili kryesonte hetimin për varret masive “nuk ishte në gjendje” të jepte ndonjë informacion për ecurinë e hetimeve. Vonë në 2002-shin, një burim policor i paidentifikuar i tha shtypit se përgjigjen duhet ta kërkonin tek gjykata, dhe pretendonte se zyra e prokurorit në mënyrë të veçantë kishte penguar me qëllim hetimet e policisë. Prokuroria e Shtetit i kundërshtoi pretendimet duke thënë se ata nuk ishin në gjendje të fillonin procedimet penale, pasi policia nuk kishte paraqitur ende ndonjë padi penale.[177]

Në 24 qershor 2003 Vlladan Batiq, asokohe Ministri Serb i Drejtësisë, në një fjalim të mbajtur në parlamentin serb, prezantoi projekt-ligjin mbi ndjekjen penale të krimeve të luftës nga gjykatat vendore dhe, duke iu referuar hetimeve në Batajnicë dhe Petrovasellë (shih seksionin më sipër “Komploti për fshehje: shqiptarët e Kosovës të varrosur në Serbi”) tha se këto raste do të ishin ndër të parat që do të ndiqeshin penalisht nga dhoma e re e krimeve të luftës e parashikuar me ligj. Edhe pse ndjekjet penale lidhur me vrasjet e individëve

të gjetur në varre janë në punë e sipër (shih seksionin më sipër "Hetimet dhe ndjekjet penale në Serbi", çështja e Suharekës dhe Byticit) dhe raste të tjera të ngjashme janë duke u hetuar, Amnesty International shqetësohet se vetë PLK-ja në 2009 i tha organizatës se nuk kishte qëllim të hetonte fshehjen [e provave], që konsiderohet një çështje për Tribunalin.[178]

Pengesat ndaj drejtësisë vazhduan gjithashtu nga qershori 1999, me refuzimin e autoriteteve serbe për të dorëzuar të dyshuarit e akuzuar nga Tribunali deri në prezantimin e ligjit mbi bashkëpunimin me Tribunalin në 11 prill 2002. Menjëherë pas miratimit të ligjit Ministri i Brendshëm, Vlajko Stojiljkoviq, i akuzuar nga Tribunali në maj 1999,[179] vrau veten në shenjë proteste me goditje me armë në kokë, jashtë ndërtesës së parlamentit federativ dhe vdiq dy ditë më vonë. Autoritetet i dhanë të dyshuarve të mbetur pesë ditë afat për tu dorëzuar. Gjenerali Ojdaniq u dorëzua në 24 prill 2002 dhe Nikolla Shainoviq në 2 maj 2002. Milan Milutinoviq nuk u dorëzua deri në 20 janar 2003, pasi përfundoi mandatin e tij në detyrë në dhjetor 2002. Nën presionin e vazhdueshëm ndërkombëtar, duke përfshirë atë nga BE-ja, të dyshuarit e tjerë të akuzuar "u bindën" nga qeveria të dorëzoheshin. Vladimir Llazareviqi u dorëzua në 3 shkurt 2005, Sreten Lukiqi në 4 prill 2005 dhe Nebojsha Pavkoviqi në 25 prill 2005.

Edhe pas krijimit të Dhomës Speciale serbe për Krimet e Luftës (DHSKL) në 2003, qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Serbisë e Vojislav Koshtunicës nuk ofroi asnjë mbështetje publike për punën e gjykatës, me Ministrin e Drejtësisë dhe me Ministrin e Brendshëm, që respektivisht ose minonin aktivisht punën e gjykatës, ose e shpërfillnin atë.[180] Në 2009 OJQ-të vazhdojnë të raportojnë rezistencë e anëtarëve të asamblesë ndaj DHSKL-së. Gjithashtu QDH-ka ka informuar Amnesty International se ndihma e premtuar më parë nga Drejtori i SHHKL-së për krijimin e "Librit të Kujtimeve nga Kosova" (që përmban përmbledhje rrëfyese për çdo person që ka vdekur ose që është raportuar i pagjetur gjatë periudhës janar 1998 dhjetor 2000 dhe që ka si qëllim të ndihmojnë hetimet penale) nuk u ofrua më, pas ndryshimit të personelit të Ministrisë së Brendshme.[181]

Për më tepër, Ligji mbi Llogaridhënien për Shkeljet e të Drejtave të Njeriut, i miratuar nga Parlamenti serb në qershor 2003, që kishte si qëllim të fuste sistemin e verifikimit të personave me detyra publike, përfshi këtu zyrtarët e policisë, nuk është zbatuar për shkak të kundërshtimit nga anëtarët e Kuvendit serb që përfaqësojnë Partinë Radikale Serbe, Partinë Demokratike të Serbisë, dhe Partinë Socialiste të Serbisë.[182]

***Pengesa në Kosovë***

Në Kosovë influenca e vazhdueshme dhe autoriteti politik i ish-anëtarëve drejtues të UÇK-së, duke përfshirë dhe mbështetjen e tyre për autorët e dënuar, ka ushqyer një klimë të ngjashme mosndëshkimi. Në 2006-n, për shembull, Agim Çeku – Kryeministri i atëhershëm i Kosovës – vizitoi gjeneralin e UÇK-së Selim Krasniqin pas dënimit të tij në 2006-ën për krime lufte dhe për ndalimin e jashtëligjshëm dhe rrëmbimin e shqiptarëve etnikë (shih më sipër seksionin "Ndjekjet penale në Kosovë"), dhe thuhet të jetë shprehur: "Kosova ka nevojë për burra si Gjeneral Selim Krasniqi."[183]

Çdo lloj dështimi në ndjekjen penale të abuzimeve të të drejtave të njeriut është i papranueshëm. Edhe pse hezitimi i palëve në konflikt për të ndjekur penalisht "të vetët" bie në kundërshtim me detyrimet e tyre ndërkombëtare, ky hezitim nuk është i papritur.

Megjithatë, Amnesty International gjykon se hezitimi i hapur i UNMIK-ut për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e luftës të kryera nga UÇK-ja ndaj jo-shqiptarëve, përbën gjithashtu një shqetësim serioz. UNMIK-u jo vetëm që është një organ i Kombeve të Bashkuara, por është i ngarkuar nga Këshilli i Sigurimit të mbrojë dhe të garantojë të drejtat e njeriut në të gjithë Kosovën.

Për më tepër, programi i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë të (GJPN) i UNMIK-ut u prezantua për të siguruar që gjyqet e krimeve të luftës dhe krimet ndër-etnike të zhvilloheshin në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të një gjyqi të drejtë.

Në 2008-n Amnesty International shprehu shqetësim lidhur me pavarësinë e GJPN-së, që ajo konsideron se është minuar nga procesi i caktimit të çështjeve prej ekzekutivit tek gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë. Organizata raportoi me një shqetësim të thellë se ndërhyrjet e pushtetit ekzekutiv të administratës së UNMIK-ut nuk kufizoheshin në zgjedhjen dhe caktimin e çështjeve, por mund të shtriheshin edhe në ndërhyrjen për drejtimin aktual të tyre.[184]

Një gjyqtar ndërkombëtar i tha Amnesty International: "Nëse nxjerr të pafajshëm shumë serbë ata [Departamenti i Drejtësisë së UNMK-ut] ka mundësi që mos të të japin më raste të krimeve të luftës ..."[185] Një gjyqtar tjetër ndërkombëtar i tha Amnesty International se një zyrtar i lartë i UNMIK-ut njihej për ushtrimin e presionit ndaj gjyqtarëve për raste të caktuara, dhe se presioni politik ishte përdorur për të detyruar largimin e të paktën një gjyqtari dhe një prokurori.[186] Informacion i besueshëm sugjeron gjithashtu se vendimet merreshin brenda për brenda Departamentit të Drejtësisë për të ndaluar hetimin dhe ndjekjen penale të figurave politike të nivelit të lartë, duke përfshirë atë kundër Ramush Haradinaj, lidhur me pretendimet për vdekjen e një anëtari të familjes Musaj.[187]

Amnesty International shqetësohet për ndërhyrje të tjera të raportuara në administrimin e gjyqësorit nga Zyra e PSSP-së. Organizata është informuar se këto ndërhyrje kishin motive politike, të cilat i jepnin përparësi stabilitetit politik dhe sigurisë në Kosovë, karshi respektimit të të drejtave të njeriut të komuniteteve në Kosovë. Disa zyrtarë të UNMIK-ut informuan Amnesty International se ishte "koha për të ecur përpara", duke sugjeruar se e kaluara duhej harruar. Reporteri Michael Motgomery konfirmoi: "Disa prej ish-zyrtarëve të UNMIK-ut më thanë se nuk kishte mbështetje politike për ndjekjet penale të krimeve kryesore të luftës, në veçanti pas protestave të marsit 2004 kundër pakicës serbe."[188]

Amnesty International gjykon se disa prej veprimeve të ndërmarra nga UNMIK-u mund të kenë kapërcyer caqet e dobisë politike, në mënyrë të veçantë në rastet e ish-udhëheqësve të UÇK-së të cilët kishin detyra apo pushtet në Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes (IPVQ).

Në 2003-in Hashim Thaçi u arrestua në Budapest mbi bazën e një urdhër arresti ndërkombëtar lëshuar në emër të autoriteteve serbe nga Interpoli. Raportohet se u lirua pas një telefonate prej të atëhershmit PSSP, Michael Steiner. Po kështu, në tetor 2003, ish-komandanti Agim Çeku u arrestua në Slloveni sipas një urdhri nga Interpoli dhe raportohet se u lirua pasi PSSP i asokohe, Harri Holker, ndërhyri tek autoritetet sllovene. Në mars 2004,

raportohet se Agim Çeku u lirua sërish me ndërhyrjen e PSSP, pasi ishte arrestuar sipas të njëjtit urdhër në Budapest.[189]

Prokuroria pranë Tribunalit ka shprehur shqetësim të veçantë se marrëdhënia ndërmjet UNMIK-ut dhe Ramush Haradinajt ka pasur efektin e krijimit të një ndjenje mosndëshkimi dhe ka ushqyer frikësimin e dëshmitarëve. Sipas Jean-Daniel Ruche, këshilltar politik i Kryeprokurorit, "[k]a pasur një atmosferë të përgjithshme frikësimi; ata [UNMIK-u] nuk bënë asgjë për ta ndryshuar këtë atmosferë." Ai raportohet të ketë thënë se takimi ndërmjet zyrtarëve të lartë të UNMIK-ut dhe Ramush Haradinajt, para se ai të dorëzohej vullnetarisht në Tribunal në mars 2007, dhe me kthimin e tij nga Tribunali pas lirimit provizor, "ka pasur një efekt drithërues tek dëshmitarët."[190] Duke komentuar transferimin e ish-udhëheqësit të UÇK-së pranë Tribunalit, PSSP Soren-Jessen Petersen tha: "Personalisht jam i trishtuar që nuk do të punoj më me një partner dhe shok të ngushtë."[191]

Amnesty International ka identifikuar prova bindëse të një tentative nga PSSP-ja në 2006-n për të ndërhyrë në ndjekjen penale të Anton Lekajt, një ish-anëtar i UÇK-së i akuzuar për krime lufte nga DHSKL-ja. Akuza përfshinte rrëmbimin dhe vrasjen e një grupi burrash romë. Në vitin 2000, Amnesty International intervistoi një nga ata që mbijetuan.[192]

## NDËRHYRJE NGA EKZEKUTIVI

Ish-anëtari i UÇK-së, Anton Lekaj, u arrestua në Mal të Zi, në gusht 2004, për vjedhjen e një makine dhe u transferua në Serbi pas akt-akuzës së ngritur nga DHSKL-ja. Ai u akuzua për krime lufte kundër popullsisë civile, duke përfshirë përdhunimin e një vajze të mitur rome në Hotelin Pashtrik në Prizren; rrahjen dhe keqtrajtimin e dy individëve në 13 qershor 1999 në të njëjtin hotel; trajtimin çnjerëzor dhe degradues të një të ndaluari natën e 13 dhe 14 qershorit; transferimin e katër burrave romë në një vend tjetër në natën e 15 qershorit 1999 dhe vrasjen e tre prej këtyre burrave.[193] Procedimet filluan në DHSKL në Gjykatën e Rrethit të Beogradit në 18 nëntor 2005.

Të mërkurën më 3 prill 2006, e përditshmja kosovare *Koha Ditore* raportoi se PSSP u kishte shkruar autoriteteve serbe duke kundërshtuar juridiksionin e DHSKL-së të Beogradit në procedimet kundër Anton Lekajt.[194] Në 4 prill 2006, në një mbledhje me Zyrën Ligjore (ZL) të UNMIK-ut, Amnesty International u informua se ZL-ja gjykonte se DHSKL-ja nuk kishte juridiksion mbi këtë rast. ZL-ja gjithashtu e konsideronte akuzën ndaj Anton Lekajt dhe akuzat e tjera ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së Hashim Thaçit, Agim Çekut dhe Ramush Haradinajt, si të jashtëligjshme, pasi këto akuza ishin bërë fillimisht nga një "gjykatë paralele" krijuar në Nish pas tërheqjes së autoriteteve serbe nga Kosova në korrik 1999. ZL-ja konfirmoi se PSSP i kishte shkruar autoriteteve serbe duke i kërkuar tërheqjen e akuzave që i ishin kaluar Interpolit nga autoritetet serbe (shih më sipër).[195]

ZL-ja nuk ishte në gjendje të konfirmonte nëse UNMIK-u kishte filluar ndonjë hetim lidhur me pretendimet ndaj Anton Lekaj. Gjithashtu nuk konfirmonte se do të fillonte hetimi në rast se kjo çështje do t'i dorëzohej UNMIK-ut nga Serbia, duke deklaruar se, nëse do t'i jepeshin prova të tilla materiale,"do t'i shqyrtonin."[196]

Në shtator 2000, organizata intervistoi B.C. një burrë rom i cili asokohe jetonte në një kamp refugjatësh, që tha se vëllai i tij Rexh Shala (Ređ Šalja) nuk ishte gjetur.[197]

*Sipas B.S. në qershor 1999 pasi përfunduan bombardimet e NATO-s, planifikohej të bëhej dasma e Rexh Shalës me S.T. Ashtu sikurse është zakoni, dhëndëri dhe tetë burra të tjera shkuan në shtëpinë e nuses – 100*

*metra larg – ta merrnin për dasmën. Gjatë rrugës në kthim katër a pesë burra, që mendohej të ishin të UÇK-së, u shfaqën dhe i arrestuan të gjithë duke përfshirë dhe Rexh Shalën dhe S.T. U çuan në një fabrike tekstili në Gjakovë dhe më pas në bodrumin e Hotelit Pashtrik. B.S. i tha Amnesty International se ata u rrahën, dhe disa prej burrave pësuan plagë me thika në fytyrë dhe në trup dhe të tjerë i kishin automatikët në fyt. Sipas B.S., S.T. u përdhunua në bodrumin e hotelit përpara të ndaluarve të tjerë nga disa burra që e përdhunuan me urdhër të komandantit, i e kishte bërë këtë i pari. Ata e njihnin komandantin.*

Disa nga burrat dhe S.T. u liruan. Katër burrave që mbetën, përfshi këtu B.S. dhe vëllanë e tij, iu tha që do i çonin në shtëpi, por i futën me forcë në një makinë dhe i dërguan në një magazinë në rrugën Gjakovë-Prizren. Sipas B.S., UÇK-ja hapi zjarr me automatikë, duke qëlluar vëllanë e tij dhe dy burra të tjerë. B.S. arriti të shpëtonte duke u hedhur në lumë dhe duke u larguar me not nën ujë.[198] Në vitin 2000 i tha Amnesty International se nuk e dinte nëse i vëllai i tij ishte gjallë a vdekur.

Në tetor 2007 Anton Lekaj u dënua me 13 vjet burg. Në 26 shkurt 2007, Paneli i Krimeve të Luftës i Gjykatës Supreme të Serbisë konfirmoi vendimin. Trupi i Rexh Shalës ende nuk është gjetur.

# 5. TË DREJTAT E TË AFËRMVE

Në kapitujt e mëparshëm kemi parë si autoritetet serbe dhe UNMIK-u nuk u kanë siguruar të afërmve të viktimave të zhdukjeve me forcë qasje efektive në drejtësi me anë të sistemit gjyqësor penal. Në këtë kapitull Amnesty International dokumenton se si, po këto autoritete dhe Qeveria e Kosovës, nuk u kanë garantuar të afërmve marrjen e një dëmshpërblimi të përshtatshëm.

E drejta për dëmshpërblim qartësohet në Parimet dhe Udhëzimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën për Zgjidhje Ligjore dhe Dëmshpërblim të Viktimave të Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve Serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.[199] Në përputhje me këto Parime dhe Udhëzime Bazë, përveç qasjes efektive në drejtësi, të afërmit e atyre që u ishin nënshtruar zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë gjatë konfliktit në Kosovë dhe në vijim të tij, duhet të marrin dëmshpërblim të përshtatshëm, efektiv dhe të menjëhershëm për dëmin që kanë vuajtur duke përfshirë, kthimin, kompensimin, rehabilitimin, përmbushjen e kërkesave dhe garantim të mospërsëritjes.

Këto pesë forma të dëmshpërblimit janë përkufizuar në Nenet 19-23 të Parimeve dhe Udhëzimeve Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën për Zgjidhje Ligjore dhe Dëmshpërblim të Viktimave të Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve Serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.

19. Kthimi, kur të jetë e mundur, duhet ta kthejë viktimën në gjendjen fillestare para se të kryheshin shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, apo shkeljet serioze të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Kthimi sipas rastit përfshin: rivendosjen e lirisë, gëzimin e të drejtave të njeriut, identitetit, jetës familjare dhe qytetarisë, kthimin e kujtdo në vendin e rezidencës, rivendosjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin e pronës.

20. Kompensimi duhet të sigurohet për çdo lloj dëmi ekonomik të vlerësueshëm ashtu si është e përshtatshme dhe në përpjesëtim me shkallën e shkeljes dhe rrethanat e çdo rasti, si pasojë e shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare si:

(a) Dëm fizik apo mendor;

(b) Mundësi të humbura, duke përfshirë punësimin, edukimin dhe përfitimet sociale;

(c) Dëmet materiale dhe humbjen e të ardhurave, duke përfshirë humbjen e potencialit për të fituar të ardhura;

(d) Dëmtim moral;

(e) Shpenzimet e nevojshme për ndihmë ligjore apo të kualifikuar, shërbimet mjekësore, shërbimet psikologjike dhe shoqërore;

21. Rehabilitimi përfshin kujdesin mjekësor dhe psikologjik si dhe shërbimet ligjore dhe shoqërore.

22. Në ato raste kur zbatohet, përmbushja e kërkesave përfshin ndonjë ose të gjitha sa më poshtë:

(a) Masa të efektshme me qëllim pushimin e shkeljeve në vazhdimësi;

(b) Verifikimin e fakteve dhe zbulimin publik të së vërtetës deri në shkallën sa ky zbulim nuk shkakton dëm të mëtejshëm apo nuk kërcënon sigurinë dhe interesat e viktimës, të të afërmve të viktimës, dëshmitarëve, ose të personave të cilët kanë ndërhyrë për të ndihmuar viktimën apo për të shmangur kryerjen e shkeljeve të tjera;

(c) Kërkimin e vendndodhjes së të zhdukurit, të identitetit të fëmijëve të rrëmbyer, dhe të trupave të të vrarëve, dhe ndihmën për marrjen, identifikimin dhe rivarrosjen e trupave në përputhje me dëshirën e shprehur ose të prezumuar të viktimave apo në përputhje me praktikat e kulturës së familjeve apo komuniteteve;

(d) Një deklaratë zyrtare ose një vendim gjyqësor që vë në vend dinjitetin, reputacionin dhe të drejtat e viktimës dhe personave të lidhur ngushtë me viktimën;

(e) Ndjesë publike duke përfshirë njohjen e fakteve dhe pranimin e përgjegjësisë;

(f) Sanksione administrative dhe gjyqësore kundër personave përgjegjës për shkeljet;

(g) Përkujtimet dhe homazhet për viktimat;

(h) Përfshirjen e rrëfimit të saktë të shkeljeve që kanë ndodhur në materialet e trajnimit dhe të edukimit të të gjitha niveleve të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

23. Garancitë e mospërsëritjes duhet të përfshijnë, aty ku është e mundur, ndonjërën ose të gjitha masat e mëposhtme , të cilat do të kontribuojnë edhe në parandalim:

(a) Sigurimin e një kontrolli civil të efektshëm të forcave ushtarake dhe atyre të sigurisë;

(b) Sigurimin se të gjitha procedimet civile dhe ushtarake respektojnë standardet ndërkombëtare të procesit të drejtë, të ndershëm dhe të paanshëm;

(c) Forcimin e pavarësisë së gjyqësorit;

(d) Mbrojtjen e personave të fushës ligjore, mjekësore, dhe kujdesit shëndetësor, medias dhe të gjitha profesioneve të tjera përkatëse, si dhe të mbrojtësve të të drejtave të njeriut;

(e) Ofrimin me përparësi dhe në vazhdimësi të edukimit mbi të drejtat e njeriut dhe të drejtën humanitare ndërkombëtare në të gjitha sektorët e jetës dhe trajnimin e punonjësve të rendit si dhe forcave ushtarake e atyre të sigurimit.

(f) Promovimin e respektimit të kodeve të sjelljes dhe normave etike, në veçanti të standardeve ndërkombëtare, nga ana e punonjësve të shërbimit publik, duke përfshirë zbatuesit e ligjit, burgjet, dhe shërbimet mediatike, mjekësore, psikologjike dhe shoqërore, personelin ushtarak si dhe ndërmarrjet

ekonomike;

(g) Promovimin e mekanizmave për parandalimin dhe monitorimin e konflikteve shoqërore dhe zgjidhjen e tyre;

(h) Rishikimin dhe reformimin e ligjeve që kontribuojnë ose që lejojnë shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Siç e kemi parë, të afërmve në Serbi dhe Kosovë nuk u janë garantuar të drejtat e tyre të përmbushjes së kërkesave, që përkufizohet nga Nenin 22 sa më sipër, ndër të tjera, të drejtat për: "Verifikimin e fakteve dhe zbulimin publik të së vërtetës ... Kërkimin e vendndodhjes së të zhdukurit ... dhe të trupave të të vrarëve ...". Të afërmve as nuk u është kërkuar ndjesë publike. Autoritetet nuk u kanë siguruar atyre "përkujtimet dhe homazhet për viktimat". Si në Serbi dhe Kosovë të afërmve u është dashur të luftojnë për të drejtat e tyre.

## TË AFËRMIT KËRKOJNË TË DREJTAT E TYRE

Të afërmit e të pagjeturve nuk janë thjesht viktima pasive të shkeljeve të të drejtave të njeriut, por vazhdojnë të jenë aktivë në kërkimin e të drejtave të tyre. Duke formuar shoqata të familjarëve, si në Kosovë, dhe Serbi, ata kanë përdorur një mori mjetesh për të bindur autoritetet që t'i tregojnë të vërtetën. Ata i kanë shkruar çdo autoriteti përkatës vendor dhe ndërkombëtar, kanë ndihmuar në punën e komisioneve dhe kanë mbështetur njëri-tjetrin.

Të afërmit gjithashtu kanë ndërmarrë veprime: në 2004-ën në Kosovë ata vendosën fotot e të zhdukurve në kangjellat jashtë parlamentit të Kosovës, për t'i kujtuar qeverisë përgjegjësitë e saj. Tashmë fotot e zbehura në shi dhe diell janë një testament i mosveprimit të autoriteteve. Të tjerë kanë protestuar jashtë zyrave të qeverisë dhe institucioneve ndërkombëtare në Beograd dhe Prishtinë, ose kanë kërkuar vizita nga delegacione ndërkombëtare, për të ndikuar të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë presion ndaj qeverive të tyre jo-reaguese.

Ato – sepse janë kryesisht gra; nënat, motrat, vajzat e të pagjeturve – kanë bërë greva urie si në Serbi dhe Kosovë. Me qindra në numër, ato kanë bllokuar rrugët kryesore të Prishtinës dhe për këtë janë arrestuar.

OJQ-të vendore i janë bashkuar fushatave të tyre. Në 2003-2004 Rrjeti Kosovar për Veprim (RRKV) së bashku me Këshillin Koordinues të Asociacioneve të Familjeve të Personave të Pagjetur dhe Familjeve me Viktima Lufte, mblodhën 236311 nënshkrime për peticionin, "Na mungojnë të gjithëve" Peticioni i drejtohej KB, SHBA-së, Komisionit Evropian (KE), UNMIK-ut, Asamblesë së Kosovës, qeverisë dhe Presidentit, dhe kërkonte kthimin e trupave nga Serbia dhe fillimin e procedimeve ligjore.[200] Në Serbi, QDH-ja ka punuar pa u lodhur për respektimin e të drejtave të të afërmve dhe ka krijuar një iniciativë që quhet *Komisioni Rajonal me mandatin për të përcaktuar dhe zbuluar faktet lidhur me krimet e luftës të kryera në ish-Jugosllavi* (inicialet në anglisht: RECOM) i cili ka si qëllimi sigurimin e "një mekanizmi sistematik për gjetjen e së vërtetës dhe të tregimit të së vërtetës për krimet e luftës."[201]

Amnesty International gjykon se situata e veçantë e atyre që janë prekur drejtpërsëdrejti nga rrëmbimet dhe zhdukjet me forcë, kërkon një qasje të ndjeshme nga pikëpamja gjinore. Edhe pse viktimat e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë në kontekstin e konfliktit në Kosovë

dhe në vijim të tij janë kryesisht (më shumë se 85 për qind) meshkuj, viktimat që kanë mbijetuar janë në pjesën më të madhe të rasteve femra. Për shumë prej tyre, humbja e anëtarit të familjes (dhe në disa raste zhvendosja e tyre nga vendi i origjinës) ka sjellë pasoja negative në gjendjen e tyre sociale dhe ekonomike. Të pakta janë ato që marrin ndihmë sociale dhe ekonomike, ose njihen me ligj nga qeveritë e tyre. Si në Serbi, ashtu dhe në Kosovë, të afërmit e të zhdukurve apo të të rrëmbyerve gjykojnë se qeveritë e tyre kanë bërë shumë pak për t'i ndihmuar.

## DËMSHPËRBLIMI: KOMPENSIMI PËR VIKTIMAT DHE FAMILJET E TYRE

Parimet dhe Udhëzimet Bazë të KB mbi të Drejtën për Zgjidhje Ligjore, cituar më sipër, i bëjnë thirrje shteteve të sigurojnë një dëmshpërblim të përshtatshëm, të efektshëm, dhe të menjëhershëm, në përpjesëtim me shkallën e shkeljes dhe dëmit të pësuar. Amnesty International gjykon se pjesa më e madhe e viktimave civile të abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut të kryera në Kosovë, nuk e kanë marrë këtë dëmshpërblim.[202]

Sipas ligjeve mbi të drejtat e viktimave ushtarake dhe civile si në Serbi dhe Kosovë, të afërmit e të pagjeturve kanë të drejtë të marrin përfitime sociale. Megjithatë, Amnesty International mendon se këto ligje diskriminojnë familjet e viktimave civile të luftës dhe nuk u sigurojnë atyre kompensim të përshtatshëm.

***Në Serbi***

Ligjet serbe për invalidët ushtarakë dhe civilë parashikojnë kompensime monetare në formën e pagesave mujore për personat invalidë nga lufta dhe për familjet e personave të vrarë në konfliktin e armatosur, apo që kanë vdekur si rezultat i dëmtimeve të pësuara lidhur me konfliktin.[203] Sipas ligjit, të afërmit e personave të humbur në shërbim kanë të drejtën e pensionit të invaliditetit, por familjet e civilëve të pagjetur mund ta kërkojnë këtë të drejtë vetëm nëse fillojnë procedime civile për deklarimin e personit të pagjetur si të vdekur. Pjesa me madhe e familjeve ose nuk kanë dijeni që mund të marrin kompensim mujor sipas këtyre kushteve, ose nuk dëshirojnë t'i fillojnë këto procedime me shpresën se të afërmit e tyre janë ende gjallë.[204]

Sipas ligjit, familjet e viktimave ushtarake marrin automatikisht një përfitim mujor familjar për invaliditet, që për një familje me tre anëtarë është 92500 dinarë (afro 1,170 Euro në 2007-n). Megjithatë, familjet e civilëve që janë vrarë përjashtohen nga këto përfitime, nëse kanë të ardhura që kalojnë një prag të caktuar. Ata që e kishin këtë të drejtë në 2007-n, merrnin afro 14750 dinarë, (187 Euro) për familje, pavarësisht nga numri përfituesve. Në Serbi, nga fundi i 2007-s, vetëm 1972 persona (jo detyrimisht nga Kosova) kishin të drejtë ta merrnin këtë përfitim dhe të fitonin statusin e invalidit civil të luftës.

Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzitore (QNDT) konstatoi se "legjislacioni parashikon një trajtim tërësisht të pabarabartë të viktimave ushtarake dhe numrit të anëtarëve të familjeve të tyre nga njëra anë, dhe të viktimave civile dhe anëtarëve të familjeve të tyre nga ana tjetër. Familjet e ushtarëve të rënë marrin ndihma të bollshme financiare për invaliditet, pavarësisht nga gjendja e tyre financiare, ndërkohë që familjet e civilëve të vrarë marrin të ardhura modeste vetëm nëse janë në kushte të mjerueshme ekonomike."[205] Këto familje mund të marrin nga Komisioni për Personat e Pagjetur pagesa për ceremoni varrimi,

donacione financiare dhe donacione humanitare ad hoc.

Drejtori i Komisionit Serb për Personat e Pagjetur, Vjelko Odaloviq, pranoi se dispozitat e ligjit kishin mangësi dhe se jo të gjithë të afërmit i përmbushnin kushtet për këto përfitime. Ai i tha Amnesty International se të afërmit e të rrëmbyerve ishin më gjendje më të keqe, për shembull, se familjarët e ish-punonjësve të policisë së MUP-it apo të të tjerëve të punësuar më parë në sektorin publik në Kosovë, të cilët merrnin pensione nga Ministria Serbe për Kosovën dhe Metohinë.[206]

Serbia nuk ka Ligji mbi Personat e Pagjetur. Sipas Vjelko Odaloviqit ka një mungesë vullneti politik për të miratuar një ligj i cili do të zbatohej për afro 10000 të afërm të personave të pagjetur nga luftërat në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, të cilët janë tani qytetarë të Serbisë. Në vend të ligjit, Komisioni Serb për Personat e Pagjetur, me ndihmën e udhëzimeve të hartuara nga KNKK-ja ka si qëllim të nxjerrë një libërth që t'i udhëzojë familjarët [e të pagjeturve] për të drejtat e tyre për ndihmë mbi bazën e ligjeve të tjera, dhe të ndryshojë legjislacionin për të lejuar këtë lloj ndihme.[207] Organizata vëzhgon se shumë familjarë romë, të cilët nuk mund të kenë të drejtë shtetësie, do të vazhdojnë të përjashtohen nga këto përfitime.

Në Serbi, të afërmit e të pagjeturve nuk konsiderohen viktima. Sipas ligjit, viktima përkufizohet si "një person i cili ka pësuar të paktën 50% dëme fizike për shkak të një plage apo dëmtimi që ka lënë shenja të dukshme të shkaktuara nga tortura apo mohimi i lirisë nga armiku gjatë luftës, si rezultat i operacioneve luftarake, mbetjeve e materialeve të luftës apo sabotimit të armikut, p. sh. akteve terroriste." Personat e ndaluar, viktima të dhunës seksuale dhe viktimat e torturës janë gjithashtu të përjashtuar nga kompensimi administrativ, veç rastit kur arrijnë pragun e dëmtimit fizik.[208] Ndonëse "viktimat" e tjera mund të kërkojnë kompensim në gjykatë, në pjesën më të madhe të rasteve "standardi i lartë i provës dhe skadimi i parashkrimit të afateve(statutit të kufizimeve) i pengojnë viktimat të marrin kompensim për dëmin fizik dhe psikologjik."[209] Ligji mbi kompensimin administrativ përjashton gjithashtu ata që kanë dëmtime ose kanë humbur jetën për shkak të veprimeve të agjencive shtetërore serbe, duke i përjashtuar kështu shqiptarët e Kosovës që kanë pësuar zhdukje me forcë nga forcat serbe.[210]

***Në Kosovë***

*"UNMIK-u në bashkëpunim me IPVQ ... duhet të sigurojnë që të afërmit e personave 'të zhdukur' dhe të rrëmbyer të marrin ... kompensim të përshtatshëm"* Komiteti i të Drejtave të Njeriut të KB, korrik 2006.[211]

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/66 parashikon të drejtën për kompensim në formën e ndihmave/beneficioneve për invalidët e luftës dhe për të afërmit e ngushtë të atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë. Ajo gjithashtu përcakton një Fond të Veçantë të administruar nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prej të cilit mund të paguhen këto beneficione.[212] Rregullorja nuk parashikonte shprehimisht të drejtën për kompensim të familjeve të të pagjeturve të cilat kishin të drejtë të merrnin një pagesë kompensimi mujore vetëm pasi anëtari i tyre i familjes të ishte deklaruar i vdekur. Pak shqiptarë të Kosovës qenë të gatshëm ta bënin këtë deklarim zyrtar; në dhjetor 2007 vetëm tetë familje të personave ende të pagjetur merrnin kompensim. Qeveria pagoi për

varrimin (duke përfshirë edhe blerjen e arkivolit) dhe i pagoi atyre një shumë të vetme modeste kompensimi.[213]

Rregullorja e UNMIK-ut parashikon vetëm beneficione që u jepen familjeve të viktimave civile të luftës që vdiqën apo u zhdukën ("fati i të cilëve është ende i paditur") nga 27 shkurti 1998 deri në 20 qershor 1999. Kështu ajo përjashton të afërmit e personave nga pakicat, të rrëmbyer pas 10 qershorit 1999 shumë prej të cilëve vazhdojnë të jenë në zonat serbe të Kosovës.[214]

Në Kosovë, Ligji mbi Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të UÇK-së dhe Veteranëve, dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës u miratua nga asambleja në shkurt 2006. Ligji i ri kryesisht parashikon beneficione financiare dhe beneficione të tjera për familjet anëtarëve të vdekur ose të plagosur të UÇK-së dhe të grupeve të tjera të armatosura.[215] Ashtu si dhe ligji në Serbi, ky ligj krijon një mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet të drejtave që u njihen dhe beneficioneve që jepen familjarëve të viktimave ushtarake, në krahasim me ato civile.[216] Sipas ligjit, familjeve nuk u kërkohet të deklarojnë një anëtar të pagjetur të familjes si të vdekur për të ushtruar të drejtën për kompensim financiar. Megjithatë në 2007-n, dispozitat e ligjit të ri ishin zbatuar vetëm për të drejtat e familjeve të luftëtarëve të pagjetur, por jo të civilëve të pagjetur.

Nën presionin e shoqatave të familjeve dhe KNPP-së, në maj 2008 u propozua një amendament i ligjit, me qëllim njohjen me ligj të të drejtave të familjeve të "të zhdukurve". Tashmë propozuar si ligj më vete , amendamenti pritet të hyjë në fuqi në nëntor 2009.[217] Një version i ligjit, që shqyrtua nga Amnesty International në shkurt 2009, nuk kishte përkufizime të hollësishme apo dispozita të përshtatshme, duke përfshirë ato mbi të drejtat e të afërmve për të ditur dhe të drejtën e tyre për kompensim. Gjithashtu kanë lindur pikëpyetje nëse do të ketë fonde të disponueshme për zbatimin e këtij ligji.[218]

## MUNDËSIA E MARRJES SË DËMSHPËRBLIMIT NËPËRMJET PROCEDIMEVE CIVILE

Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit të KB parashikon: "Një person mund të konsiderohet viktimë në përputhje me këtë Deklaratë, pavarësisht nëse autori i veprës penale identifikohet, kapet, ndiqet penalisht apo dënohet dhe pavarësisht nga lidhja familjare ndërmjet autorit dhe viktimës. Termi "viktimë", aty ku është e përshtatshme, përfshin gjithashtu anëtarët e afërt të familjes ose personat në varësi të viktimës së drejtpërdrejtë dhe personat të cilët janë dëmtuar kur kanë ndërhyrë për të ndihmuar viktimën në gjendjen e vështirë ose për të shmangur viktimizimin. Pra, detyrimi për të ofruar dëmshpërblim për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut nuk varet nga ndjekja penale edhe pse ndjekja penale e autorit mund të konsiderohet një pjesë përbërëse e së drejtës për të vënë të drejtën në vend." (Seksioni A (2)).

Legjislacionet si në Serbi dhe Kosovë parashikojnë se paditë civile për dëme mund të ngrihen si ndaj zyrtarëve publikë ashtu edhe kundër aktorëve jo-shtetërorë për shkeljet e së drejtës kombëtare. Megjithatë, Amnesty International vëren se paditë civile të ngritura për dëmshpërblim deri tani kanë qenë të pasuksesshme. QDH-ja ngriti në 24 janar 2007 një padi civile në emër të 24 anëtarëve të familjeve të 14 civilëve të vrarë në Podujevë/Podujevo në 28 mars 1999 nga anëtarë të njësisë rezerviste të policisë serbe të njohur si "Akrepat" dhe kërkoi kompensim nga Serbia për vrasjen e anëtarëve të familjeve të tyre. QDH-ja kërkoi

dëmshpërblim për veprimet e mosveprimet që i atribuohen Shtetit dhe që përbënin shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ose shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Padia u hodh poshtë në maj 2009, mbi bazën e një vendimi të Gjykatës Supreme të 2004-ës në kundërshtim me parashkrimin e afateve(statutin e kufizimeve), parashikonte se paditë kundër shtetit duhet të ngrihen brenda pesë vjetëve nga koha e shkeljes.[219]

Amnesty International vëren se një gjykatë serbe në prill 2009 hodhi poshtë një padi të ngjashme të ngritur nga familjet e 16 boshnjakëve nga fshati Sjeverin, të cilët ishin rrëmbyer në Bosnjë dhe Hercegovinë (BH) në 22 tetor 1992.[220]

Të afërmit e të zhdukurve në Kosovë nuk mund të ngrenë ankesa kundër Serbisë, por ato kanë paraqitur ankesa kundër UNMIK-ut tek Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë (IOK), i cili deri në 2006-n kishte juridiksion mbi veprimet dhe mosveprimet e UNMIK-ut.[221] Për shembull në vitin 2003, S.Q. gruaja e A.Q., një shqiptari të Kosovës që mendohet të jetë rrëmbyer në 9 gusht 1999, bëri një ankesë kundër UNMIK-ut për mos-hetimin e rrëmbimit të A.Q. Gruaja kishte qenë në kontakt për herë të fundit me burrin në orën 8:45, kur A.Q. i kishte telefonuar për t'i thënë se duhet të udhëtonte nga puna e tij në Prizren për në Prishtinë, për të blerë bojëra për lyerje. Që prej asaj kohe, ajo nuk kishte dëgjuar më gjë për të. Kishte raportuar rrëmbimin e tij tek policia e UNMIK-ut, e cila nuk kishte përcaktuar dot fatin apo vendndodhjen e tij.

Pas shqyrtimit të hetimeve të UNMIK-ut, Institucioni i Ombudspersonit arriti në përfundimin se hapat e ndërmarra nga policia e UNMIK-ut nuk përmbushnin detyrimin për mbrojtjen e të drejtës së jetës sipas KEDNJ-së. Institucioni i Ombudspersonit gjykoi se vonesat në procesin e hetimit, që i atribuoheshin njësive të ndryshme të policisë së UNMIK-ut, Xhandarmërisë Franceze dhe autoriteteve të tjera kompetente, pasqyronin mungesën e gatishmërisë së duhur që kërkon KEDNJ-ja për hetimin e krimeve të rënda dhe zbuloi se veprimet e autoriteteve ishin të pamjaftueshme për mbrojtjen e së drejtës së jetës të A.Q.[222]

Në vijim të heqjes së juridiksionit të Institucionit të Ombudspersonit mbi UNMIK-un, në 23 mars 2006, PSSP shpalli Rregulloren 2006/12, Për Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), që krijon një organ ku mund të paraqiten ankesat për rastet kur pretendohet të jenë shkelur nga UNMIK-u të drejtat e njeriut, sikurse përkufizohen nga legjislacioni i zbatueshëm në Kosovë, .[223]

Në 2008-n, PKDNJ-ja filloi një fushatë gjithëpërfshirëse si në Kosovë dhe Serbi me qëllim informimin e popullsisë për mandatin dhe procedurat e saj, si dhe për të informuar personat për të drejtën e tyre për të ngritur ankesa kundër UNMIK-ut. Si pasojë, të afërmit e personave që besohet të jenë rrëmbyer nga UÇK-ja, kanë paraqitur disa kërkesa pranë PKDNJ-së lidhur me moskryerjen e hetimeve të menjëhershme, të paanshme dhe të efektshme nga ana e UNMIK-ut.[224]

Në 12 nëntor 2008 PKDNJ-ja nxori vendimin e saj të parë mbi mos-hetimin nga policia e UNMIK-ut të vrasjes së Remzije Canhasit në vitin 2000. Edhe pse ky rast nuk lidhet me krimet e luftës, Amnesty International gjykon se vendimi paraqet interes për çështjet që mund të ngrenë të afërmit e të rrëmbyerve.

Shaip Canhasi, bashkëshorti i të ndjerës, u ankua se UNMIK-u nuk kishte hetuar në mënyrën e duhur vrasjen e

gruas së tij, duke shkelur të drejtën e jetës të garantuar nga Neni 2 i KEDNJ-së. PKDNJ-ja konstatoi se "[p]avarësisht nga identifikimi i dukshëm i të dyshuarve të mundshëm të vrasjes, hetimi është zvarritur për tetë vjet pa arritur asnjë rezultat thelbësor." Edhe pse u krye autopsia dhe ekzaminimi forensik i vendit të vrasjes dhe dëshmitarët u pyetën nga policia, nuk u bë asnjë përpjekje për të marrë në pyetje ata individë që dëshmitarët thoshin se ishin përfshirë në vrasjen e Remzije Canhasi. Për më tepër, policia e UNMIK-ut nuk e mbajti Shaip Canhasin, të afërmin më të afërt, "të përfshirë në procesin e hetimin dhe të informuar lidhur me të. Me gjithë kërkesat e vazhdueshme për informacion mbi hetimin, ankuesi nuk njoftohej për zhvillimet."[225] PKDNJ-ja konstatoi shkeljen e së drejtës së jetës të mbrojtur nga Neni 2 i KEDNJ-së dhe urdhëroi të rihapej hetimi si dhe t'i jepej Shaip Canhasit një kompensim i përshtatshëm për vuajtjen e tij.[226]

## E DREJTA PËR TË DITUR: NJË SHKELJE E VAZHDUESHME

Të afërmit e të zhdukurve dhe të rrëmbyerve janë vetë viktima të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Jo vetëm që atyre u është mohuar e drejta e jetës familjare, cunguar nga vdekja e burrit, djalit, gruas, motrës së tyre, por edhe u është mohuar e drejta për të ditur fatin dhe vendndodhjen e anëtarit të tyre të familjes. Sipas Nenit 24 (1) të Konventës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë, "viktimë' do të thotë person 'i zhdukur' dhe çdo individ i cili ka pësuar dëm si pasojë e drejtpërdrejtë e zhdukjes me forcë."

Neni 24(2) i së njëjtës konventë parashikon se: "Çdo viktimë ka të drejtë për të ditur të vërtetën lidhur me rrethanat e zhdukjes me forcë, progresin dhe rezultatet e hetimit dhe fatin e personit 'të zhdukur'. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e nevojshme lidhur me këtë çështje."

*"Kam bërë gjithçka. Kam shkuar tek KFOR-i në Prishtinë. Jam takuar me policinë e ushtrinë tonë si dhe me UNMIK-un dhe u kam dhënë gjithë informacionin. Kam qenë tek qeveria e Kosovës dhe kam folur me Bajram Rexhepin [asokohe Kryeministër]; kam kontaktuar Flora Brovinën. Kam kontaktuar Barbara Davies të Komisionit të Lartë të të Drejtave të Njeriut të KB. Kam kontaktuar familjet që kanë paguar haraç. Kam dhënë mostrën e ADN-së. Kam bërë çdo gjë. Jemi ne, të gjithë shokët dhe të afërmit; ne jemi viktimat e këtij krimi."*

Amnesty International, shkurt 2009. Intervistë me D.M., një grua serbe djali 17 vjeçar i së cilës, Ivan, u rrëmbye në 19 gusht 1999.

E drejta e të afërmve për të ditur fatin e anëtarit të familjes së tyre është parashikuar gjithashtu në Nenin 32 të Protokollit I të katër Konventave të Gjenevës. Neni 33 parashikon më tej se "[s]apo të lejojnë rrethanat ... çdo palë e konfliktit duhet të kërkojë për personin i cili është raportuar si i pagjetur nga Pala kundërshtare." (Neni 33).

Sipas KNKK-së "[e] drejta për të ditur se çfarë i ka ndodhur një të dashuri të pagjetur është një çështje themelore e së drejtës humanitare dhe të drejtës të të drejtave të njeriut. Kjo e drejtë duhet të respektohet. Autoritetet dhe palët e konfliktit të mëparshëm janë të detyruara me ligj të japin përgjigje. KNKK-ja do të vazhdojë të mbështesë familjet e goditura në kërkesën e tyre për të zbuluar të vërtetën dhe për të shkuar tek autoritetet për t'u rikujtuar përgjegjësinë e tyre për të dhënë informacioni lidhur me vendndodhjet e të zhdukurve."[227]

Ky detyrim për t'i dhënë informacion të afërmve lidhur me fatin e "të zhdukurve" ose të rrëmbyerve është theksuar nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut të KB: *"UNMIK-u në bashkëpunim me IPVQ ... duhet të sigurojë që të afërmit e personave të zhdukur dhe të*

*rrëmbyer të marrin informacion rreth fatit të viktimave ...”*[228]

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se dhimbja dhe ankthi që i është shkaktuar të afërmve të viktimave të zhdukjeve me forcë për shkak se autoritetet nuk kanë qartësuar fatin e të dashurve të tyre, mund të përbëjë trajtim çnjerëzor dhe degradues, një shkelje të të drejtave të tyre sipas Nenit 3 të KEDNJ. Kjo është njohur gjithashtu si një shkelje që vazhdon derisa të kryhet një hetim i efektshëm.

Ankthi dhe dëshpërimi i shkaktuar nga mosnjohja e fatit të të afërmve të afërt bën që shumë persona të mos munden të rindërtojnë jetën e tyre si emocionalisht dhe praktikisht. Siç u shpreh M.P. për Amnesty International, “[n]ëna ime ka qarë absolutisht për çdo ditë gjatë këtyre 10 vjetëve të fundit.”[229] Edhe pse nuk janë ndërmarrë studime autoritative mbi pasojat e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë të të afërmve, këto pasoja kanë një ndikim të vazhdueshëm dhe të konsiderueshëm në shëndetin fizik dhe mendor mbi një përqindje të konsiderueshme të popullsisë. Kjo është gjithashtu e qartë nga intervistat e zhvilluara nga Amnesty International me këta të afërm.

As autoritetet në Serbi dhe as ato në Kosovë nuk kanë marrë ndonjë masë që njohin këtë aspekt të vazhdueshëm të shkeljes së të drejtave të të afërmve.[230]

## KTHIMI DHE MOSPËRSËRITJA

Neni 19 i Parimeve dhe Udhëzimeve Bazë të KB mbi të Drejtën për Zgjidhje Ligjore dhe Dëmshpërblim e përkufizon kthimin, ndër të tjera, si gëzimin e të drejtave të njeriut, qytetarisë, kthimin e një personi në vendin e rezidencës, rivendosjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin e pronës. Për shumë familje serbe dhe rome[231] dhe familje të pakicave të tjera të cilat tani jetojnë si persona të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi ose nën mbrojtjen e përkohshme të shteteve anëtare të BE-së, vazhdimi i mosndëshkimit dhe shqetësimet për sigurinë paraqesin pengesat më serioze për kthimin e tyre në vendin e mëparshëm të banimit në Kosovë. Shumë pak prej tyre kanë mundur të rimarrin pronat dhe pjesa më e madhe nuk kanë mjete financiare të rindërtojnë shtëpitë e shkatërruara.[232]

Pak gra serbe dhe rome, që u janë rrëmbyer të afërmit, ka gjasa të kthehen në komunitetet e tyre të para-luftës. Një grua serbe i tha Amnesty International “do të desha të shkoja në shtëpinë time vetëm sa për ta parë dhe të shikoja kush po jeton aty, po të kisha mbrojtje.” Ashtu si N.N., ato vazhdojnë të kenë frikë për sigurinë e tyre: anëtare të Shoqatës Serbe të Familjeve të Personave të Pagjetur dhe të Rrëmbyer në Kosovë (Udruzenje porodica nestalih i kidnapovanih lica sa Kosova) pranuan të intervistoheshin nga Amnesty International, me kusht ruajtjen e anonimitetit. Shumë pak prej tyre kishte besim se KFOR-i, UNMIK-u apo SHPK-ja do t'u garantonte sigurinë.

Megjithëse nënshkrimi nga Serbia i Konventës së KB për Mbrojtjen e Personave nga Zhdukjet me Forcë mund të merret si një tregues i “mospërsëritjes”, sikurse përkufizohet më sipër, Amnesty International gjykon se – ndërkohë që mbizotëron mosndëshkimi, trupat janë ende të pagjetur, autorët [e veprave penale] nuk janë sjellë para drejtësisë dhe statusi i Kosovës mbetet i pazgjidhur – të paktë do të jenë ata të afërm të shqiptarëve të Kosovës, viktima të zhdukjeve me forcë nga forcat serbe, ose ata të afërm të serbëve dhe romëve të rrëmbyer, që do të mendojnë se të drejtat e tyre janë mbrojtur apo respektuar.

# 6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Amnesty International gjykon se ka pengesa institucionale serioze për t'i dhënë fund frymës së mosndëshkimit për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë. Influenca e individëve, dikur të pushtetshëm, shtrihet në gjithë qeverinë e shoqërinë serbe dhe ato shqiptare të Kosovës dhe, në disa raste, edhe në komunitetin ndërkombëtar, edhe pse këta individë mund të mos kenë më pozitat që kishin gjatë luftës. Si në Serbi dhe Kosovë ka nga ata të cilët do të preferonin që të zhdukurit dhe të rrëmbyerit të mbeteshin të varrosur në të kaluarën, ndër të cilët edhe disa udhëheqës të UÇK-së dhe zyrtarë të policisë serbe, që nuk kanë interes të garantojnë të drejtën e të afërmve për të ditur të vërtetën.

Ky raport tregon se si Serbia dhe UNMIK-u nuk e kanë trajtuar çështjen e mosndëshkimit për krimet e luftës. Edhe pse në Serbi ka shenja progresi që nga koha e krijimit të Zyrës së Prokurorisë së Krimeve të Luftës, kjo ende mbetet me burime dhe mbështetje të pamjaftueshme për kryerjen e detyrës së saj. Në Kosovë, EULEX-i premton se do t'i japë përparësi zgjidhjes së krimeve të luftës dhe krimeve ndër-etnike të pazgjidhura, por mund të pengohet nga tradita e pasivitetit në hetime dhe ndjekje penale e trashëguar nga 10 vjetët e fundit.

Ashtu si me çdo krim, me kalimin e kohës bëhet gjithnjë e më vështirë për të mbledhur informacionin dhe provat e nevojshme për të kryer ndjekje penale të suksesshme. Sikurse tregon dhe ky raport, provat fizike – si vendndodhjet e varreve dhe trupave, plumbat dhe provat e tjera kontekstuale – ende mbeten për t'u grumbulluar nga hetuesit ose i duhen vënë atyre në dispozicion. Disa prova të marra nga Tribunali janë asgjësuar, deklarata të mbledhura nga KFOR-i nuk janë bërë të disponueshme, dhe prova të tjera mund të jenë ndotur, shkatërruar me qëllim apo zhdukur. Kujtimet e dëshmitarëve mund të jenë ndikuar ose shtrembëruar me kalimin e kohës, ose mund të jenë ngulitur si rezultat i ri-tregimit shumë të shpeshtë të historive. Mundet që dhe përcaktimi i vendndodhjes së dëshmitarëve të jetë i pamundur. Ndërkohë që kultura e mosndëshkimit dhe frikësimi i dëshmitarëve mbizotëron si në Kosovë dhe Serbi, i shumtë do jetë numri i atyre që do të vazhdojnë të mos pranojnë të ofrojnë dëshmi.

## REKOMANDIME

Qeveritë e Serbisë dhe Kosovës duhet të tregojnë një angazhim dhe mbështetje publike për të gjitha masat që do të mundësojnë t'i jepet fund mosndëshkimit për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë.

Si Serbia dhe Kosova duhet të fusin në Kodet Penale përkatëse një përkufizim të krimit në përputhje me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë. Serbia duhet të ratifikojë Konventën pa vonesë.

## ZHVARRIMET DHE IDENTIFIKIMET

- Ushtria dhe autoritetet policore serbe duhet të gjejnë informacionin për vendndodhjen e varreve individuale dhe varreve masive që kanë mbetur në Serbi. Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Mbrojtjes duhet të jenë të parët në bërjen publike të këtij informacioni.

- Ish-anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) duhet të japin informacion të plotë për vendndodhjen e varreve individuale apo varreve masive në Kosovë. Këtu duhet të përfshihen ata ish-komandantë apo udhëheqës politikë të UÇK-së, të cilët janë aktualisht në pozicione pushteti në qeverinë e Kosovës ose janë anëtarë të Kuvendit, si dhe anëtarët e Forcave të Sigurisë së Kosovës.[233] Kryeministri i Kosovës dhe Presidenti i Kosovës duhet të marrin rol drejtues në këtë proces;

- Duhet të krijohen mekanizma shtesë për mbledhjen e informacionit për vendndodhjen e varreve masive. Institucionet kompetente në Serbi dhe Kosovë duhet të kërkojnë ndihmë financiare nga BE dhe shtetet anëtare të BE për të mbështetur funksionimin e këtyre mekanizmave;

- Prokuroria në të dyja juridiksionet duhet të rivendosë protokolle për shkëmbimin e të gjitha informacioneve përkatëse për vendndodhjen e mundshme të varreve;

- Duke pasur parasysh rolin që ka luajtur komuniteti ndërkombëtar në Kosovë, organizatat ndërkombëtare dhe shtetet anëtare të KB duhet të analizojnë çdo dokument që posedojnë mbi konfliktin e armatosur dhe pasojat e tij, për të përcaktuar nëse ata kanë ndonjë informacion që lidhet me eshtrat, varret apo personat e pagjetur, dhe t'ia paraqesin këtë informacion anëtarëve të Grupit të Punës ose Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK);

- BE dhe shtetet anëtare të BE duhet t'i sigurojnë Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), në veçanti Zyrës së Personave të Zhdukur dhe Mjekësisë Ligjore (ZPZHML), burime të mjaftueshme njerëzore, teknike, dhe financiare për të hetuar dhe gërmuar të gjitha vendndodhjet e mundshme të varreve; masa të menjëhershme duhen marrë për të kërkuar mjete për përcaktimin e identitetit të mbi 400 trupave të paidentifikuar që mbahen në morgun e ZPZHML-së.

- Duhet të lidhen marrëveshje ndër-kufitare me shtetet fqinje ku ka dyshime të arsyeshme se mund të ketë vendndodhje varresh;

- Komuniteti ndërkombëtar duhet të vazhdojë të sigurojë ndihmë financiare, ekspertizë dhe mbështetje për programin e identifikimit me anë të ADN-së, të marrë përsipër nga Komiteti Ndërkombëtar për Personat e Pagjetur (KNPP).

## HETIMET DHE NDJEKJET PENALE

Qeveritë e Kosovës dhe të Serbisë dhe ato autoritete të UNMIK-ut që kanë mbetur duhet:

- Të mos bëjnë ndërhyrje politike në hetimin e krimeve të luftës;

- të demonstrojnë mbështetje politike për hetimet dhe ndjekjet penale, përfshi këtu nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet hetuese përkatëse;

- të miratojnë një Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunim reciprok në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës. Kjo marrëveshje duhet të lidhet edhe midis Serbisë dhe EULEX-it.

- BE dhe shtetet anëtare të BE duhet të sigurojnë mjete financiare dhe burime të tjera të mjaftueshme për Zyrën e Prokurorisë së Krimeve të Luftës (ZPKL) dhe Dhomën Speciale për Krimet e Luftës në Beograd dhe misionin e Policisë dhe Drejtësisë së EULEX-it me qëllim që:

- të sigurohet një hetimin i menjëhershëm, i pavarur, i efektshëm dhe i paanshëm i krimeve të luftës, përfshirë zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë;

- të zhvillohet një program i efektshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve që siguron mbrojtjen e dëshmitarëve dhe mbështetjen e tyre si para dhe gjatë e pas procedimeve penale;

- të merren masa që të gjitha gjykatat në Kosovë të jenë të pajisura me lidhje me video dhe masa të tjera për mbrojtjen e dëshmitarëve, ashtu sikurse parashikohet në rregulloret përkatëse të UNMIK-ut dhe në legjislacionin e vendit;

- të sigurohet se shërbimi për mbrojtjen e dëshmitarëve në Dhomën Speciale të Krimeve të Luftës të jetë i pajisur me personelin dhe burimet e përshtatshme;

- të krijohet një drejtori e veçantë për krimet e luftës brenda Ministrisë së Brendshme ose Ministrisë së Drejtësisë, ose t'i jepet Zyrës së Prokurorisë së Krimeve të Luftës (ZPKL) kontroll mbi njësinë.

EULEX-i duhet të vazhdojë të miratojë rekomandimet e bëra nga Amnesty International në raportin kësaj organizate të janarit 2008, të cilat kishin si qëllim sigurimin në Kosovë të një gjyqësori të efektshëm dhe të paanshëm, në veçanti nëpërmjet prezantimit të masave për të siguruar llogaridhënien e gjyqësorit dhe prokurorëve ndërkombëtarë; rekrutimin e individëve me eksperiencë, ekspertë në të drejtën civile, penale, humanitare, dhe atë të të drejtave të njeriut; për të krijuar një bazë të dhënash që t'i sigurojë publikut qasje në akt-akuzat, gjykimet dhe vendimet të tjera publike të paneleve ndërkombëtare të UNMIK-ut në të kaluarën dhe të gjyqtarëve të EULEX-it; duke siguruar trajnimin e vazhdueshëm të tyre në ligjet e zbatueshme në Kosovë.

- Lidhur me të drejtat e të dyshuarve (dhe të anëtarëve të familjes), EULEX-i duhet të sigurojë që të gjitha procedimet që përfshijnë gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë të jenë tërësisht dhe njëkohësisht të përkthyera në gjuhët zyrtare të Kosovës dhe të të gjitha palëve, duke përfshirë avokatin mbrojtës, të akuzuarin e viktimat, dhe të sigurojë që familjet e tyre të marrin në kohën e duhur kopje të të gjitha dokumenteve të gjykatës, të përkthyera në gjuhën gjegjëse.
- Të bëhen përgatitjet për krijimin e një zyre ndërkombëtare për avokatët mbrojtës, e cila mund t'u ofrojë atyre ndihmë për përgatitjen e çështjeve.

- Duke pasur parasysh se misioni i EULEX-it do të qëndrojë në Kosovë vetëm për një kohë të kufizuar dhe nuk planifikon të zgjidhë të gjitha çështjet e pazgjidhura të krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve ndër-etnike, Amnesty International nxit Policinë dhe Gjyqësorin e EULEX-it të hartojnë dhe zbatojnë një plan veprimi për të siguruar, me anë të trajnimit dhe këshillimit të policisë vendore dhe prokurorëve dhe gjyqtarëve vendas, dhe duke punuar në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, një Njësi të pavarur për Krimet e Luftës në Shërbimin Policor të Kosovës si dhe prokurorë e gjyqtarë të specializuar brenda Ministrisë së Drejtësisë përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të *të gjitha* krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve ndër-etnike.

## TË DREJTAT E TË AFËRMVE

Qeveritë duhet të marrin masa se policia dhe prokurorët në Serbi dhe Kosovë:

- Do të mbajnë të afërmit të informuar rregullisht dhe plotësisht për hetimet dhe ndjekjet penale në të gjitha fazat e procedimeve të çështjeve që kanë të bëjnë me anëtarët e familjeve të tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë dhe Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ);

- sigurojnë garantimin në mënyrë të efektshme të të drejtave të viktimave dhe të familjeve të tyre për mbrojtje, mbështetje, informacion lidhur me procedimet penale dhe civile si dhe dëmshpërblim të plotë;

- sigurojnë që procedurat për marrjen e dëmshpërblimit të jenë të menjëhershme, të pavarura, të paanshme, dhe të efektshme.

Qeveritë e Serbisë dhe Kosovës duhet:

- të shprehin në nivel ministerial mbështetje publike për të drejtat e të afërmve të viktimave të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë;

- të amendojnë legjislacionin me qëllim njohjen e shkeljes së vazhdueshme të të drejtave të të afërmve, duke i mundësuar ata të jenë titullarë të vetë të drejtës së tyre për statusin e viktimave civile të luftës, dhe të sigurojnë se ata kanë të drejtën e dëmshpërblimit nga autoritetet që nuk u kanë dhënë informacion mbi fatin dhe vendndodhjen e anëtarëve të familjes së tyre;

- të amendojnë legjislacionin për të siguruar që dispozitat për dëmshpërblim, duke përfshirë kompensimin, nuk diskriminojnë të afërmit e civilëve dhe nuk u kërkojnë t'i deklarojnë të afërmit e tyre të vdekur, kur ata konsiderohen të pagjetur nga një autoritet i pavarur si KNKK-ja;

- të identifikojnë burimet financiare për t'i siguruar të afërmve dëmshpërblim të përshtatshëm;

- në përgatitjen e këtij legjislacioni qeveritë duhet të këshillohen me të afërmit;

- të dy qeveritë duhet të sigurojnë që të gjithë të afërmit të informohen për të drejtat e tyre nëpërmjet Komisioneve të Personave të Pagjetur dhe të marrin masa të veçanta për të siguruar se anëtarët e komunitetit rom dhe komuniteteve të tjera, duke përfshirë ata që jetojnë gjetiu si personat e zhvendosur brenda vendit apo si refugjatë, të jenë tërësisht të informuar për këto të drejta;

- të sigurojnë që të gjitha këto masa të marrin parasysh natyrën gjinore të zhvendosjeve dhe rrëmbimeve me forcë , dhe të kenë një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë në sigurimin e të drejtave të të afërmve.

- Së fundi, ndonëse Amnesty International nuk pozicionohet nëse këto shtetet duhet të jenë anëtarë të BE-së ose jo, organizata nxit Komisionin Evropian që në raportet vjetore mbi progresin në Serbi dhe Kosovë, të sigurohet monitorimi i kujdesshëm i progresit për t'i dhënë

fund mosndëshkimit për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, si një detyrim thelbësor në përputhje me Kriteret e Kopenhagenit për pranimin në Bashkimin Evropian.

# INICIALET DHE SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| BH | Bosnja dhe Hercegovina |
| NJQHP | Njësia Qendrore për Hetime Penale (policia e UNMIK-ut) |
| ADN | Acidi deoksiribonukleik |
| KE | Komisioni Evropian |
| KEDNJ | Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore |
| BE | Bashkimi Evropian |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, [inicialet në anglisht] |
| RFJ | Republika Federale e Jugosllavisë |
| QDH | Qendra e së Drejtës Humanitare |
| PKDNJ | Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut |
| HRW | Vëzhguesi i të Drejtave të Njeriut [ inicialet në anglisht] |
| KNDCP | Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike |
| KNPP | Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Pagjetur |
| KNKK | Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq |
| QNDT | Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë Tranzicionale |
| PZHBV | Personat e Zhvendosur Brenda Vendit |
| GJPN | Gjyqtarët dhe Prokurorët Ndërkombëtarë, UNMIK |
| KFOR | Forcat Kosovare të udhëhequra nga NATO, [inicialet në anglisht] |
| SHPK | Shërbimi Policor i Kosovës |
| UÇK | Ushtria Çlirimtare e Kosovës |
| MUP | Ministria e Brendshme [inicialet në serbisht] |
| NATO | Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut [inicialet në anglisht] |

| | |
|---|---|
| OJQ | Organizata Jo-Qeveritare |
| IOK | Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë |
| ZL | Zyra Ligjore (UNMIK) |
| ZPZHML | Zyra e Personave të Zhdukur dhe Mjekësisë Ligjore |
| OSBE | Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimit në Evropë |
| PKL | Prokuroria e Krimeve të Luftës (Serbi) |
| IPVQ | Institucionet Provizore të Vetë-Qeverisjes |
| PJP | Njësitë e Policisë Speciale, në serbisht *Posebnih jedinica policije* |
| RDB | Sigurimi i Shtetit, në serbisht *Resor državne bezbednosti* |
| RJB | Departamenti i Sigurisë Publike, në serbisht *Resor javne bezbednosti* |
| RFSJ | Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë |
| PSSP | Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në Kosovë |
| TPNJ | Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë |
| UNHCR | Komisioneri i Lartë i KB për Refugjatët [inicialet në anglisht] |
| UNMIK | Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë [inicialet në anglisht] |
| KSKB | Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara |
| VJ | Ushtria e Jugosllavisë, në serbisht *Vojska Jugoslavije* |
| DHSKL | Dhoma Speciale e Krimeve të Luftës, Gjykata e Rrethit të Beogradit |
| SHHKL | Shërbimi Hetimor i Krimeve të Luftës (policia serbe) |
| PKL | Prokuroria e Krimeve të Luftës |
| NJHKL | Njësia e Hetimit të Krimeve të Luftës (EULEX) |
| NJKL | Njësia e Krimeve të Luftës (UNMIK) |

# SHTOJCA 1: ÇËSHTJE EMBLEMATIKE TË NDJEKURA NGA AMNESTY INTERNATIONAL

| Emri, data kur është parë për herë të fundit, referenca nga KNKK-ja | Zhvarrimi/Identifikimi | Hetime dhe Ndjekje Penale[234] |
|---|---|---|
| **KOSOVARË-SHQIPTARË QË BESOHET TË JENË VIKTIMA TË ZHDUKJEVE ME FORCË NGA FORCAT SERBE** | | |
| Bekim Rrecaj<br>KMI BLG-802481<br>Mehmet Tupella<br>KMI BLG 802482<br>Basri (Bastria) Tupella<br>KMI BLG 802482 | Trupi i Bekim Rrecaj u zhvarros nga Bajna Bashta në Serbi, dhe iu kthye familjes së tij në 16.11.2007. Trupi i Mehmet Tupellës u zhvarros në Vidomiric (Mitrovicë) në 15.12.2002 dhe iu kthye familjes së tij në 05.08.2005. Trupi i Basri Tupellës nuk është gjetur. | Nuk është marr asnjë informacion. |
| Afrim Dana<br>DJA BLG-800942<br>Albert Dana<br>DJA BLG-800940<br>Luan Dana<br>DJA BLG-801034<br>Labinot Dana<br>DJA BLG-801034<br>Kastriot Dana<br>DJA BLG-801033<br>Gëzim Dana[235]<br>DJA BLG 801035<br>Këta persona u arrestuan të gjithë në grup në 10 maj 1999. | Trupat e anëtarëve të familjes Dana u zhvarrosën nga Batajnica në Serbi. Trupi i Afrim Danës iu kthye familjes së tij në 15.01.2005. Të gjitha eshtrat e tjera u kthyen në 25.08.2005. | Gusht 2008; NJKL e UNMIK-ut; Hetim nga policia;<br><br>Dhjetor 2008: çështja për t'ju transferuar prokurorëve të EULEX-it. |
| Albion Kumnova<br>DJA BLG-801769<br>Artan Efendia<br>DJA BLG-801037<br>Gëzim Deva<br>DJA BLG-803511<br>Lutfi Bunjaku<br>DJA BLG-801030 | Trupi i Albion Kumnovës ende nuk është gjetur. Trupat e të gjithë anëtarëve të tjerë të këtij grupi u zhvarrosën nga Peruçac (Bajna Bashtë) në shtator 2001 dhe iu kthyen familjeve të tyre në | Gusht 2008: çështja është në fazën fillestare të hetimit nga një prokuror ndërkombëtar i UNMIK-ut; konfirmuar nga Departamenti i Drejtësisë (DD) i UNMIK-ut, dhjetor 2008. |

| | | |
|---|---|---|
| Bekim Bunjaku<br>DJA BLG-801030<br>Shkëlzen Binishi<br>DJA BLG-800829<br><br>Arrestuar së bashku në 31 mars 1999. | 20.09.2006. | |
| Bekim Beqiri<br>jo i listuar | | Asnjë raport penal i lidhur me emrin e tij. |
| Artan Qerkezi<br>DJA BLG-801535<br>Edmond Qerkezi<br>DJA BLG-801535<br>Vegim Qerkezi<br>DJA BLG-801536<br>Shpejtim Ymeraga<br>DJA BLG-800954<br>Skënder Dylhasi<br>DJA BLG-801038<br>Myrtezan Dylhasi<br>DJA BLG-803295<br>Fatos Jetishi<br>DJA BLG-801009<br>Shpend Jetishi<br>DJA BLG-801009<br>Halim Qerkezi<br>DJA BLG-801535<br>Armend Qerkezi<br>DJA BLG-803297<br>Ardian Qerkezi<br>DJA BLG-801535<br><br>Të gjithë këta burra u arrestuan së bashku në 27 prill 1999. | Trupi i Artan Qerkezit u zhvarros nga Tribunali në vitin 2000 në Prizren dhe iu kthye familjes në 15.12.2005.<br><br>Trupi i Edmond Qerkezit u zhvarros nga Tribunali në vitin 2000 në Gjakovë dhe iu kthye familjes në 15.12.2005.<br><br>Trupat e anëtarëve të tjerë të këtij grupi nuk janë gjetur. | Gusht 2008: çështja është në fazën fillestare të hetimit nga një prokuror ndërkombëtar i UNMIK-ut; konfirmuar nga DD i UNMIK-ut, dhjetor 2008. |

## SERBËT DHE ROMËT[236] QË BESOHET TË JENË RRËMBYER NGA USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS

| | | |
|---|---|---|
| Petrija Piljeviq<br>Rrëmbyer në 28 qershor 1999<br>PRI BLG-800674 | Trupi i saj u gjet në Dragodan, Prishtinë dhe u zhvarros në vitin 2000 nga Tribunali. Trupi iu kthye familjes në 15.08.2001. | Gusht 2008: çështja është nën hetim nga Njësia Krimeve të Luftës e policisë së UNMIK-ut.<br>Dhjetor 2008: nuk është regjistruar si subjekt për të cilin ka ndonjë raportim penal, hetim, apo ndjekje penale. |
| Gradimir Stoliq<br>25 gusht 1999 | | Gusht 2008: çështja është nën hetim nga Njësia Krimeve të |

| | | |
|---|---|---|
| GJI BLG-801720 | | Luftës e policisë së UNMIK-ut.<br><br>Dhjetor 2008: çështja nuk është regjistruar në sistemin e të dhënave të NJKL-së. |
| Tihomir Patrnogiq<br>1 shtator 1999<br>BLG 802702_01 | | Gusht 2008: çështja nën hetim nga Njësia e Krimeve të Luftës e policisë së UNMIK-ut.<br><br>Dhjetor 2008: nuk ka asnjë provë se çështja e tij lidhet me krime lufte. |
| Ramadan Halilaj (Halili)<br>DJA BLG802522<br>Xhevdet Cufaj (asnjë referencë)<br>Vehbi Mailiqi (asnjë referencë)<br>Qershor 1999 | Trupi i Ramadan Halilajt u gjet në dy vende: Pyllin Ramoc në 04.09.2004 dhe Dragodan në 18.06.2003, dhe iu kthye familjes së tij në 17.07.2007 | Dhjetor 2008: nuk është regjistruar si subjekt i ndonjë raportimi penal, hetimi, apo ndjekje penale. |
| Kujtim Imeraj<br>Qershor 1998<br>DJA BLG-803492<br>Bashkim Imeraj<br>16 qershor 1999<br>DJA BLG-802519 | Trupi i Kujtim Imeraj u gjet në Piskote, Gjakovë, në 10.10.2005 dhe iu kthye familjes së tij në 17.07.2007.<br><br>Trupi i Bashkim Imeraj nuk është gjetur. | Kujtim Imeraj, shih Prokurori v. Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, Lahi Brahimaj, IT-04-84-T, 3 prill 2008, paragrafët 298-302 ku Dhoma Gjyqësore konstatoi se kishte prova të pamjaftueshme që të akuzuarit Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, dhe Lahi Brahimaj të ishin përgjegjës për veprimet penale lidhur me vdekjen e tij.<br><br>Gusht 2008: Bashkim Imeraj, Hetohet nga NJKL e Policisë së UNMIK-ut. |
| Vesel Rama<br>PRI BLG-802589<br>Qershor 1999 | Trupi i Vesel Ramës u gjet në Makovc në 11.09.2003 dhe iu kthyet familjes së tij në 03.12.2003. | Gusht 2008: Në fazën fillestare të hetimit nga një prokuror ndërkombëtar. |
| Rexhe Shala<br>BLG-804815-01<br>Qershor 1999 | Trupi i tij nuk është gjetur. | Në 18 shtator 2006 Anton Lekaj u dënua për vrasje nga DHSKL e Serbisë, shih seksionin më sipër "Ndërhyrjet politike në rrjedhën e drejtësisë" |
| Bajram Krasniqi<br>(asnjë referencë) | Sipas ZPZHML-së u zhvillua një analizë ADN-je, por ZPZHML-ja nuk | Gusht 2008: Asnjë raportim penal |

| | | |
|---|---|---|
| | vendosi dot kontakt me familjen e tij. | nuk lidhet me këtë emër. |
| Abdyl (Avdul) Imeraj<br>DJA BLGS-802521 | | Gusht 2008: Asnjë raportim penal nuk lidhet me këtë emër. |
| Daka Asani/Asanoviq<br>1 gusht 1999<br>DJA BLGS-802521 | Trupi i Daka Asanit u zhvarros në vitin 2000 nga Tribunali dhe iu kthye familjes së tij në dhjetor 2006. | Gusht 2008: Asnjë raportim penal nuk lidhet me këtë emër. |

# FUNDSHËNIME

---

[1] KNKK, *Statistics – Kosovo Conflict*, 14 prill 2009 (Përkthimi i burimit: Statistika – Konflikti i Kosovës).

[2] Kosova deklaroi unilateralisht pavarësinë nga Serbia më 17 shkurt 2008; deri në 28 prill 2009, pavarësinë e saj e kanë njohur 58 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara . Në 1999-n Serbia ishte një shtet përbërës i Republikës Federale të Jugosllavisë. Emri i shtetit u ndryshua në Serbia dhe Mali i Zi me Kushtetutën e nëntor 2002-shit. Ky emër hyri në fuqi më 4 shkurt 2003. Pas një referendumi në qershor 2006, Republika e Malit të Zi u nda nga Serbia dhe Mali i Zi dhe Republika e Serbisë u bë një shtet i pavarur.

[3] Shih: *Amnesty International, FRY (Kosovo), A Decade of Unheeded Warnings*, Vols. 1 & 2, (Index: EUR 70/39/99 & EUR 70/40/99) (Përkthimi i burimit: RFJ (Kosova), Një Dekadë pa u Vënë Veshin Paralajmërimeve).

[4] Amnesty International: *"Collateral Damage" or Unlawful Killings? Violations of the Laws of War by NATO during Operation Allied Force*, (Index: EUR 70/18/00), qershor 2000 (Përkthimi i burimit: Dëm Kolateral apo Vrasje të Paligjshme? Shkeljet e Ligjeve të Luftës nga NATO gjatë Operacionit të Forcave Aleate).

[5] http://www.unhcr.ch/news/media/kosovo.htm, 4 maj 1999.

[6] http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm

[7] Rezoluta 1244 (1999), Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij të 4011-të, më 10 qershor 1999, S/RES/1244 (1999), gjendet në http://daccess-ods.un.org/TMP/658974.9.html; S/1999/779: Report of the Secretary-General of the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, 12 korrik 1999 (Përkthimi i burimit: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë) përgatitur në përputhje me paragrafin 20 të rezolutës së Këshillit të Sigurimit; raporti skicoi autoritetin, kompetencat, strukturën dhe përbërësit kryesor të UNMIK-ut, http://daccess-ods.un.org/TMP/658974.9.html, pasur akses në prill 2009.

[8] Neni 9 (c); Neni 11(k); Neni 10, Rezoluta 1244 (1999).

[9] Në përputhje me Seksionin 1.1, të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1, 25 korrik 1999, "Tërë kompetenca legjislative dhe ekzekutive në Kosovën, përfshirë administrimin e gjyqësorit, i takon UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm."

[10] Këto standarde parashikoheshin në Seksionin 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 dhe përfshinin Deklaratën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut; Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e Protokollet përkatëse; Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet përkatëse; Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale, dhe Kulturore; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave; Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese; Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës.

[11] Emrat e qyteteve, qytezave dhe fshatrave, me përjashtim të Prishtinës, referohen në shqip dhe serbisht.

[12] *Smrekovnica prison: a regime of torture and ill-treatment leaves hundreds unaccounted for*, (Index: EUR 70/107/99) tetor 1999 , faqja 2-3. (Përkthimi i burimit: Burgu i Smrekovnicës: një regjim torture dhe keqtrajtimi lë qindra të zhdukur). M.K. u intervistua nga Amnesty International në maj 1999-të (Përkthimi i burimit: Burgu i Smrekovnicës: një regjim torture dhe keqtrajtimi lë qindra të zhdukur). Smrekovnica/Smrekonicë është një fshat në gjysmë të rrugës ndërmjet Kosovska Mitrovicës/Mitrovica dhe Vushtrrisë/Vučitrn.

[13] Disa shqiptarë etnikë u rrëmbyen dhe u vranë nga grupe të armatosura të përbërë nga shqiptarë etnikë, shih kapitullin 4.

[14] Shih për shembull, Amnesty International, *Smrekovnica prison: a regime of torture and ill-treatment leaves hundreds unaccounted for*; (Përkthimi i burimit: Burgu i Smrekovnicës: një regjim torture dhe keqtrajtimi lë qindra të zhdukur).

[15] Shih: *KFOR forces should live up to responsibility to protect all inhabitants of Kosovo*, (Index: 70/101/99), 25 qershor 1999 (Përkthimi i burimit: Forcat e KFOR-it duhet t'i përgjigjen përgjegjësisë për të mbrojtur të gjithë banorët e Kosovës); Kosovo: murder of 14 ethnic Serbs -- UN civilian police must be deployed, (Index: EUR 70/104/99) 26 korrik 1999 (Përkthimi i burimit: Kosova: vrasja e 14 serbëve etnikë – Duhet të dislokohet Policia civile e KB).

[16] Në 15 tetor 1999, Kryqi i Kuq Jugosllav dhe autoritetet lokale dëshmuan se afro 230884 persona nga Kosova ishin të regjistruar si të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi, Overview of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo, 3 nëntor 1999, UNHCR/OSBE (Përkthimi i burimit: Përmbledhje e Situatës së Pakicave Etnike në Kosovë)

[17] Intervista e Amnesty International me V.T., Beograd, shkurt 2009.

[18] *Report of the Special Rapporteur for Bosnia and Herzegovina, Croatia and the Federal Republic of Yugoslavia*, UN Doc. A/54/396, 24 shtator 1999, paragrafi 112 (Përkthimi i burimit: Raport i Raportuesit Special për Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë dhe Republikën Federale të Jugosllavisë).

[19] Shih: Amnesty International, *A Broken Circle: "Disappeared" and abducted in Kosovo province*, (Index EUR 70/106/1999), nëntor, 1999, faqja 8 (Përkthimi i burimit: Një rreth i ndërprerë: "I zhdukur" dhe i rrëmbyer në krahinën e Kosovës.)

[20] Më 13 qershor 1999 një zëdhënës i KFOR-it raportoi se, që prej 12 qershorit 1999, janë vrarë 348 persona. Qendra për Paqe dhe Tolerancë, një OJF e serbëve të Kosovës, raportonte se 644 serbë ishin rrëmbyer dhe më shumë se 40 ishin vrarë pas vendosjes së trupave të KFOR-it në qershor 1999, *FRY: In the Interests of Justice*, (Index: EUR 70/121/99), nëntor 1999, faqja 5 (Përkthimi i burimit: RFJ: Në Interes të Drejtësisë).

[21] Shih: *Amnesty International, FRY (Kosovo): Update from the field January 2000*, (Index: EUR 70/02/00), janar 2000 (Përkthimi i burimit: RFJ (Kosova): Përditësim nga terreni, janar 2002). Asokohe pakicat përbënin 5-8% të popullsisë.

[22] Bazuar në vlerësime nga burime të ndryshme.

[23] Intervistë me nënën e Marijan Melonashit, Beograd, shkurt 2009. Më 20 qershor 2000, Valentina Cukiq, redaktore e programit në gjuhën serbe të Radio Kontaktit, u qëllua në kraharor.

[24] Për shqetësimin e vazhdueshëm të Amnesty International për shkeljen e të drejtave të njeriut të komuniteteve në pakicë në Kosovë shih për shembull*: "Prisoners in our own homes": Amnesty*

*International's concerns for the human rights of minorities in Kosovo/Kosova,* (Index: EUR 70/010/2003), prill 2003 (Përkthimi i burimit: 'Të burgosur në shtëpitë tona': Shqetësimet e Amnesty International për të drejtat e njeriut të pakicave në Kosovo/Kosovë); *Serbia and Montenegro (Kosovo/Kosova): The March Violence: KFOR and UNMIK's failure to protect the rights of the minority communities,* (Index: EUR 70/016/2004), 8 korrik 2004 (Përkthimi i burimit: Serbia dhe Mali i Zi (Kosovo/Kosova): Dhuna e marsit: i UNMIK-u dhe KFOR-i nuk arritën të mbrojnë të drejtat e komuniteteve në pakicë).

[25] Përdorimi i shprehjes 'zhdukje me forcë', i përdorur nga Amnesty International është në përputhje me përkufizimin e kësaj shprehje në rang ndërkombëtar ashtu sikurse parashikohet në Nenin 2 të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë: "Për qëllimet e kësaj Konvente 'zhdukje me forcë' konsiderohet arrestimi, ndalimi, rrëmbimi ose çdo lloj mohimi lirie nga agjentët e Shtetit apo personat a grupe personash që veprojnë me autorizimin, mbështetjen, pranimin e heshtur të Shtetit, të ndjekur nga mohimi për të njohur mohimin e lirisë apo nga fshehja e fatit apo vendndodhjes së personit të zhdukur, që e vendos këtë person jashtë kuadrit të mbrojtjes ligjore." Kjo Konventë u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në dhjetor 2006 dhe ende nuk ka hyrë në fuqi. Konventa do të hyjë në fuqi kur 20 shtete të jenë palë e saj. Deri në maj të vitit 2009 vetëm 10 shtete ishin palë e kësaj Konvente.

[26] *Cyprus v Turkey*, vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (10 maj 2001) në paragrafët 136 dhe 150, Neni 8 (1) (b) i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë; Neni 17 (1) i Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë.

[27] Serbia dhe Mali i Zi e ratifikuan KEDNJ-në në 3 mars 2004.

[28] Legjislacioni i zbatueshëm në Kosovë pas vendosjes së UNMIK-ut u përcaktua në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1, e cila ndryshoi Rregulloren 1999/24, *Për Ligjin në Fuqi në Kosovë* (12 dhjetor 1999) e cila parashtron se: "1.3 Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në: [midis të tjerash] (b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut të 4 nëntorit 1950 dhe Protokollet e saj; (c) Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të 16 dhjetorit 1966 dhe Protokollet e saj."

[29] Neni 3 i cili gjendet si në Konventat e Gjenevës të 1949-ës dhe në nenet 4 dhe 5 të Protokollit II të Konventave të Gjenevës.

[30] Neni 7 (i) dhe (e) i Statutit të Romës së Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

[31] Prokurori kundër. Milan Milutinoviqit, Nikolla Shainoviqit, Dragoljub Ojdaniqit, Nebojsha Pavkoviqit, Vladimir Llazareviqit dhe Sreten Lukiqit, Çështja nr. IT-05-87-T.

[32] Prokurori kundër. Fatmir Limaj, Isak Musliu dhe Haradin Bala, Çështja nr. IT-03-66-I; Prokurori kundër. Ramush Haradinaj, Idzriz Balaj dhe Lahi Brahimaj, (IT-04-84).

[33] Serbi: Neni 142, Krimet e Luftës Kundër Popullsisë Civile përfshijnë: sulmimin e popullsisë civile që sjellë si pasojë vdekjen, vrasjen, torturimin, trajtimin çnjerëzor; marrjen peng; vendosjen e paligjshme në kampe përqendrimi dhe arrestime dhe ndalime të tjera të jashtëligjshme, të parashikuara në Kapitullin 16 ("Veprat Penale kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare"), Kodi Penal Bazë, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 44/1976, Nenet 141-156. Sipas Nenit 371 të Ligjit mbi Organizimin e Juridiksionit të Autoriteteve Qeveritare për Ndjekjen Penale të Autorëve të Krimeve të Luftës, (Gazeta Zyrtare, nr.

67/2003, 1 korrik 2003) përkufizimet e krimeve kundër njerëzimit përfshijnë: "ndalimin ose rrëmbimin e personave pa u njoftuar për këtë veprim duke u shkaktuar atyre mohim të mbrojtjes së ofruar nga korniza ligjore."

[34] Kosova: Neni 142: Krimet e Luftës Kundër Popullsisë Civile përfshijnë: vrasjet, torturën, trajtimin çnjerëzor; marrjen peng; vendosjen e paligjshme në kampe përqendrimi dhe arrestime dhe ndalime të tjera të jashtëligjshme duke shkaktuar mohimin e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm, dhe Nenin 125, Terrorizmi, Kodi Penal i 1976-ës i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ) dhe Kodi Penal Bazë i Republikës së Serbisë, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 44 e 8 tetorit 1976. Ligji në fuqi në Kosovë parashikohet në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24.

[35] Këto përgjegjësi burojnë, ndërmjet të tjerash, nga Nenet 2, 6, dhe 9 i KNDCP dhe Nenet 13, 2, 3 dhe 5 të KEDNJ, *Cyprus v. Turkey* vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (10 maj 2001) në paragrafin 147; *Cicek v. Turkey*, vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (27 shkurt 2001) në paragrafin 164. Shih Nenet 12 dhe 3 të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë.

[36] Shih për shembull, *Luluyev dhe të Tjerë kundër. Rusisë*, vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (nëntor 2006) paragrafët 90 dhe 122.

[37] Neni 12(1) i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, Neni 13(3) i Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë; Neni 5(d) i Deklaratës së Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit apo Abuzimit të Pushtetit.

[38] *Cyprus v. Turkey* (Qipro kundër Turqisë), vendimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (2001) në paragrafët 156-158; Khaila Isayeva v. Rusisë, 15 nëntor 2007 në paragrafin 130; Neni 24(2) i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë.

[39] *Cyprus v. Turkey*, (10 maj 2001), Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, paragrafët 136 dhe 156-158. Komiteti i të Drejtave të Njeriut ka njohur se "ankthi dhe stresi" i vuajtur nga anëtari i familjes së një viktime të zhdukur me forcë mund të përbëjë shkelje të Nenit 7 të KNDCP mbi torturën dhe trajtimin çnjerëzor apo degradues. Quinteros v. Uruguay (Kinteros kundër Uruguajit) (107/1981), Raporti i Komitetit të të Drejtave të Njeriut.

[40] Të pesë format e dëmshpërblimit përcaktohen në Nenet 19-23 të Parimeve dhe Udhëzimeve Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën për Zgjidhje Ligjore dhe Dëmshpërblim të Viktimave të Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve Serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, shih seksion 5 në vijim.

[41] Në këtë kohë, Serbia ishte një nga republikat e shtetit të Serbisë dhe Malit të Zi. *Initial report Serbia and Montenegro, 24/07/2003*, (CCPR/C/SEMO/2003/1), Raport i Shtetit Palë, (Përkthimi i burimit: Raporti fillestar i Serbisë dhe Malit të Zi).

[42] *Concluding Observations of the Human Rights Committee*: *Serbia and Montenegro*. 12/08/2004.

CCPR/CO/81/SEMO (Përkthimi i burimit: Vërejtje Përfundimtare të Komitetit mbi të Drejtat e Njeriut: Serbia dhe Mali i Zi)

[43] *Report Submitted By The United Nations Interim Administration Mission In Kosovo To The Human Rights Committee on The Human Rights Situation In Kosovo Since June 1999*, CCPR/C/UNK/1, 3 mars 2006 (Përkthimi i burimit: Raport i Paraqitur nga Misioni i Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të

Bashkuara në Kosovë pranë Komitetit të të Drejtave të Njeriut mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë prej qershorit 1999), (duke përshirë dhe Dokumentin Themeltar të Përbashkët "DTHP" dhe Raportin Specifik mbi Konventën "RSK"), http://www.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/AdvanceDocs/CCPR.C.UNK.1.pdf. UNMIK-u nuk është shtet palë i KNDCP-së, megjithatë, KDNJ-ja i kërkoi UNMIK-ut t'i raportonte komitetit, pasi në 2004-ën Serbia deklaroi se nuk ishte në gjendje të raportonte lidhur me zbatimin e KNDCP-së në Kosovë.

[44] CCPR/C/UNK/CO/1, *Concluding observations of the Human Rights Committee, Advance non edited version, Kosovo (Republic of Serbia)* (Përkthimi i burimit: Vërejtje Përfundimtare të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, Version i Avancuar i paredaktuar, Kosovë, (Republika e Serbisë)).

[45] Konventa e Gjenevës mbi Trajtimin e të Burgosurve të Luftës, miratuar në 12 gusht 1949, http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/91.htm; Protokolli Plotësues i Konventave të Gjenevës së 12 gushtit 1949 mbi Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve Ndërkombëtare të Armatosura (Protokolli 1), Miratuar më 8 qershor 1977, http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/93.htm

[46] KNKK, *Persons Missing in Relation to the Events in Kosovo from January 1998*, maj 2000 (Përkthimi i burimit: Personat e Humbur nga Ngjarjet në Kosovë prej janarit 1998). Lista përfshin emrin e personit, ditëlindjen, gjininë, emrin e babait, dhe datën e vendin ku personi u pa për herë të fundit. Janë nxjerrë katër botime. kurse lista që përditësohet rregullisht gjendet në adresën elektronike: http://www.familylinks.icrc.org/eng/missing-kosovo

[47] KNKK, "Persons Unaccounted for in Connection with Kosovo Crisis", 10 prill 2001 (Përkthimi i burimit: Personat Fati i Cilëve nuk Dihet lidhur me Krizën në Kosovë)

[48] Njësia e Personave të Pagjetur e policisë së UNMIK-ut dhe Njësia Qendrore për Hetime Penale. Policia e UNMIK-ut nuk kishte punonjës të mjekësisë ligjore deri në 2002-shin. Megjithatë, në dhjetor 1999 vetëm 1900 nga 4800 oficerë ndërkombëtare policie të premtuar mbërritën në Kosovë.

[49] Në një artikull të botuar në 2008-n dhe të shoqëruar me fotografi të personelit të KFOR-it që nxirrte trupat nga një lumë, Mauro Del Vecchio, një ish-gjeneral italian i KFOR-it, tha: "Kishim marrë lutje nga nënat dhe gratë serbe që raportonin rrëmbimin e djemve dhe burrave të tyre. Ndonjëherë ata gjendeshin të vdekur. ... këta trupa ishin braktisur në vende të paparashikueshme.", shih "Kosovo, La verita nascosta: I massacri di serbi", *Panorama*, (Përkthimi i burimit: Kosova:E vërteta e fshehur: masakrat ndaj serbëve) 18 dhjetor 2008, http://www.faustobiloslavo.com/articoli/29203.pdf

[50] Mesazh elektronik nga Monique Fienberg, Shefja e Zyrës së UNMIK-ut për të Ndaluarit dhe Personat e Pagjetur, 19 prill 2002. Zyra u mbyll në qershor 2002. ZPZHML-ja deklaroi në shtator 2002 se "së shpejti do të nxirrte Listën e Konsoliduar të Personave të Pagjetur", duke përfshirë 4700 regjistrime, UNMIK/PR/833, 27 shtator 2002; në shkurt 2003, ZPZHML-ja raportoi se lista më "e fundit" përfshinte 4,233 persona si të zhdukur, nga të cilët 3324 ishin shqiptarë dhe 909 jo-shqiptarë, *UNMIK/PR/917*, 3 shkurt 2003. Më 3 dhjetor 2004, ZPZHML-ja e UNMIK-ut raportoi se në "listën e konsoliduar të personave të zhdukur" ishin përfshirë maksimumi 5602 persona , 439 prej të cilëve ishin gjetur të gjallë, *Raporti Vjetor i ZPZHML-së 2002-2004.*

[51] *Raporti Vjetor i ZPZHML-së 2002-2004*, http://www.unmikonline.org/justice/ompf/ompf_reports.htm

[52] S/RES/827(1993), 25 maj 1993; CC/PIO/302-E, Deklarata e Prokurorit për me Gjykatën me Juridiksion mbi Kosovën, 10 maj 1998, http://www.icty.org/sid/7683, adresë e përdorur në prill 2009.

[53] Prokurori kundër Sllobodan Millosheviq, Milan Milutinoviq, Nikolla Shainoviq, Dragoljub Ojdaniq,

Vlajko Stojiljkoviq, (IT-99-37-I), 23 maj 1999. Të pesë të akuzuarit ishin akuzuar si përgjegjës për drejtimin e krimeve kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës në Kosovë.

[54] Lajme nga UN, *UN Tribunal Reports On Mass Graves, Altered Evidence*, (Përkthimi i burimit: Raportet e Gjykatë së KB mbi Varret Masive, Provat e Ndryshuara) 11 nëntor 1999, http://www.unwire.org/unwire/19991111/5783_story.asp, përdorur në prill 2009.

[55] *Beta News*, (Përkthimi i burimit: Lajmet Beta)17 korrik 2001, cituar në HRW, *Under Orders*, (Përkthimi i burimit: Nën Urdhra) poshtëshënimi 40. Kjo bie në kundërshtim me shifrën që i është dhënë Amnesty International në 2002-shin prej Komisionit për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave (KGJIV) se 1,800 eshtra i janë dhënë të afërmve për varrim nga një numër përgjithshëm prej 2,198 trupash të zhvarrosur. Deri më 2002-shin KGJIV ishte përgjegjës për t'ia dorëzuar këto trupa të zhvarrosur Tribunalit.

[56] *Comments on Technical Assessment of Progress in Implementation of Standards for Kosovo*, (Përkthimi i burimit: Komente mbi Vlerësimin Teknik të Progresit në Zbatimin e Standardeve për Kosovën) përgatitur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, 30 nëntor 2007, pasur akses më 3 prill 2009 tek www.mfa.gov.yu/Policy/Priorities/KIM/anex_e.pdf

[57] Intervistë me R.D., Beograd, shkurt 2009; intervistë me Valerie Brasey, ZPZHML, shkurt 2009.

[58] Neni 15 i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë.

[59] http://www.mfa.gov.yu/Policy/Priorities/KIM/unmik_e.html, gjendur më 3 prill 2009. Objektivi i UNMIK-ut në lidhjen e kësaj marrëveshje ishte inkurajimi i serbëve që jetonin në Kosovë dhe atyre të zhvendosur në Serbi të cilët kishin refuzuar të ushtronin të drejtën e tyre zgjedhore për t'u regjistruar për të votuar për zgjedhjet e nëntor 2001-shit.

[60] Sipas kësaj marrëveshje UNMIK-u ra dakord që "deri në 31 dhjetor 2002 të hetonte të gjitha vendndodhjet e varreve në Kosovë të cilat nuk ishin hetuar ende, të ndërmerrte zhvarrimet e të gjithë eshtrave njerëzore, dhe të procedonte nëpërmjet testimeve të ADN-së e të dhënave lidhur me periudhën para dhe pas vdekjes rastet e 1250 eshtrave të paidentifikuara [nga zhvarrimet e Tribunalit] të mbajtura anekënd Kosovës me shpresën e identifikimit dhe kthimit të tyre pranë familjeve." Për më tepër "[D]uke pranuar se programi i zhvarrimit dhe identifikimit është vetëm një pjesë e aktiviteteve", autoritetet ranë gjithashtu dakord "të bashkëpunojnë me një transparencë të plotë dhe të ndajnë me njeri-tjetrin informacionet përkatëse. Ky bashkëpunim do të përfshijë gjithashtu punën në pikat e vendndodhjeve të varreve." www.unmikonline.org/justice/documents/

[61] Kjo u paraqit në përgjigje të besimit të familjeve të kosovarëve serbë se personat e rrëmbyer vazhdonin të ishin të burgosur. Si UNMIK-u, dhe autoritetet e RFJ-së, kishin kryer deri në atë kohë hetime për ekzistencën e burgjeve sekrete, por sipas informacioneve që kemi, nuk u gjet asnjë provë për burgje të fshehura apo qendra ndalimi të jashtëligjshme përkatësisht si në Kosovë apo Serbi. Protokolli u nënshkrua kryesisht për të zbutur frikën dhe për t'i dhënë fund thashethemeve për këto burgje. Gjithashtu ai pati si qëllim shmangien e shfrytëzimit të familjeve nga individë si avokatët, të cilët pretendonin se dinin vendndodhjet e këtyre burgjeve për të zhvatur para familjeve duke u premtuar atyre se do t'ua gjenin anëtarin e familjes.

[62] Në kuadrin e bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës deri në 2004-ën nuk u krijua ndonjë Grup Pune për Personat e Pagjetur që të përfshinte përfaqësues nga Komisioni Serb për Personat e Pagjetur dhe UNMIK-u.

[63] Autoritetet e RFJ-së kishin krijuar një mekanizëm për adresimin e çështjes së personave të pagjetur në 1991, gjatë luftës në Kroaci. Në qershor 2006, qeveria serbe krijoi zyrtarisht një Komision për Personat e Pagjetur të Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe në tetor 2006, Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisëse (IPVQ) në Kosovë krijuan Komisionin Kosovar për Personat e Pagjetur. Të dy komisionet (teorikisht) përfshijnë përfaqësues nga ministritë përkatëse dhe kanë si mandat kërkimin e personave të humbur pavarësisht nga nacionaliteti, etnia apo besimi fetar.

[64] KNPZH, ICMP *Proposal for Kosovo*, dhjetor 2006 (Përkthimi i burimit: Propozime e KNPZH-së për Kosovën)

[65] Deri në prill 2002 ZPZHML-ja kishte kryer 69 zhvarrime dhe kishte gjetur 85 trupa.

[66] Më parë ZPZHML-ja ishte pjesë e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe në 2007-ën një pjesë e kësaj zyre iu transferua Ministrisë së Drejtësisë, por në 2008-ën u bë pjesë e misionit EULEX.

[67]ZPZHML, *Activity Report 2002-2004*, (Përkthimi i burimit: Raporti mbi Veprimtarinë 2002-2004) http://www.unmikonline.org/justice/ompf/ompf_reports.htm, përdorur në 3 prill 2009. Sipas ZPZHML-së 849 eshtra të identifikueshme përshinin 641 shqiptarë etnikë dhe 98 jo-shqiptarë.

[68] Diku tjetër ZPZHML-ja raportoi se ishin kryer 69 zhvarrime dhe se 77 trupa ose pjesë trupi që përfaqësonin 43 individë u gjetën në 2005-n. *Assessments - Exhumations results 2005*, (Përkthimi i burimit: Vlerësimet – Rezultatet e zhvarrimeve 2005) http://www.unmikonline.org/justice/ompf/ompf_reports.htm, referuar në 3 prill 2009.

[69] http://www.unwire.org/unwire/20010611/15196_story.asp. Një prej veprimeve të para të bashkëpunimit serb me Tribunalin; ftesa u mor tre javë para një konference ndërkombëtare donatorësh.

[70] HRW, *Under Orders: War Crimes in Kosovo*, 2001, faqe 124, (Përkthimi i burimit: Nën Urdhra: Krimet e Luftës në Kosovë) http://www.hrw.org/legacy/reports/2001/kosovo/

[71] Në procedimet e Gjykatës dëshmitarët dëshmuan gjithashtu se trupa të tjerë ishin zhvarrosur nga zona të ndryshme në Kosovë dhe se ishin rivarrosur më pas në zona të tjera. Çështja IT-05-87-T, Seksioni P i Vendimit, Përpjekjet për Fshehjen e Krimeve, paragrafi 1263 e në vijim.

[72] Në vitin 2001 ZPZHML-ja nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me të atëhershmen Ministrinë e Punëve të Jashtme të RFJ-ja, dhe një Marrëveshje Dhurimi me Qendrën e Koordinimit për Kosovën dhe Metohinë për të ndihmuar në gërmimin dhe identifikimin e personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë.

[73] Vendim, Çështja IT-05-87-T, paragrafët 1350-1355.

[74] http://www.ic-mp.org/icmp-worldwide/southeast-europe/republic-of-serbia/

[75] Intervistë e Amnesty International me KNKK-në në Beograd, shkurt 2009.

[76] KNPZH, *Concept Paper - A Proposal For ICMP Activities In Kosovo*, gusht 2006. (Përkthimi i burimit: Artikull Konceptues – Një Propozim Për Veprimtarinë e KNPZH-së në Kosovë)

[77] Intervistë me KNKK-në, Beograd, shkurt 2009.

[78] Këto pretendime bazohen në deklaratat e dy dëshmitarëve, njëri prej të cilëve kishte punuar në kompleks; dy dëshmitarë të tjerë, përfshi këtu dhe një ish-anëtar të forcave policore, në intervista me gazetarë hetues konfirmuan më pas këto pretendime, HLC; Danas, 24 dhjetor 2004; Raport për Krizën në Ballkan i IWPR, Investigation: *Serbia: More Mackatica Body Burning Revelations,* prill 2005

(Përkthimi i burimit:  Hetimi:  Serbia:  Zbulime të tjera mbi Djegien e Trupave në Mackatica).

http://www.iwpr.net/?p=bcr&s=f&o=242276&apc_state=henibcr2005

[79] Intervistë me Valerie Brasey, ZPZHML shkurt 2009.

[80] *Lajm*, "Procedurë për gjetjen e të zhdukurve kosovarë", 27 shkurt 2009.  Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës e mohoi bërjen e një kërkese zyrtare homologëve në Maqedoni.

[81] KNPZH, Konkluzionet, *Eleventh Regional Networking Conference on the Missing Persons Issue*, (Përkthimi i burimit:  Konferenca e Njëmbëdhjetë Rajonale për Rrjetin e Çështjes së Personave të Humbur), 28-30 nëntor 2008.

[82] KNKK, Deklaratë për Shtyp 01/05, "Yugoslavia: Families of Kosovo missing can consult new Book of Belongings", 8 shkurt 2001 (Përkthimi i burimit:  Jugosllavia:  Familjet e të zhdukurve të Kosovës mund të konsultojnë Librin e ri mbi Sendet Vetjake)

[83]http://www.ic-mp.org/icmp-worldwide/southeast-europe/un-administered-kosovo.  Mesazh elektronik Amnesty International nga KNPZH-ja, prill 2009.

[84] ICRC, Newsletter of the ICRC Regional Delegation Belgrade, covering Serbia, Albania, Macedonia and Montenegro (Përkthimi i burimit:  Buletin Informativ i Delegacionit Rajonal të KNKK-së në Beograd që mbulon Serbinë, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi), dhjetor 2008; OMPF Activity Report, 2008 (Përkthimi i burimit:  Raporti mbi Veprimtarinë e ZPZHML-së, 2008)

[85] Intervistë me Valerie Brasey, ZPZHML, shkurt 1999.  Këto teknika përshkruhen në Gunilla Holmlund et. al., "Experiences from DNA analysis in Sweden for the Identification of Tsunami Victims", *International Congress Series*, 1288, faqja 74-76, 2006 (Përkthimi i burimit:  'Eksperiencat nga analizat e ADN-së në Suedi për Identifikimin e Viktimave të Tsunamit,' Seritë e Kongresit Ndërkombëtar).

[86] Amnesty International mori në shkurt 2009 një raport prej ZPZHML-së, i përgatitur për Nesrete Kumnovën, i cili shpjegonte hollësisht pse asnjë prej trupave të paidentifikuar të mbajtur në morgun e ZPZHML-së dhe të mjaftueshëm për të siguruar një mostër ADN-je, nuk është i Albion Kumnovës.

[87] http: video.kosovapress.com/?cid=1,7,2998, përdorur në 9 mars 2009.  Përkthim jo-zyrtar, Amnesty International.

[88] "Over 400 sets of human remains still unidentified in Pristina morgue", pasur akses në 6 prill 2009, (Përkthimi i burimit:  Mbi 400 grupe eshtrash mbeten ende ta paidentifikuara në morgun e Prishtinës)

http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2009/04/06/feature-03

[89] Në burgun e Dubravës u vranë afërsisht 150-200 të burgosur shqiptarë të Kosovës, 23 u vranë në dy sulmet bombarduese të NATO-s në 19 dhe 22 maj; të paktën 130 u vranë nga policë serbë dhe burra të maskuar më  22-23 maj.  Intervistë e Amnesty International me HLC-në në Prishtinë, shkurt 2009; lajmet e UNMIK-ut Nr. 86-2/04/01, http://www.unmikonline.org/pub/news/nl86.html, përdorur në prill 2009.

[90] Intervistë me Valerie Brasey, ZPZHML, shkurt 2009.

[91] ZPZHML MPU2000-001592, Shkaku i Vdekjes; Certifikata e Vdekjes prej Departamentit të Drejtësisë; Kërkesë e KNKK-së për Gjurmim.

[92] Komunikim i ekspertit të pavarur me Amnesty International, shtator 2007.  Ai tha gjithashtu se në

këtë rast nuk dinte ndonjë arsye specifike për mosidentifikimin.

[93] Intervistë e Amnesty International me familjen Daka Asani, gusht 2007.

[94] Në shtator 2002, ZPZHML-ja raportoi se kishte kthyer 203 nga 910 raportet e autopsisë të marra nga hetuesit e Tribunalit. Sipas Jose Pablo Baraybar, ato nuk mund të shpërndaheshin pasi shoqatat e familjarëve u ankuan për gabime në shkrimin e emrave [të kërkuara për procedura administrative të mëtejshme], dhe mungesë saktësie lidhur me shkakun dhe datën e vdekjes. Data e vdekjes jepej si dita kur u krye autopsia, shpesh shumë muaj ose vite pas varrosjes për herë të parë. ZPZHML-së i ishte bërë një propozim të ndryshonte "datën e vdekjes" për të pasqyruar se kur e kishte përfunduar punën çdo grup i Tribunalit në secilën vendndodhje varresh, UNMIK/PR/833, *OMPF Press Conference*, 27 shtator 2002 (Përkthimi i burimit: UNMIK/PR/833, Konferenca për Shtyp e ZPZHML-së).

